

European Commission
Commission européenne



Council of Europe
Conseil de l'Europe

Projekti Rajonal CARPO

Shqip

**Raporti mbi
Gjendjen e Krimin të Organizuar dhe
Krimin Ekonomik
në Evropën Juglindore**

Strasbourg, Gusht 2005

Projekti Carpo ("Zhvillimi i Sistemeve të Besueshme dhe Funktionale të Policive si dhe Nxitja e luftimit të aktiviteteve kryesore kriminale dhe i forcimit të bashkëpunimit policor") është një projekt teknik bashkëpunimi i financuar bashkërisht nga Këshilli i Evropës dhe nga Bashkimi Evropian. Ai ka një kohëzgjatje prej 30 muajsh (Mars 2004-Gusht 2005). Këshilli i Evropës është përgjegjës për zbatimin e këtij projekti, në partneritet me Belgjikën, Finlandën, Hungarinë, Italinë, Slloveninë, Spanjën, Suedinë dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim.

Për çdo informacion shtesë ju lutem kontaktoni:

Departamenti i Problemeve të Krimit
Drejtoria e Përgjithshme I – Marrëdhëniet
Juridike
67075 Strasbourg CEDEX, Francë
Tel +33-3-9021-4506
E-mail: livia.stoica@coe.int
Website: www.coe.int/economiccrime

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e paraqitura këtu në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohen se reflektojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës

Tabela e lëndës

1	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
2	KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMI EKONOMIK NË EVROPËN JUGLINDORE: KUADRI	7
2.1	Prapavija dhe qëllimi i raportit.....	7
2.2	Koncepti i krimit të organizuar.....	9
2.3	Skanimi i ambjentit.....	11
2.3.1	Politika dhe qeverisja.....	11
2.3.2	Ekonomia.....	12
2.3.3	Tendencat shoqërore dhe kulturore.....	14
2.3.4	Teknologjia dhe shkenca.....	15
3	GJENDJA E KRIMIT TË ORGANIZUAR	16
3.1	Tregjet Kriminale.....	17
3.1.1	Krimi ekonomik.....	17
3.1.2	Trafiku i Drogës.....	21
3.1.3	Trafikimi i qenieve njerëzore.....	25
3.1.4	Kontrabanda e Personave.....	31
3.1.5	Kontrabanda e mallrave të ligjshme.....	34
3.1.6	Pastrimi i parave.....	38
3.2	Grupet e krimit të organizuar.....	42
3.2.1	Rastet dhe grupet e krimit të organizuar.....	42
3.2.2	Struktura e grupeve të krimit të organizuar.....	45
3.2.3	Modi operandi.....	46
4	VLERËSIMI I KËRCËNIMIT	51
4.1	Kërcënimet kryesore.....	51
4.1.1	Drogat.....	52
4.1.2	Krimi Ekonomik.....	52
4.1.3	Trafikimi i qenieve njerëzore.....	53
4.1.4	Korrupsioni.....	53
4.2	Profilet e vendeve.....	54
4.2.1	Shqipëria.....	54
4.2.2	Bosnja dhe Hercegovina.....	57
4.2.3	Kroacia.....	60
4.2.4	Serbia dhe Mali i Zi.....	63
4.2.5	“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”.....	69
5	KONKLuzioni	72
6	BIBLIOGRAFIA	74

1 Përmbledhja ekzekutive

Krimi i organizuar përbën një rrezik madhor për demokracinë, rendin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe për progresin ekonomik dhe shoqëror në Evropë. Vitet e fundit, Evropa Juglindore është ndikuar në mënyrë të veçantë nga krimi i organizuar dhe krimi ekonomik sikurse dhe nga pushteti ekonomik, lidhjet ndërkombëtare, metodat dhe teknikat e sofistikuara, si dhe impakti korruptiv që shoqëron këto krime.

Kuptimi i krimit të organizuar dhe krimit ekonomik varet në një masë të madhe tek prioritetet e organeve të zbatimit të ligjit dhe të politikave kundër krimit, të cilat mbështeten në kërcënimet e perceptuara në një kohë të caktuar. Pa i kuptuar në thellësi këto fenomene, qeveritë do të dështojnë pashmangshmërisht në përpjekjet e tyre për t'i parandaluar dhe për t'i luftuar ato.

Shqetësimi në rritje lidhur me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në Evropën Juglindore si dhe perspektiva e pranimit të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian, janë shtysë për një analizë thelbësore të shtrirjes, natyrës dhe karakteristikave të këtyre fenomeneve në rajon. Prandaj synimi i këtij raporti është:

- Të analizojë dhe të tregojë kërcënimet dhe problemet e reja shqetësuese për Evropën Juglindore;
- T'i ndihmojë politikë-bërësit në Evropë dhe në rajon të hartojnë politika kundër krimit, si dhe të marrin vendime, duke qenë më të informuar;
- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut mbi këtë çështje si dhe pjesëmarrjen e publikut në strategjitë kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar;

Ky raport mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik është rezultati përfundimtar i punës së kryer në kuadër të projektit CARPO¹ nga përfaqësuesit e përkushtuar të grupeve të punës nga institucionet përkatëse (Policia, Njësitë e Inteligjencës apo të Informacinit Financiar, administrata doganore dhe e tatim taksave, zyra e Prokurorisë së Përgjithshme dhe e Auditimit të Përgjithshëm) të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Republikës së Malit të Zi, Kosovës, Republikës së Serbisë dhe "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë". Ai mbështetet tek informacioni dhe komentet që janë paraqitur me anë të pyetësorëve, tek vlerësimet e bëra nga zyrtarët e sipërpërmendur, por edhe nga një game e gjerë burimesh publike shtesë.

Krimi i organizuar në Evropën Juglindore merr forma të ndryshme dhe përfshin një shumëllojshmëri aktiviteteve kriminale. Sikurse edhe në pjesët e tjera të Evropës, tregjet kryesore kriminale të cilat janë të përbashkëta për shumicën e shteteve dhe zonave janë:

- Mashtrimet, evazioni fiskal dhe doganor si dhe forma të tjera të krimit ekonomik
- Trafiku dhe shpërndarja e drogës
- Kontrabanda e personave
- Trafikimi i qenieve njerëzore

Krimi i organizuar është një koncept dinamik, i cili përshtatet vazhdimisht me një ambjent në ndryshim të përhershëm dhe me mundësitë e reja për krimin. Kjo është po aq e vërtetë edhe për krimin e organizuar në Evropën Juglindore:

- Përpjekjet e harmonizuara në fushën e legjislacionit dhe të zbatimit të ligjit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së personave duket se e kanë përmirësuar situatën duke e reduktuar numrin e personave të trafikuar apo emigrantëve klandestinë përgjatë

¹ "Zhvillimi i Sistemeve të Besueshme dhe Funktionale të Policive si dhe Nxitja e Luftës kundër Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe Forcimi i Bashkëpunimit ndërmjet Policive".

kufijve. Në të njëjtën kohë, kontrabanda e personave dhe trafikimi i qenieve njerëzore paraqet sfida të reja, që kanë të bëjnë me trafikimin dhe rekrutimin e brendshëm si dhe me shtimin e klientelës brenda vendit.

- Krimi ekonomik nga i cili janë prekur rëndë të gjitha vendet e rajonit, gjithashtu ka përparuar. Dhënia fund e sanksioneve kundër Serbisë dhe shkatërrimi menjëherë pas kësaj i kanaleve të kontrabandës së naftës dhe të cigareve, si dhe përpjekje të tjera në fushën e legjislacionit dhe të zbatimit të ligjit, kanë kontribuar në mënyrë domethënëse në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave publike. Kështu janë hequr disa mundësi për tregti të paligjshme në rajon. Sidoqoftë, të tjerat mbeten. Falsifikimi i dokumenteve, dhe kompanitë fiktive – mekanizmat bazë të evazionit fiskal dhe të pastrimit të parave – duket se janë të pranishëm kudo në të gjitha vendet dhe në të gjitha zonat. Forma të tjera të krimit ekonomik – siç mund të jenë mashtrimet që lidhen me tenderat, me privatizimin dhe sektorin financiar – besohet se janë në rritje, duke e çnuar vazhdimisht besimin e publikut në ekonominë e tregut dhe në sistemin e drejtësisë penale.
- Rruga tradicionale ballkanike e trafikimit të drogës është bërë një rrugë vajtje-ardhje, ku heroina dhe kanabisi shkojnë drejt Bashkimit Evropian, ndërkohë që prekursorët, kokaina dhe drogat sintetike lëvizin drejt Lindjes. Në disa vende, tregjet e brendshme të drogave duket se janë duke u shtuar së bashku me numrin e përdoruesve të drogës. Lidhur me këtë nuk duhet të shtohen vetëm masat ndëshkuese, por edhe masat parandaluese.

Së bashku me maturimin e tregjeve të krimit, grupet kriminale po tentojnë t'i konsolidojnë aktivitetet ekzistuese, t'i transformojnë ato në aktivitete të tjera si dhe të legjitimojnë të ardhurat dhe pozitën e tyre në shoqëri. Korrupsioni, në nivele të larta dhe të ulëta, duket se është mjete kryesor për të ndikuar dhe për të depërtuar tek strukturat politike dhe komerciale. Përpjekjet që po bëhen aktualisht kundër korrupsionit në këto vende kanë pasur si rezultat një numër gjithnjë në rritje të hetimeve dhe të procedimeve penale, por ende pak dënime. Fakti që shumica e shteteve dhe e zonave kanë miratuar tashmë strategji të gjithanshme anti-korrupsion dhe kanë ngritur shërbime kundër korrupsionit është premtues. Këto përpjekje mund të ndihmojnë për të dobësuar lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe krimit ekonomik me strukturat ligjore dhe publike.

Pavarësisht disa tipareve dalluese në secilin shtet dhe zone të projektit, problemet që lidhen me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik kanë një dimension rajonal. Si të tilla për to nevojiten zgjidhje rajonale. Harmonizimi ligjor, përpjekjet e përbashkëta për zbatimin e ligjit dhe shkëmbimi i informacionit midis policive në nivel rajonal do të jenë kyçi i suksesit në luftimin e krimeve serioze në Evropën Juglindore. Për këtë arsye, policimi që paraprihet nga informacioni në këtë rajon duhet të mbështetet në themele të qëndrueshme duke ndërtuar sisteme koherente të mbledhjes së informacionit (të të dhënave) mbi krimin.

Megjithëse shtetet e këtij projekti e kanë pranuar impaktin negativ që krimet e rënda kanë për shoqëritë e tyre, ende nuk i kanë gati vlerësimet lidhur me humbjet e të ardhurave publike, si pasojë e krimit ekonomik, apo mbi përmasat e tregut të brendshëm të drogës. Me përjashtime të rralla, sistemet e zbatimit të ligjit në rajon ende nuk kapacitetet për mbledhjen e të dhënave, për analizimin e tyre dhe për hetimin.

Duke qenë se produktet e krimit, janë një emërues i përbashkët për forma të ndryshme të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik, hetimi financiar dhe intelijenca financiare janë thelbësore për çdo analizë mbi krimin ekonomik dhe krimin e organizuar. Shtetet dhe zonat e këtij rajoni kanë ngritur njësi të inteligjencës financiare dhe po ashtu në një shkallë të caktuar ndërmarrin hetime financiare që kanë lidhje me hetimet kriminale. Por, këto mjete duhen përdorur në mënyrë më sistematike.

Masat që shtetet dhe zonat e këtij projekti do të ndërmarrin në kuadër të Projektit Rajonal për Policinë CARPO, do të ndihmojnë në kapërcimin e këtyre mangësive. Këto masa mund të përfshijnë:

- Përmirësimin e mbledhjes dhe të analizimit të informacionit me qëllim që të përmirësohet njohja dhe kuptimi i krimit të organizuar dhe krimit ekonomik (p.sh. ngritja e sistemeve statistikore mbi krimin, përcaktimi i instrumenteve që masin nivelin e krimit, studime mbi mundësinë e prekjes së sektorëve të ndryshëm ekonomikë nga krimi i organizuar dhe krimi ekonomik, bashkëpunimi ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe studiuesve të pavarur apo akademike me qëllim studimin dhe analizimin e fenomeneve që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në rajon).
- Mekanizma të udhëhequr nga informacioni për përkufizimin e politikave, të cilat do të mbështeten në vlerësime rrënjësore, si dhe do të japin mundësinë e caktimit të prioriteteve në luftimin e formave specifike të krimit.
- Fuqizimin e kapaciteteve të njësive për analizimin e krimit, të shërbimeve të specializuara të hetuesisë apo të prokurorisë, për t'u marrë me krimin e organizuar, veçanërisht duke siguruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare si dhe trajnime të specializuara.
- Masat për përmirësimin e aftësive hetuese në lidhje me krimin ekonomik dhe krimin e organizuar, sikurse dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndër-juridiksional (p.sh. përdorimi siç duhet i teknikave të posaçme hetimore, përdorimi i informacionit me rëndësi strategjike dhe i analizës së krimit, përdorimi ndërkufitar i informacionit të mbledhur, etj).
- Përdorimin më të mirë të shërbimit informativ financiar me qëllim që të përfitohet një njohje më e plotë e krimit të organizuar dhe e krimit ekonomik (të forcohen kapacitetet për hetime financiare, kapacitetet e vetë njësive të inteligjencës financiare si dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërkufitar për këto çështje).
- Vënien në dispozicion dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur garantimit të një shkalle të caktuar të konfidencialitetit (duke përfshirë zbatimin e instrumenteve përkatëse evropiane mbi intimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale).
- Monitorimin sistematik të efektivitetit të masave për paranadalinimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik.

Ratifikimi dhe zbatimi i plotë i instrumenteve evropiane do t'i ndihmojë shtetet që të bëjnë progres në këtë fushë si dhe do të lehtësojë bashkëpunimin ndërkombëtar. Këto instrumente përfshijnë në mënyrë të veçantë Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale (CETS 182), Konventën e re mbi Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit si dhe mbi Financimin e Terrorizmit (CETS 198) si dhe Konventën e re mbi Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS 197).

Ky raport është fillimi premtues i diçkaje që në natyrë është një ushtrim afat-gjatë, i cili kërkon të kryhet rregullisht, dhe që ka nevojë për reagim (feedback), identifikim dhe azhurnim të informacionit, konfirmim ose anulim të vlerësimeve të bëra këtu. Ky raport do të azhurnohet në vitin 2006.

Ne shpresojmë që raporti do të shërbejë si udhërrëfyes për politikë-bërësit në Evropë dhe në rajon, për të bërë një politikë kundër krimit, apo për të marrë vendime, duke qenë më të informuar, për të ndërmarrë aksione të qëndrueshme në luftën kundër krimit të organizuar si dhe për të thelluar kuptimin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore.

2 Krimi i organizuar dhe krimi ekonomik në Evropën Juglindore: Kuadri²

2.1 Prapavija dhe qëllimi i raportit

Krimi i organizuar ka qenë në axhendën e Këshillit të Evropës për më shumë se dy dekada³ dhe është rikonfirmuar si një prej shqetësimeve madhore nga Samiti i 3-të i Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive në maj të vitit 2005. Po ashtu, këto çështje kanë pushtuar edhe axhendën e Bashkimit Evropian gjatë dhjetëvjeçarit të shkuar, sidomos në këndvështrimin e pranimin të dhjetë shteteve të reja anëtare në BE, të cilat kanë miratuar me sukses *acquis* (të drejtën) e BE-së në këto fusha.

Në Evropën Juglindore, situata nuk është e njëjtë dhe nuk ka arritur të njëjtat përmasa kritike në të gjitha vendet e këtij rajoni. Ekziston perceptimi se krimi i organizuar dhe krimi ekonomik rrezikojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe stabilitetin si dhe progresin ekonomik dhe shoqëror brenda rajonit, por impakti i tyre ndjehet edhe përtej Evropës Juglindore. Natyra komplekse dhe në ndryshim të përhershëm e krimeve të rënda shtron kërcënime të reja për këto shoqëri në tranzicion.

Prandaj, shqetësimet në rritje në lidhje me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në Evropën Juglindore si dhe perspektiva e pranimin të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian, diktojnë një analizë të thellë të gamës, natyrës dhe të karakteristikave të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik në rajon. Veprimet efektive duhet ta kenë burimin tek politika kundër krimit, të cilat duhet të udhëhiqen nga informacioni i mbledhur dhe të jenë të afta të gjenerojnë impakte pozitive.

Gjithsesi, duket se njohja e asaj se çka përbën krim të organizuar dhe krim ekonomik, dhe në mënyrë të veçantë, se cilat janë implikimet ndërkuftare dhe ndërkombëtare të tyre, ende mbetet e kufizuar. Në përgjigje të kësaj, Këshilli i Evropës projekttoi Projektin CARPO ("Zhvillimi i Sistemeve të Besueshme dhe Funktionale të Policive si dhe Nxitja e Luftimit të Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe Forcimi i Bashkëpunimit Policor") me qëllim forcimin e kapaciteteve të policive kundër krimeve të rënda në Evropën Juglindore.⁴ Një prej rezultateve të pritshme të këtij projekti është thellimi i kuptimit të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, si dhe të kërcënimeve që shfaqen në lidhje me to.

Qëllimi i këtij raporti, i cili është përpunuar në kuadër të Projektit CARPO, është që:

- Të analizojë dhe të tregojë kërcënimet e reja dhe çështjet shqetësuese për Evropën Juglindore.
- Të ndihmojë politikë-bërësit në Evropës dhe sidomos ata të rajonit të marrin vendime më të informuara mbi politikat kundër krimit;
- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut mbi këtë çështje, por edhe pjesëmarrjen publike në strategjitë kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Ky raport është rezultati përfundimtar, i cili është mbështetur në punën e kryer nga grupet e punës të përbërë nga anëtarë të organeve kompetente të zbatimit të ligjit (kryesisht policia), të ngritur në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Mali i Zi, Kosovë dhe në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", (të cilat këtej e tutje do të quhen zonat e projektit).⁵

² Ky raport përqendrohet në situatën e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik kryesisht në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi dhe Mali i Zi (duke përfshirë Kosovën), dhe në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë".

³ Shih për shembull Rekomandimin Nr. (86) 8 mbi politikat kundër krimit në Evropë në një kohë ndryshimesh.

⁴ Ky projekt, i cili është financuar bashkërisht nga Komisioni Evropian dhe nga Këshilli i Evropës do të zgjasë 30 muaj. (Mars 2004-Gusht 2006). Informacione të mëtejshme në lidhje me këtë projekt, mund t'i gjeni në faqen e internetit: <http://www.coe.int/cards-police>.

⁵ Ky raport është përpunuar nga Znj. Kristina Hemon (këshilltare, Mbretëria e Bashkuar), duke u mbështetur kryesisht në informacionet, vlerësimet dhe komentet e paraqitura nga grupet e punës, të përmendura më sipër.

Përveç përfaqësuesve të njëjësive të specializuara të policies, të cilët kanë mbizotëruar në përbërjen finale të grupeve të punës, ato kishin në përbërje edhe agjenci të tjera të zbatimit të ligjit, të tilla, si: Njësitë e Inteligjencës Financiare (pastrimi i parave), administrata e tatim taksave dhe administrata doganore (krimi ekonomik dhe humbja e të ardhurave publike), prokurorë të specializuar dhe Zyra e Auditimit të Përgjithshëm (të ardhurat publike dhe tenderat publikë).

Sipas praktikës që ndiqet me raportet mbi gjendjen e krimit të Këshillit të Evropës⁶, një pyetësor është dërguar në të shtatë zonat e projektit në pranverë të vitit 2004. Gjithashtu, një seri aktivitesh janë organizuar në kuadër të Projektit CARPO, të cilat kanë patur si synim trajnimin thelbësor në fushën e analizës strategjike të të dhënave mbi krimin si dhe mbi kriteret institucionale, ligjore dhe praktike që lidhen me mbledhjen, analizën dhe menaxhimin e të dhënave mbi krimin. Po ashtu në secilën prej zonave të projektit janë organizuar workshope, u organizuan tre seminare rajonale në periudhën shtator 2004-Qershor 2005; janë organizuar tre vizita studimore (në Shërbimin Informativ Kombëtar mbi Krimin në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Njësinë Qendrore të Informacionit mbi Krimin në Policinë Spanjolle, EUROPOL).

Burimi kryesor për raportin e gjendjes së krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, janë pyetjet që i janë dhënë pyetësorit, intervistat dhe diskutimet që janë kryer gjatë workshopeve dhe seminareve rajonale, sikurse dhe çdo literature tjetër në shërbim të publikut, sikundër mund të jenë raportet mbi gjendjen e krimit dhe raporte të tjera, të përgatitura nga Këshilli i Evropës, EUROPOL-i, UNODC, OSCE dhe Departamenti i Shtetit i SHBA-së, raporte nga institute të shumta kërkimore, nga institucione të ndryshme akademike, nga media, etj.

Ky raport, i cili është i pari në llojin e vet, analizon shtrirjen, natyrën dhe karakteristikat e krimit ekonomik dhe krimit të organizuar në rajon:

- Kapitulli i parë jep një panoramë të kuadrit, brenda të cilit është përpunuar ky raport, konceptin e krimit të organizuar si dhe ambjentin e jashtëm të krimit ekonomik dhe të krimit të organizuar;
- Me qëllim që të bëhet një vlerësim i gjendjes së krimit të organizuar në rajon, kapitulli i dytë analizon disa fusha, të cilat mendohet se janë tregje të rëndësishme kriminale për vendet e rajonit – krimi ekonomik, trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda e personave, kontrabanda e mallrave të ligjshme, pastrimi i parave – si dhe bën një përpjekje për të identifikuar strukturat e grupeve të krimit të organizuar, metodat e punës (modi operandi) si dhe prirjet me rëndësi që vërehen në këtë drejtim;
- Kapitulli i fundit tenton të përshkruajë dhe të vlerësojë kërcënimet kryesore, si në kë ndvështrimin rajonal, ashtu edhe për secilin shtet në veçanti, pavarësisht nga vështirësitë përta u takon instrumenteve të besueshme të matjes dhe të krahasimit të seriozitetit të kërcënimit;
- Kapitulli i fundit propozon disa konkluzione të cilat mund të jenë të rëndësishme, nëse merren parasysh përpjekjet e intensifikuara kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Krimi i organizuar dhe forma të tjera të krimit ekonomik dhe krimeve të rënda sipas të gjitha gjasave do të mbeten një prioritet i shoqërive evropiane edhe për njëfarë kohe në të ardhmen, aq më tepër për shoqëritë e vendeve të Evropës Juglindore. Ky raport do të shërbejë si bazë për zhvillimin e një strategjie rajonale mbi instrumentet kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në vjeshtën e vitit 2005. Raporti mbi gjendjen e krimit do të azhurnohet në përfundim të projektit, në verën e vitit 2006.

⁶ Shih www.coe.int/economiccrime

2.2 KONCEPTI I KRIMIT TË ORGANIZUAR

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin e Organizuar Ndërkufitar (UNTOC) mund të konsiderohet si sprova më e rëndësishme për të arritur tek një koncept i pranuar globalisht në lidhje me krimin e organizuar. Kjo konventë ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2003. Deri në vitin 2005, konventa është nënshkruar dhe ratifikuar nga të gjitha shtetet e rajonit, si dhe nga pjesa më e madhe e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian. Prandaj, është edhe referenca kryesore për Evropën dhe për rajonin.

UNTOC gjen zbatim në raport me krimet e rënda, korrupsionin, pastrimin e paranave, dhe pengimin e drejtësisë, nëse vepra penale ka natyrë ndërkufitare si dhe përfshin një grup të krimit të organizuar, sikurse përkufizohet në konventë. Sipas nenit 2 të Konventës:

- (a) 'një grup kriminal i organizuar' nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime apo vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale;
- (b) 'krim serioz' nënkupton atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një denim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh, ose me një denim më të rëndë;
- (c) 'Grup i strukturuar' nënkupton një grup që nuk është formuar në mënyrë të rastësishme për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të ose të ketë një strukturë të zhvilluar;

Këshilli i Evropës – në Rekomandimin e tij (Rec2001)11 – ka miratuar një përkufizim të ngjashëm të "grupit të organizuar kriminal" pa e kufizuar shtrirjen e tij vetëm për veprat ndërkombëtare.⁷

Përgjigjet që i janë dhënë pyetësorit tregojnë se shumica e shteteve në rajon kanë parashikuar në legjislacionin e tyre përkufizime për krimin e organizuar apo grupet e organizuar a kriminale⁸.

Megjithatë, ende, krimi i organizuar mbetet një koncept jo shumë i qartë, që merr kuptimin e asaj që konsiderohet forma më kërcënuese e krimit për një shoqëri, dhe që influencohet nga interesa të ndryshme politike dhe institucionale. Ai zë vend në një kontekst shumë dinamik, i cili ofron shumë mundësi për krimin e organizuar, por kërkon edhe një lloj lehtësie për t'u përshtatur qoftë nga agjencitë e zbatimit të ligjit, qoftë nga vetë kriminelët. Krimi i organizuar formohet nën ndikimin e kontekstit politik, shoqëror dhe ekonomik, në të cilin operon, të marrëdhënieve tepër komplekse, shpeshherë jo konfrontuese, por klienteliste dhe në simbiozë, ndërmjet tij dhe shtetit e shoqërisë. Koncepti i vjetër i grupeve kriminale të organizuara, hierarkike dhe të ashpra, është zëvendësuar me konceptin e ri, të grupeve kriminale të organizuara "burokratike" me struktura tepër të zhvilluara,

⁷Sipas Rekomandimit Rec(2001)11 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me parimet udhëheqëse në luftën kundër krimit të organizuar (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 shtator 2001, në mbledhjen e 765-të të Zëvendës Ministrave), për qëllime të rekomandimit:

- "grup i organizuar kriminal" nënkupton një grup të strukturuar, që ka ekzistuar për një periudhë të caktuar kohe, të përbërë prej tre ose më shumë personave, që veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime të rënda, me qëllim që të sigurojnë në mënyrë direkte apo indirekte, përfitime financiare apo materiale;
- 'krim i rëndë', nënkupton një sjellje që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një denim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh, apo me një denim më të rëndë;;

Shih gjithashtu, përkufizimin e Bashkimit Evropian të vitit 1998 mbi organizatën kriminale: "1. Organizata kriminale nënkupton një bashkësi të strukturuar, të ngritur për një periudhë të caktuar kohe, të përbërë prej tre ose më shumë personave, që veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin me qëllimin për të kryer vepra penale të cilat ndëshkohen me heqje lirie apo me izolim për një periudhë maksimale prej të paktën katër vjetësh, apo me denim më të rëndë, kur këto vepra penale janë në vetvete qëllimi apo mjeti për sigurimin e përfitimeve materiale, apo sipas rastit, për influencimin e veprimeve të autoriteteve publike. (neni 1). (Veprimi i përbashkët 98/733/JHA, i datës 21 dhjetor 1998, i miratuar nga Këshilli, mbështetur në Nenin K3 të Traktatit mbi Bashkimin Evropian, që e bën vepër penale, pjesëmarrjen në një organizatë kriminale në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian).

⁸ Të tilla si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia (Serbia dhe Mali i Zi) dhe "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"

për t'i bërë më të pakapshme dhe fluide rrejet e bashkëpunimit, gjë që e bën detyrën e identifikimit dhe të analizimit të tyre akoma dhe më të vështirë.⁹

Pyetësi kërkonte nga zonat e projektit, që të përdornin kriteret e mëposhtëme gjatë përkufizimit të krimit, apo të grupeve kriminale si "krim i organizuar":¹⁰

Kriteret e domosdoshme:

1. Bashkëpunimi i tre ose më shumë njerëzve
2. Për një periudhë të zgjatur, ose të pacaktuar kohe
3. Të dyshuar ose të dënuar për kryerjen e shkeljeve të rënda penale
4. Me qëllimin që të nxjerrin fitime ose/dhe të fitojnë pushtet

Kriteret fakultative:

5. Kanë një rol ose detyrë të veçantë për secilin anëtar;
6. Përdorin ndonjë formë disipline ose kontrolli të brendshëm;
7. Përdorin dhunën ose forma të tjera për të frikësuar;
8. Ushtrojnë ndikim tek politika, media, administrata publike, organet e zbatimit të ligjit, gjyqësori, ose administrata ekonomike duke e korruptuar ose me forma të tjera;
9. Përdorin struktura tregtare ose të ngjashme me biznesin;
10. Janë të përfshirë në pastrim parash;
11. Operojnë në nivel ndërkombëtar;

Përveç minimumit të karakteristikave ('kriteret e detyrueshme' nga 1 në 4), të paktën dy prej 'kriterëve fakultative' duhet të zbatohen për të kualifikuar një grup kriminal apo një vepër si krim të organizuar. Në këtë mënyrë, profesionistët apo entet ligjore të përfshira në forma të reja, apo të rënda të krimit operacional apo të krimit ekonomik, duhet të përfshihen në këtë përkufizim.

⁹ Shih Raportin e Këshillit të Evropës mbi gjendjen e krimit të vitit 2004, faq. 10-11. Lidhja e rastësishme, apo edhe amalgama e koncepteve të krimit të organizuar dhe terrorizmit i shton edhe më shumë paqartësitë dhe ambiguitetet, duke krijuar ndonjëherë një lidhje të rreme ndërmjet terrorizmit dhe metodave të caktuara, nga të cilat ai financohet, ose nëpërmjet të cilave kryhet. Terrorizmi dhe krimi i organizuar janë koncepte - a priori - të ndara. Krimi i organizuar ka si qëllim kryesor të përfitojë të ardhura financiare, ose të mira të tjera materiale, ndërkohë që terrorizmi mbështetet në përdorimin e pa dallim të dhunës për të ndryshuar rendin e vendosur ligjor dhe kushtetues apo politikat. Shumica e grupeve dhe e rrjeteve kriminale që veprojnë në Evropë janë të përfshira në mashtrime dhe në forma të tjera të krimit ekonomik, në prodhimin e drogës, në trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandën e klandestinëve, por jo në aktivitete terroriste. Kjo megjithatë, nuk e përjashton mundësinë që mund të ekzistojnë disa lidhje dhe ngjashmëri ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit, sidomos me prirjen e terrorizmit për t'u konvertuar në krim të organizuar. (shih në këtë kontekst: Rezolutën e miratuar nga Mbledhja e tretë e Nivelit të Lartë e Ministrave të Brendshëm, mbi "Luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, për të përmirësuar sigurinë në Evropë", Varshavë, 17-18 mars, 2005).

¹⁰ Përdoret gjithashtu nga Bashkimi Evropian (doc. 6204/2/97 Enfopol 35 Rev 2) në raportet e tij vjetore mbi kriminalitetin.

2.3 SKANIMI I AMBJENTIT

'Skanimi i ambjentit' u fut për here të pare në raportet mbi krimin e organizuar, të vitit 2001 dhe 2002. Ai konsiston në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit që ka lidhje me ambjentin e jashtëm të krimit të organizuar, në mënyrë që të identifikohet një kontekst më i gjerë si dhe tendencat kryesore që kanë ndikim mbi të, por edhe të analizohen ndryshimet e mundshme të tij, si pasojë e këtyre tendencave. Ky proces i shërben një fokusi pro-aktiv dhe e bën marrëdhënien ndërmjet prirjeve të identifikuara dhe subjektit më transparent.

Analiza e mëposhtëme ndihmon në strukturimin e ambjentit të jashtëm duke e ndarë atë në: lëmin politik, ekonomik, shoqëror dhe teknologjik - PEST¹¹.

2.3.1 Politika dhe qeverisja

Natyra e shtetit dhe institucionet politike duket se janë faktorë përcaktues për krimin e organizuar.

Tema kryesore në fushën e politikës dhe të qeverisjes janë shpërndarja e pushtetit dhe ndryshimi i rolit të shtetit. Këto ndryshime shkaktohen nga liberalizimi i tregut, decentralizimi dhe globalizimi si dhe nga roli gjithnjë e në rritje i aktorëve jo-shtetërorë, të tillë si strukturat qeverisëse mbikombëtare, (BE-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare), apo korporatat transnacionale. Një shpërndarje e tillë e pushtetit ngre për diskutim çështjen e primatit të shtetit në kontrollimin e krimit.

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë, kërcënimet e reja, të tilla si konfliktet ndër-shtetërore, terrorizmi dhe rrjetet e krimit ndërkufitar i zunë vendin, armikut të vjetër, të dukshëm dhe të identifikueshëm. Pas ngjarjeve të 11 Shtatorit, masat kundër terrorizmit përfshinë forcimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar për kontrollimin e krimit të organizuar.¹² Traktatet ekzistuese u rigjallëruan, dhe u miratuan konventa të reja, të tilla si konventat e Këshillit të Evropës dhe të Kombeve të Bashkuara kundër pastrimit të parave, kundër financimit të terrorizmit, kundër krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, apo krimit në fushën e kibernetikës.¹³

Një prej zhvillimeve thelbësor të vitit 2004 ishte dhe zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe aderimi i dhjetë shteteve të reja anëtare më 1 maj. Perspektiva e aderimit të Bullgarisë dhe Rumanisë, në vitin 2007, e zhvendos raundin e pranimit për shtetet e "Ballkanit Perëndimor" në një kohë tjetër.¹⁴ Ndërkohë, kufijtë e Bashkimit Evropian janë zhvendosur më në jug, duke vënë një theks më të madh në policimin e kufirit dhe në përqasjen e mëtejshme të legjislacionit me *acquis* të vendeve kandidatë të mundshme të BE-së. Disa argumentojnë se një pozicion i tillë i rajonit në mesin e vendeve të BE-së do ta shtojë edhe më tej shqetësimin e BE-së për këtë zonë, gjithnjë problematike, si dhe do të diktojë një politikë më të angazhuar të BE-së në rajon.¹⁵

Evropa Juglindore ka tiparet e saj të veçanta, sidomos në fushën e politikës dhe të qeverisjes, sikurse mund të përmendet rënia e ish-Jugosllavisë dhe rivendosja e të ashtuquajturës "Rrugë Ballkanike". Shtete dhe kufij të rinj u krijuan pas vitit 1990, gjë që kërkonte institucione të reja, si p.sh. policinë e kufirit. Përshpejtimi qoftë i procesit të ndërtimit të institucioneve të reja dhe të një kuadri të ri ligjor, por edhe i reformimit të institucioneve të vjetra, është një barrë tepër e rëndë qoftë për kapacitetet

¹¹ Shih: Black et al. 2001. Kjo lloj analize e PEST-së mund të duket spekulative, por çon në disa përfundime të dobishme.

¹² Shih Bear (2003)

¹³ Shih: Council of Europe, <http://conventions.coe.int/>

¹⁴ Me përjashtim të Kroacisë e cila ka marrë një vlerësim pozitiv nga Komisioni Evropian në Prill të vitit 2005, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, si dhe "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ende nuk e kanë statusin e kandidatit. Për Kroacinë, shih *Opinionin e Komisionit Evropian mbi Aplikimin e Kroacisë për Anëtarësim në Bashkimin Evropian*, 20 prill 2005

¹⁵ Në lidhje me këtë argument shih Komisionin Ndërkombëtar: "Ballkani në të ardhmen e Evropës", prill 2005.

institucionale ekzistuese, që janë ende të pafuqishme, apo të dëmtuara nga lufta, por edhe për buxhetin. (të ardhurat publike). Për ato vende të cilat kanë qenë më të suksesshme në procesin e përsheptimit të reformave, problemet janë lidhur më tepër me zbatimin e instrumenteve të reja, por janë shoqëruar edhe nga mungesat në pajisje teknike për zbatimin e tyre.

Në nivel kombëtar, kuadri ligjor i zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme si dhe kompetencat e paqarta të agjencive të zbatimit të ligjit, e kanë dobësuar bashkëpunimin ndër-dikasterial dhe zbatimin e ligjit në mënyrë efektive. Në nivel ndërkombëtar, lufta ka ndikuar në bashkëpunimin rajonal ndërmjet policive dhe në shkëmbimin e informacionit. Ndërkohë që, kriminelët kanë përfituar nga avantazhe konkurruese, që i kanë rrënjët tek lidhjet e ngushta rajonale, një gjuhë përgjithësisht e përbashkët dhe nga mundësia e disponimit të armëve dhe të aparaturave të tjera teknike, ndërkohë që ata nuk ballafaqohen me asnjë prej vështirësive që janë të përbashkëta për të gjitha shtetet e rajonit.

Lufta në ish vendet jugosllave, sanksionet ndërkombëtare kundër Serbisë dhe rënia e shtetit shqiptar në vitin 1990, kanë ofruar një shans unik për krimin e organizuar, për t'u infiltruar në strukturat qeveritare, fillimisht në shërbimet e sigurimit dhe në agjencitë e patrullimit të kufijve (doganat dhe shërbimi i sigurimit të kufirit).

Sondazhet tregojnë se shoqëritë e Evropës Juglindore vazhdojnë ta perceptojnë korrupsionin si një problem shqetësues dhe domethënës. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, vendet e rajonit renditen gjithësi poshtë.¹⁶ Viti 1990, mendohet t'i jetë dedikuar "ndërtimit" të bizneseve të paligjshme. Në vitin 2000, kriminelët e organizuar, janë përqendruar më tepër në konsolidimin e bizneseve të tyre dhe në gjetjen e mënyrave nga më të ndryshmet për të investuar në ekonominë e ligjshme, duke shfrytëzuar korrupsionin si një prej mjeteve kryesore, për ta arritur këtë.

2.3.2 Ekonomia

Forcat e kërkesës dhe të ofertës ndikojnë njësoj si në tregun e ligjshëm ashtu edhe në tregun e paligjshëm, duke i detyruar ato t'u nënshtrohen të njëjtave dinamika dhe të shfaqin sjellje të ngjashme me biznesin, duke marrë në konsideratë mundësitë më fitimprurëse. Prandaj procesi i globalizimit i ndryshon kushtet si për aktivitetet e ligjshme, ashtu dhe për ato të paligjshme:

- **Asimetritë:** Globalizimi mund t'i theksojë më tej asimetritë, që mendohet se janë të një natyre krimogjenike (që gjenerojnë krimin). Në bazë të indeksit të zhvillimit njerëzor të Raportit të vitit 2005 të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Evropa ka 15 nga 20 vendet më të zhvilluara të botës. Sidoqoftë, të gjitha vendet e Evropës Juglindore, duke përfshirë Rumaninë, Bullgarinë dhe Turqinë, janë vende me tregues mesatar të zhvillimit njerëzor. Vetëm Kroacia futet në listen e shteteve me një indeks të lartë të zhvillimit njerëzor,¹⁷ megjithëse diferenca e saj me vendet e tjera fqinje nuk është shumë e madhe. Kështu asimetritë midis Evropës dhe Fqinjve të saj më të afërt janë të dallueshme.

¹⁶ Kroacia ka lëvizur prej vendit të 60-të në vendin e 67-të, që prej vitit 2003; Bosnja dhe Hercegovina ka rënë prej vendit të 70-të në vendin e 83-të; ndërkohë që Shqipëria ka rënë prej vendit të 92të në vendin e 108të. Serbia dhe Mali i Zi, por edhe "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" e kanë përmirësuar pozicionin e tyre, prej respektivisht vendit të 109-të në vendin e 100-të dhe prej vendit të 108-të në vendin e 99-të.

¹⁷ Vendet që janë pozicionuar nga 1 deri në 55, i përkasin vendeve me tregues të lartë të zhvillimit njerëzor, vendet të pozicionuara me numrat nga 55 deri në 142 u përkasin vendeve me tregues të mesëm të zhvillimit njerëzor, që ndiqen nga vendet me zhvillimi të ulët njerëzor, të pozicionuara në vendin 143 e poshtë. Shih *Raportin e Zhvillimit Njerëzor* të vitit 2004, të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Vendi	Popullsia (milione) 2003	Të ardhurat kombëtare bruto/ për person (US\$) 2003	Pozicioni në zhvillimin njerëzor 2004	Perceptimi i Korrupsionit Treguesi i vendeve 2004	Veprat penale të regjistruara 2000	Dënimet 2000	Popullata e burgjeve 2004
					Per 100 000 inhabitants in 2000		
Shqipëria	****3.4	1 740	65	108	149	117	105
Andora	0.07						90
Armenia	3.2	3 770	82	82	360	203	92
Austria	8.1	26 720	14	13	6 891	512	100
Azerbajxhani	8.2	810	91	140	*73	*197	198
Belgjika	10.4	25 820	6	17	**8 558	1 446	88
Bosnja dhe Hercegovina	****3.8	1 540	66	82			67
Bullgaria	7.8	2 130	56	54	1 779	388	127
Kroacia	4.4	5 350	48	67	1 597	403	68
Qipro	0.8		30	36	575	**126	50
Republika Çeke	10.2	6 740	32	51	3 811	615	182
Danmarka	5.4	33 750	17	3	9 447	**767	70
Estonia	1.4	4 960	36	31	4 038	717	330
Finlanda	5.2	27 020	13	1	10 262	3 351	69
Franca	59.6	24 770	16	22	6 405	957	91
Gjeorgjia	4.3	830	97	133	269	173	165
Gjermania	82.5	25 250	19	15	7 616	1 071	96
Greqia	10.6	13 720	24	49	3 482		83
Hungaria	10.1	6 330	38	42	4 445	1 034	165
Islanda	0.29		7	3		*719	40
Irlanda	4.0	26 960	10	17	1 928	193	85
Italia	****56.3	21 560	21	42	**4 123	**484	100
Letonia	2.3	4 070	50	57	2 087	528	339
Liehtenshteini	0.03						53
Lituania	3.5	4 490	41	44	2 275	571	234
Luksemburgu	0.4		15	13	5 216		111
Malta	0.4		31	25	4 345		72
Moldavia	3.6	590	113	114	864	360	297
Monako	0.03						39
Hollanda	16.2	26 310	5	10	8 215	658	123
Norvegjia	4.5	43 350	1	8	3 278	1 427	65
Polonia	38.2	5 270	37	67	3 278	577	209
Portugalia	10.4	12 130	26	27	3 616	534	128
Rumania	21.8	2 310	69	87	1 578	338	180
Federata Ruse	143.1	2 610	57	90	2 022	811	532
San Marino	0.03						0
Serbia dhe Mali i ZI	****10.7	1 910		97			92/108
Slovakia	5.4	4 920	42	57	1 642	399	164
Slovenia	2.0	11 830	27	31	3 614	358	59
Spanja	40.7	16 990	20	22	2 308	*254	139
Suedia	8.9	28 840	2	6	13 693	1 338	75
Zvicra	7.3	39 880	11	7	3 732	**971	72
"Ish Republika Jugosllave e Magedonisë"	****2.0	1 980	60	97	*976	*366	78
Turqia	69.6	2 790	88	77	712	*1 512	95
Ukraina	48.0	970	70	122	1 126	470	415
Mbretëria e Bashkuar	59.3	28 350	12	11	***	***	***
					9 817	2 684	140

- **Krimi i organizuar ndërkufitar:** Krimi i fillimeve të shekullit të njëzetë, ka qenë kryesisht i lokalizuar, që do të thotë se kriminelët i shfrytëzonin mundësitë e tyre në qytetin, apo në territorin ku jetonin. Sot, ndërsa binzeset e ligjshme po globalizohen, edhe krimi po vepron në të njëjtën mënyrë. Krimi i organizuar ndërkufitar i eksploron mundësitë njësoj si biznesi në kërkim të fitimeve, si dhe përpiket të dobësojë sistemet e kontrollit për të pakësuar rreziqet në mbarë botën. Menaxherët e organizatave kriminale janë shpeshherë të shkëputur nga

lokaliteti ku ndjehet më shumë ndikimi i veprimtarisë së tyre, prandaj janë thuajse të padukshëm.

- **Tregjet “tradicionale” të krimit:** në kohën e globalizimit gjithnjë në rritje të tregtisë së ligjshme, po ashtu kemi globalizim të tregjeve klasike kriminale, të tilla si trafikimi i drogës, i armëve, i automjeteve, i cigareve, por edhe i mallrave të tjera jo tradicionale. Duke pare asimetritë në zhvillimin njerëzor – faktorët tërheqës dhe shtytës për migracionin – qeniet njerëzore, po bëhen gjithnjë e më shumë një mall i vlefshëm për kontrabandë, trafikim, shfrytëzim për punë apo qëllime prostitucioni..
- **Krimi ekonomik i organizuar:** Mundësitë e reja për mashtrim, krim financiar, falsifikim, apo për forma të tjera të krimit ekonomik krijojnë potenciale të mëdha për fitim dhe nuk mbartin shumë rreziqe, sepse mbështeten kryesisht në dallimin jo shumë të qartë ndërmjet akvitetit financiar dhe ekonomik të ligjshëm. Në Evropën Juglindore, mashtrimet me taksat dhe doganat, mashtrimet në procesin e privatizimeve kanë më shumë rendësi nga krimi i organizuar tradicional. Kjo për faktin se impakti i krimit ekonomik ndjehet më shumë nga vetë këto shtete, sesa nga vendet e tjera, që janë larg kufijëve të tyre. Dallimi ndërmjet ndërmarrjeve të ligjshme, që përdorin mjete të paligjshme për drejtimin e bizneseve të tyre, dhe investimi i produkteve të krimit në çfarë mund të duket një akvitet ekonomik i ligjshëm, në njërin anë, dhe grupeve kriminale, të krijuara për të kryer krime ekonomike, por në një mënyra që ngajjnë me bizneset nuk është dhe aq i qartë. Investimi i të ardhurave që burojnë nga krimi në një aktivitet ekonomik të ligjshëm shpesh shoqërohet me korrupsion, që ngre shqetësime serioze përsa i takon legjitimitetit të strukturave qeverisëse.
- **Specifikat e rajonit:** Një pjesë e madhe e kapaciteteve produktive të ekonomisë u shkatërruan gjatë luftës, ose u neglizhuan rendë në vitin 1990, duke humbur njëkohësisht tregjet ndërkombëtare, që ato më parë furnizonin. “Dhjetëvjeçari i humbur” e ka theksuar më shumë rendësinë e tregtisë si me mallra të ligjshme ashtu edhe të paligjshme, duke rritur në të njëjtën kohë në mënyrë të ndjeshme, kostot e tregtisë në rajon. Rritja e tarifave të kontrabandës dhe të trafikimit ka ndjekur të njëjtën tendencë, duke ofruar terren të favorshëm për krimin e organizuar, i cili duket se është shndërruar në një prej mekanizmave kyç në rishpërndarjen në forma të paligjshme të pasurive kombëtare në rajon.¹⁹
- Ndryshimi në të drejtën e pronësisë, me anë të privatizimit ka qenë një tjetër element kyç, që ka kontribuar në krimin ekonomik, duke krijuar fenomenin e falimentimit të ndërmarrjeve të pronës shoqërore (shtetërore), dikur tepër fitimprurëse, me anë të zhveshjes së tyre nga pasuritë dhe shitjes për shuma të vogla. Kjo madje mendohet të jetë një prej arsyeve kryesore të humbjes së besimit tek institucionet shtetërore. Së bashku me humbjen e të ardhurave publike si rezultat i shmangies nga pagimi i taksave dhe doganave (evazioni fiskal dhe doganor) dhe mashtrimet me tenderat publike, mashtrimet në fushën e privatizimeve janë një prej shqetësimeve kryesore, për vendet e Evropës Juglindore.

2.3.3 Tendencat shoqërore dhe kulturore

Sikurse dhe fenomene të tjera shoqërore, krimi i organizuar ndihmohet shpesh nga disa faktorë të veçantë kulturorë dhe nga ekzistenca e disa subkulturave. Rrjetet kriminale mund të funksionojnë si një sistem shoqëror alternativ, në të cilin aktorët janë të lidhur nga përvoja e përbashkët, besimi, apo lidhjet etnike ose familjare. Rrjetet etnike mendohet se luajnë një rol domethënës në zhvillimin e krimit të organizuar ndërkufitar, sidomos në rastin kur grupet e emigrantëve nuk janë integruar plotësisht në shoqërinë e tyre të re.

¹⁹ Shih: *Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar në Evropën Juglindore* (2003) dhe *Transporti, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar, Qendra për Studimin e Demokracisë*, (2004)

Nga ana tjetër, përgjigjet që iu dhanë pyetësorit, sugjerojnë se faktori i etnisë së njëjtë po e humbet rendësinë, në disa rrjete kriminale të caktuara, të cilat shfaqin tendencën e përbërjes multietnike. Rrjetet kriminale të trafikimit të drogës në rajon janë dominuar në të shkuarën nga një etni e caktuar. Ky dominim sot, nuk është më aq evident si rezultat i larmisë së madhe të aktiviteteve që lidhen me drogën, por ende ndodh që një etni e caktuar të dominojë një pozicion të caktuar në organizatën kriminale, ndërkohë që nuk merret me aktivitete të tjera.

Një subkulture veçanërisht e paqendrueshme në raport me krimin e organizuar, duket se është dhe lidhja ndërmjet shërbimeve të sigurimit dhe kriminelëve, e cila u krijua gjatë luftës në vitet 90.20

Në raport me krimin ekonomik duket se kriminelët janë kryesisht shtetas të vendit, në të cilin kryhet krimi. Ky fakt komplikohet më tej në rajonin e Evropës Juglindore për shkak të një numri të madh të njerëzve të zhvendosur gjatë luftës (ish Jugosllavia) apo për shkak të emigracionit ekonomik (Shqipëria) gjë që jep mundësinë e nënshtetësisë së dyfishtë dhe e bën hetimin dhe dënimin e krimit ekonomik, ose identifikimin e mashtrimeve financiare akoma më shumë të varur nga bashkëpunimi rajonal.

2.3.4 Teknologjia dhe shkenca

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT) hap shumë dyer për krimin e organizuar, sepse i pajis kriminelët me mjete të reja për kryerjen e krimeve të vjetra, por i pajis ata gjithashtu me mjete dhe tregje për kryerjen e llojeve të reja të krimit.²¹ Teknologjia e re mund të ketë gjithashtu ndikim në strukturën e organizatave kriminale apo në menaxhimin e aktiviteteve kriminale, të ngjashme me strukturën e shoqërive dhe ekonomive me Teknologji informacioni të zhvilluar, që ndjekin më shumë logjikën e rrjetit se sa të një hierarchie të pastër.²² Të njëjtën structure ndjekin grupet e krimit të organizuar, të cilat demonstrojnë një structure të bazuar në rrjete.

Në kontekstin e Evropës Juglindore, ka një hendek të madh ndërmjet krimit të organizuar i cili ka mundësitë të investojë në teknologjinë e komunikimit dhe të vëzhgimit dhe organeve të zbatimit të ligjit, të cilat janë shumë të kufizuara nga pikëpamja e buxhetit. Një faktor tjetër i cili është sidmos i rëndësishëm në luftimin e pastrimit të parave, është ekonomia e bazuar në kesh. Pavarësisht modernizimit të sistemeve bankare në rajon, një pjesë e madhe e aktiviteteve ekonomike dhe e transaksioneve financiare ende kryhen me para në dorë (cash). Kjo e bën hetimin financiar shumë të vështirë.

²⁰ Shih: *Partnerë në Krim. Rreziku i Simbiozës ndërmjet Sektorit të Sigurisë dhe Krimit të Organizuar në Evropën Juglindore*, Qendra për Studimin e Demokracisë (2004) si dhe raportet e ICGsë: *Serbia: Ngjitja e saj (2005) dhe Kthimi 180 gradë i Serbisë (2004)*.

²¹ See Europol 2002.

²² Shih Castells 2003, fq. 21 mbi "lindjen e shoqërive në formë rrjeti".

3 Gjendja e krimit të organizuar

Krimi i organizuar është në pjesën më të madhe i padukshëm. Vetëm ato aktivitete kriminale të cilat analizohen dhe hetohen nën perspektivën e krimit të organizuar, dalin në dritë. Prandaj kuptimi i këtij fenomeni varet shumë nga prioritetet e zbatimit të ligjit dhe nga politikat që ndiqen kundër krimit, të cilat nga ana e tyre mbështeten në kërcënimet që perceptohen në një moment të caktuar kohor. Krimi i organizuar në Evropë dhe në Evropën Juglindore, ka forma të ndryshme dhe përfshin një shumëllojshmëri aktiviteteve kriminale. Sidoqoftë tre janë tregjet kriminale, të cilat janë të përbashkëta për shumicën e vendeve të rajonit:

- Mashtrimet, evazionet nga taksat dhe dogana, dhe forma të tjera të krimit ekonomik
- Trafikimi dhe shpërndarja e drogës
- Kontrabanda e personave
- Trafikimi i qenieve njerëzore

Trafiku i drogës vazhdon të jetë kuintesenca e krimit të organizuar në Evropë. Për dallim nga kjo, problemi në rritje i kontrabandës së personave dhe trafikimit të qenieve njerëzore si dhe perceptimi publik për to është relativisht një zhvillim i kohëve të fundit. Vendet e Evropës Juglindore kanë qenë deri më tani, vende kryesisht tranzit, dhe mjetet që ato kanë përdorur kundër trafikimit dhe kontrabandës kanë qenë të natyrës represive. Këto tregje sot po ndryshojnë: vendet kanë raportuar për një tendencë në rritje të rekrutimit lokal të grave si dhe për një rritje të tregut vendas në lidhje me shfrytëzimin seksual të tyre, gjë e cila do të kërkojë masa më efektive parandaluese në të ardhmen.

Megjithëse është një zhvillim relativisht i kohëve të fundit, krimi ekonomik (mashtrimi dhe forma të tjera) përbëjnë një shqetësim të posaçëm për vendet në rajon. Kjo ndodh për faktin se volumi dhe ndikimi ekonomik që sjell kjo formë e krimit, ndjehet më shumë nga vetë këto vende, prandaj dhe është më i dukshëm për publikun.

Meqenëse grupet kriminale mbështeten gjithnjë e më tepër në strukturat tregtare të ligjshme dhe kufiri ndërmjet strukturave të ligjshme dhe të paligjshme sa vjen e bëhet më i vështirë për t'u kuptuar, pastrimi i parave është një dukuri që përbën një sfidë gjithnjë e më të madhe për vendet evropiane. Në Evropën Jug-lindore paratë pastrohen në shumë mënyra, duke shkaktuar shqetësime lidhur me depërtimin e produkteve të krimit në ekonominë e ligjshme.

Disa tregje dhe aktivitete të tjera kriminale, të tilla si kontrabanda e cigareve, automjeteve, armëve dhe artikujve të tjerë përmenden gjithashtu në përgjigjet që i janë dhënë pyetësorit por vëmendja kryesore nuk është përqendruar tek to në këtë raport.

Identifikimi i saktë i grupeve të krimit të organizuar, mbetet një çështje shumë e vështirë, por një analizë më e mire në të ardhmen dhe një përdorim më i mire i parave, mund të ndihmojnë në kapërcimin e këtyre vështirësive. Sidoqoftë, influencimi i politikës dhe ekonomisë, kryesisht nëpërmjet korrupsionit dhe investimeve në ekonominë e ligjshme të cilat angazhojnë dhe juristë, si dhe mbështeten tek struktura të ligjshme tregtare dëshmon më shumë për një marrëdhënie harmonike (në simbiozë) ndërmjet krimit të organizuar dhe pjesës tjetër të popullsisë, sesa për një marrëdhënie konfliktuale. Shumica e kriminelëve të organizuar, janë nështetas të vendit, në të cilin hetohet krimi, por kanë mundësinë të lëvizin lehtësisht përtej kufijve, falë dhe rrjeteve apo lidhjeve, me vende të tjera në rajon apo me BE-në, duke e përforcuar edhe më shumë tezën se krimi i organizuar është ndërkufitar në natyrën e tij.

3.1 TREGJET KRIMINALE

3.1.1 Krimi ekonomik

Krimi ekonomik ka qenë një shqetësim madhor për shoqëritë evropiane për shumë dekada, por përkufizimi i saktë i tij ende paraqet disa vështirësi. Rekomandimi R(81)12 i Këshillit të Evropës, i vitit 1981²³, mbështetet në supozimin se krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një ndikim negativ për shoqërinë në përgjithësi, në kuptimin që deformon ekonominë kombëtare apo ndërkombëtare si dhe ndikon në uljen e besimit në sistemin ekonomik.

Hartuesit e parimeve Udhërrëfyese mbi krimin e organizuar kanë treguar "lidhjen e ngushtë ndërmjet krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, në veçanti korrupsionit, pastrimit të parave dhe mashtrimit".²⁴ Por, megjithatë dallimi ndërmjet krimit të organizuar dhe krimit ekonomik krijon disa probleme, në mënyrë të veçantë për shtetet në tranzicion.²⁵ Krimi i organizuar krijon kompani kriminale, me qëllim kryerjen e veprave penale edhe nëse ata investojnë më vonë në ekonominë e ligjshme. Krimi ekonomik në anën tjetër, përdor ndërmarrjet e ligjshme (kompanitë) për të kryer biznese të ligjshme, por mbështetet tek mashtrimi, monopolet, kartelet dhe korrupsioni për të qenë konkurrues në tregun e ligjshëm. Të dyja këto lloje të krimit përdorin aftësi dhe teknika të ngjashme me ato që përdorin strukturat e organizuara dhe lulëzojnë nga bashkëpunimi.

Integrimi i tregjeve financiare, përqendrimi dhe bashkimi i kompanive shumë-kombëshe dhe strategjitë neoliberale të tregjeve (rigoroziteti i sistemit fiskal, privatizimi, liberalizimi i tregut si dhe reduktimi i barrierave tregtare) i shumëfishojnë shanset për krimin e organizuar në vendet e zhvilluara, sic e tregojnë edhe skandalet e ENRON-it, WorldCom-it, Tyco-International dhe Parmalat-it. Pavarësisht se hendeku i shtrirjes së krimit ekonomik, për nga fondet që ai përdor, është tepër i madh, ndërmjet vendeve të pasura të Evropës Perëndimore dhe Europës Juglindore, faktori domethënës është impakti që ky krim ka në shoqëritë e këtyre vendeve, si pasojë e përmasave dhe natyrës së ekonomive të tyre.

Mendohet se të ardhurat nga krimi ekonomik janë të tilla sa që i errësojnë të ardhurat dhe dëmet që mund të shkaktojnë krimet e tjera. Disa prej vendeve të Evropës Juglindore humbasin deri në 30 për qind të të ardhurave të tyre publike nga krimi ekonomik. Pavarësisht kësaj, metodat për vlerësimin e humbjeve dhe të impaktit janë inekzistente, dhe shumë pak dihet për efektet e krimit ekonomik në Evropën Juglindore.

²³ Rekomandimi i Këshillit të Evropës R (81) 12 i vitit 1981 (miratuar nga Këshilli i Ministrave më 25 qershor 1981) rreshton 16 krime specifike dhe jo-specifike të cilat konsiderohen si krime ekonomike: vepra penale që lidhen me kartelet; praktikat mashtruese si dhe abuzimet me situatën ekonomike nga kompanitë shumëkombëtare; mashtrimet me tenderat apo abuzimet me grantet shtetërore ose të organizatave ndërkombëtare; krimet në fushën e kompjuterave (p.sh. vjedhja e të dhënave, thyerja e sekreteve, manipulimi i të dhënave kompjuterike); firmat fantazmë; mashtrimet me bilancet e kompanisë dhe veprat penale në fushën e kontabilitetit; mashtrimet në raport me situatën ekonomike dhe kapitalin themleor të kompanisë; shkelja nga ana e kompanisë të standardeve të sigurisë në punë dhe të shëndetit të punonjësve; mashtrimet në dëm të kreditorëve (p.sh. falimentimi, shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale); mashtrimet ndaj konsumatorëve (si p.sh. falsifikimi i produkteve, ose dhënia e përshkrimeve të rreme në lidhje me mallrat, veprat penale kundër shëndetit publik, përfitimet abuzive duke shfrytëzuar dobësinë dhe mungesën e përvojës së konsumatorëve); konkurrenca e pandershme (duke përfshirë korrupsionin e një të punësuarit të një kompanie konkurrense) dhe reklamata mashtruese; veprat penale në fushën e tatimeve, shmangja nga detyrimi i pagimit të sigurimeve shoqërore, veprat penale në fushën e doganave, (psh. mospagimi detyrimeve doganore, tejkalimi i kuotave të përcaktuara të import-eksportit, veprat penale që lidhen me paratë dhe lëvizjet valutore, veprat penale në fushën e bankave dhe të bursave, (p.sh. manipulime mashtruese me aksionet në burse dhe përfitime abuzive nga mungesa e përvojës së publikut); veprat penale kundër mjedisit.

²⁴ Shih paragrafin. 28 të Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit të Këshillit të Evropës (2000) 11.

²⁵ Nelken 2002, duke cituar Ruggeron dhe përgjigjet nga vendet.

Megjithatë vendet e Evropës Juglindore kanë raportuar për format kryesore të krimit ekonomik, që ata i quajnë sfidat kryesore:

- **Mashtrimet me taksat dhe doganat** është raportuar prej të gjitha shteteve si një prej krimeve më të mëdha. Ky lloj mashtrimi konsiston para së gjithash në krijimin e kompanive fiktive, të regjistruara nën identitet të rremë, (apo me identitet/të dhëna të falsifikuara, ose të vjedhura) të cilat përdoren për tregti dhe “zhduken” ose “falimentojnë” kur vjen koha e pagimit të taksave, konsiston në mbajtjen e dy bilanceve, si dhe në mashtrime të tjera të përbashkëta për gjithë rajonin. Skema të tilla vihen në lëvizje zakonisht nga rrjete të organizuara, të cilat regjistrojnë kompanitë, hapin llogaritë bankare, dhe organizojnë kontakte me pronarë shtetërorë ose private për shitblerje të mallrave apo shërbimeve të tyre. Celësi në këtë zinxhir aktiviteteve është prodhimi i dokumenteve dhe faturave të rreme, të cilat mund të kushtojnë deri në 3-5% të të fitimeve të tyre, një kosto kjo që është shumë here më e vogël sesa kostoja e taksave (rreth 20%), që cdo kompani e përfshirë në tregti do t’i duhej t’i paguante shtetit.²⁶

Detyrimet doganore shmangen nëpërmjet raportimit të një vlere më të ulët sesa vlera reale e mallrave të tilla si p.sh. nafta; nëpërmjet deklarimit si transit të mallrave, të cilat më vonë shiten në “tregun e zi” të brendshëm, si dhe kontrabanda e mallrave nëpërmjet kufijve. Kontrabanda e cigareve dhe e naftës në rajon e cila shkëlqeu në kohën e sanksioneve kundër Serbisë, ende vazhdon, megjithëse në përmasa më të vogla.

Suksesi në vënien nën kontroll të evazionit fiskal nëpërmjet futjes së sistemit të TVSH-së varion nga një shtet në tjetrin. Për ato shtete, që nuk kanë qenë shumë të suksesshme, mashtrimet me TVSH-në vazhdojnë dhe mbështeten përsëri në kompani fiktive, që shërbejnë si fasadë për eksport/importin e mallrave, por në fakt krijohen për mbledhjen e rimbursimeve të TVSH-së apo në formën e një tregtari të munguar në mashtrimet brenda për brenda komunitetit (MITC) të njohura me emrin karuseli i TVSH-së. Një kapërcim i tillë nga një sistem i mbledhjes së taksave (taksa/tatim mbi shitjet) në një tjetër sistem të mbledhjes së taksave (sistemi I TVSH-së) mund të shërbejë si paralajmërim i dobishëm për vendet, të cilat mendojnë ta fusin së shpejti sistemin e TVSH-së.

- **Mashtrimet me tenderat publike** – Pavarësisht tregtisë, një pjesë e madhe e aktivitetit ekonomik në rajon, mbështetet në të ardhurat publike. Kështu tenderat publike janë një treg i madh për kriminelët në të gjitha vendet e rajonit. Mashtrimet dhe korrupsioni janë të njohura dhe të përbashkëta për të gjithë rajonin, megjithatë formimi i karteleve, dhe frikësimi përdoren për të fituar kontratat e tenderave publikë.
- **Privatizimi.** Mashtrimet në fushën e privatizimit përbëjnë një shqetësim të madh për të gjitha vendet e rajonit. Zhveshja nga pasuritë të firmave që do të privatizoheshin, për të shkaktuar falimentimin e tyre si dhe aktivitete të tjera janë të lidhura ngushtë me korrupsionin në sektorin publik. Efektet e këtyre mashtrimeve janë humbjet në kapacitetet productive si dhe e vendeve të punës.²⁷ Përveç kësaj subvencionet shtetërore (për shembull fondet që u akordohen bashkive, huatë qeveritare, për kompanitë që janë me humbje) po ashtu janë subjekt krimi, duke përfshirë në një shkallë të madhe, nëpunësit civilë, politikanët dhe menaxherët e kompanive.

Megjithëse problemet e privatizimit lidhen ngushtësisht me tranzicionin e këtyre vendeve drejt një ekonomie tregu dhe nuk është se lidhen detyrimisht me krimin e organizuar, (krimin ekonomik), ka një konsensus të përgjithshëm ndërmjet shteteve, se krimet në fushën e privatizimeve, përbëjnë një sfidë unike për organet e zbatimit të ligjit dhe për gjyqësorin.

²⁶ Të gjitha vendet e rajonit, me përjashtim të Bosnjë Hercegovinës e kanë futur sistemin e TVSH-së.

²⁷ Megjithëse privatizimi i një kompanie mund të kërkojë reduktimin e numrit të punonjësve, qoftë për të rritur rendimentin e saj, qoftë nëse kompania ndryshon qëllimin e vet (mënyra të ligjshme) shtetet kanë shprehur shqetësimet e tyre, mbështetur në rastet e hetuara.

Shtetet kanë përshtypjen se besimi i publikut tek institucionet do të ndikohet së tepërmi nga rezultati i hetimeve komplekse të cilat do të godasin interesa të fuqishme politike dhe ekonomike që lidhen me fushën e privatizimeve.

- **Mashtrimet me bankat** – Reformat e institucioneve financiare që ende vazhdojnë, ofrojnë një game të gjerë mundësish për krimin e organizuar ekonomik. Për shembull, mënyrat e abuzimit me bankat apo me shoqëritë e kursimeve/të kredive janë të tilla: duke marrë kredi me një interes më të ulët, dhe dhënia e kësaj shume po prapë me kredi, por, me interes më të lartë; kreditë bankare merren duke përdorur dokumente të falsifikuara; kreditë përdoren jo për qëllimet, të shprehura në fillim; falsifikohen kartat e kreditit, etj. Reformat e papërfundara në fushën e bankave dhe mungesa e zbatimit të rregulloreve, kontribuojnë në dobësimin e mëtejshëm të sistemit bankar.
- **Falsifikimi i produkteve të ligjshme.** Falsifikimi i produkteve të ligjshme, të tilla si paratë, cigaret, produktet ushqimore dhe alkolike, si dhe produktet për zbavitje (CDtë dhe DVDtë) janë një biznes i organizuar, që kryhet nga sipërmarrës ndërkombëtarë dhe rajonalë, të cilat janë një formë tepër fitimprurëse e krimit të organizuar, në bazë të asaj që është raportuar nga Shqipëria, “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, dhe Kosova. Këto vende kanë raportuar se artikuj të tillë si produktet ushqimore dhe cigaret falsifikohen kryesisht për të përmbushur nevojat e tregjeve vendas dhe tregut rajonal.
- **Mashtrimet kundër interesave të Bashkimit Evropian** – Me shfaqjen e trajtimit tregtar preferencial dhe të kuotave të eksportit për në BE, janë vënë re abuzime me eksportin e sheqerit nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia në drejtim të BE-së.²⁸

Kur bëhet fjalë për të dhënat mbi krimin, shtetet ndryshojnë nga njëra-tjetra, në lidhje me mënyrën e numërimit të çështjeve që përfshijnë krimin e organizuar dhe krimin ekonomik. Për këtë raport, shtetet, me përjashtim të Malit të Zi, kanë raportuar të dhëna mbi krimin e organizuar, dhe jo statistikatat në tërësi për vitin 2004. Mbi bazën e pyetësorëve të paraqitur mund të bëhen pohimet e mëposhtëme:

- Krimi ekonomik, përfshin një numër të konsiderueshëm të rasteve që kanë lidhje me krimin e organizuar. Shqipëria ka raportuar 17 raste të regjistruara dhe të dënuara, ndërkohë që Kroacia ka regjistruar 14 raste të krimit të organizuar ekonomik, 12 prej të cilave i kishte nën hetim, kurse 3 i kishte dënuar.²⁹ “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” ka raportuar vetëm për 8 raste të krimit ekonomik që mund të llogariten si krim i organizuar, dhe të gjitha këto raste i ka nën hetim. Shifrat që ka raportuar Mali i Zi, dëshmojnë për total prej 1707 rastesh të regjistruara të krimit ekonomik, prej të cilave disa prej tyre i përkasin krimit të organizuar,³⁰ duke shkaktuar një total humbjesh prej 17.2 milionë eurosh në vitin 2004, që dëshmon për një rritje të lehtë në krahasim me 16.51 milionë Euro, të humbura në vitin 2003, ndërkohë që Serbia humbet në çdo vit përafësisht 300-500 milionë euro, si pasojë e krimit ekonomik.³¹ Kosova ka raportuar 4968 raste si shifër të përgjithshme të rasteve të regjistruara të krimit ekonomik, prej të cilave vetëm 3 kishin lidhje me krimin e organizuar. Bosnja dhe Hercegovina, sipas të dhënave, humbet rreth 2.5 miliardë euro në vit nga krimi i

²⁸ Shih njoftimin për shtyp të OLAF-it: *Olafi Heton për Importet e Sheqerit nga Rajoni i Ballkanit*, OLAF /15/2003, 29 Maj 2003, europa.eu.int/olaf; *Serbia: Bashkimi Evropian mund t'i Shtojë Ndalimet për Sheqerin*. IWPR/BCR, Nr 445, 18 korrik 2003 dhe Komunikata për Shtyp e Delegacionit të Komisionit Evropian për Bosnjë Hercegovinën: *Mashtrim I Mundshëm me Sheqerin*, Sarajevë, 2 gusht 2004.

²⁹ Me përjashtim të Malit të Zi, vendet kanë raportuar në pjesën më të madhe për krimet ekonomike që kishin lidhje me krimin e organizuar, që nuk do të thotë se i kanë përfshirë të gjitha rastet e krimit ekonomik. Prej këtyre shifrave që paraqiten këtu për krimin ekonomik mund të jenë jo shumë të sakta.

³⁰ Koncepti “krim i organizuar”, i cili është futur në prill të vitit 2004, nuk ka ekzistuar në legjislacionin e Malit të Zi, në kohën kur rastet e krimit të organizuar që janë përmendur, janë regjistruar. Fakti nëse në ndonjë prej rasteve të regjistruara demonstrohej ndonjë shkallë organizimi nuk ishte subjekt i kualifikimit juridik.

³¹ Nga intervistat me zyrtarë të zbatimit të ligjit, shtator 2004.

organizuar ekonomik. Numri i çështjeve që janë ndjekur penalisht në vitin 2003 ka qenë 941, dhe ai i vitit 2004 (907), prej të cilave kanë përfunduar me dënime respektivisht 298 me 435 kriminelë në vitin 2003 dhe 168 dënime me 212 kriminelë në vitin 2004. Numri i organizatave kriminale, që janë të përfshira në krimin ekonomik nuk bëhet i ditur.³²

- Një numër i madh i grupeve të krimit të organizuar, janë të përfshira në krimin ekonomik. Në Shqipëri janë regjistruar 17 grupe të tilla, me 52 të dyshuar të përfshirë në total.³³ Në Kroaci janë regjistruar 14 grupe kriminale dhe një total prej 93 të dyshuarish, nga të cilat janë hetuar 10 grupe (11% e numrit total të grupeve të krimit të organizuar të regjistruara) dhe një total prej 63 të dyshuarish (17% e numrit të përgjithshëm të grupeve të krimit të organizuar, të hetuara). “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” ka raportuar për 8 grupe të përfshira në krimin ekonomik (17% e numrit të përgjithshëm të grupeve të krimit të organizuara, të hetuara), ndërkohë që Mali i Zi, nuk ka asnjë të dhënë në këtë drejtim. Kosova ka raportuar se 4% e grupeve të krimit të organizuar, të regjistruara janë të përfshira me krimin ekonomik (total prej 3 grupesh), ndërkohë që në Serbi 13% e të gjitha grupeve të krimit të organizuara janë të përfshira në krimin ekonomik (një total prej 12 grupeve) që shkon deri në 21% e grupeve të hetuara apo të ndjekura penalisht (në total 47 grupe). Me përjashtim të Kroacisë, e cila ka deklaruar se ka patur 3 dënime për raste të krimit të organizuar ekonomik dhe 19 dënime për raste të krimit të organizuar në përgjithësi si dhe Bosnjë Hercegovinës me 4 dënime për 6 kriminelë të përfshirë në krimin e organizuar, asnjë vend tjetër në rajon nuk ka deklaruar për dënime të rasteve të krimit të organizuar në vitin 2003 apo në vitin 2004.
- Pavarësisht dallimeve sipas vendeve, krimi ekonomik në Ballkan ka natyrë në thelb rajonale dhe lulëzon vetëm nëse është ushqyer më pare nga lidhje të ngushta rajonale. Të gjitha vendet besojnë se krimi ekonomik përbën një kërcënim serioz për ekonominë dhe shoqëritë e tyre. Një prej arsyeve për këtë kërcënim është se impakti i krimit ekonomik ndjehet kryesisht nga vetë këto shtete, gjë që nuk vlen detyrimisht edhe për llojet e tjera të krimit të organizuar, të tilla si trafiku i drogave, kontrabanda e personave, etj, impakti i të cilave ndjehet në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera.
- Jo vetëm që krimi ekonomik është në vetvete shkaktar i humbjeve të mëdha të të ardhurave publike dhe i deformimit të tregut të ligjshëm, por ai gjithashtu shkatërron dhe besimin në sistemin ligjor dhe ekonominë e ligjshme. Në Kroaci, por edhe në vendet e tjera, ka shumë shpresa në publik, se do të ndërmerren masa kundër mashtrimeve në fushën e privatizimeve, apo mashtrimeve, që lidhen me përfitime nga burimet bregdetare, shumë fitimprureëse. Mungesa e masave të tilla mund të minojë besimin e publikut tek sistemi.³⁴
- Lidhjet ndërmjet krimit ekonomik dhe krimit të organizuar janë dukshëm të mbështetura tek korrupsioni, në të dyja nivelet, të lartë apo të ulët. Rryshfetet dhe praktika të tjera korruptive që përdoren për regjistrimin e kompanive si dhe të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, procedurat e caktimit të tenderave, transportimit të mallrave përtej kufijve, pagesa e gjyqtarëve dhe e prokurorëve për rikualifikim apo rrëzim të akuzave, trafiqet e influencës në privatizime, dhe praktika të tjera të panumërta përdoren për të realizuar të dyja këto forma të krimit. Vendet shprehin një shqetësim të madh lidhur me rritjen e pushtetit dhe të ndikimit që krimi i organizuar ushtron mbi strukturat legjitime të qeverisjes dhe mbi shoqërinë, duke e përshkruar atë si kërcënimin e vetëm dhe më seriozin që bashkon të gjitha aspektet e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik.

³² Të dhënat e raportuara nga Bosnja dhe Hercegovina përfshijnë të dhëna vetëm nga Republika Srpska dhe jo ato të Qarkut Brcko apo të Federatës së Bosnjë Hercegovinës.

³³ Nuk ka qenë e mundur që të jepej një vlerësim rreth përqindjes së grupeve të krimit të organizuar, të përfshira në krimin ekonomik.

³⁴ Përgjigjet që janë dhënë nga Kroacia për pyetëtorin si dhe intervista me zyrtarë kroatë të zbatimit të ligjit, shtator, 2004.

3.1.2 Trafiku i Drogës

Sistemi i kontrollimit të drogave ndërkombëtare mbështetet në tre Konventa të Kombeve të Bashkuara,³⁵ të cilat e kufizojnë përdorimin e disa qindra substancave psikoaktive vetëm për qëllime mjekësore dhe shkencore. Abuzimi me këto substanca – para së gjithash me opiate (duke përfshirë heroinën), kanabisin, kokainën, dhe stimulantët e tipit amfetaminë (ATS, që përfshijnë ekstazinë, amfetaminën dhe stimulantë të tjerë sintetikë) – përbën një shqetësim global. Besohet se sot, 200 milionë njerëz, në mbarë botën (ose 5% e popullsisë globale) përdorin drogën.³⁶ Edhe pse shumica e përdoruesve të drogës jetojnë në vendet e zhvilluara, Evropa mendohet se është tregu më fitimprurës për drogat, në mbarë botën, si për nga fuqia blerëse ashtu edhe për nga numri i përdoruesve të drogës.

Pothuaj krejt heroina e cila konsumohet në Evropë mbështetet në opiumin e Afganistanit, dhe në këtë drejtim, "Itinerari Ballkanik" vazhdon të jetë kanali kryesor për trafikimn e tij. Grupet kriminale shqiptare (nga Shqipëria, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), thuhet se luajnë një rol kyç në shpërndarjen dhe shitjen me shumicë të heroines në Evropë.³⁷

Kokaina prodhohet nga gjethet e coca-s që kultivohen në Amerikën Latine, dhe megjithëse fillimisht ajo është e destinuar për kontinentin amerikan (të dy Amerikat), një pjesë e madhe trafikohet gjithashtu në Evropë, nëpërmjet Spanjës dhe Holandës, ndërkohë që në Evropën Juglindore kokaina transportohet nëpërmjet porteve të Detit Adriatik si dhe nëpërmjet rrugëve tokësore edhe nga Veriu edhe nga Jugu.

E vetmjadrogë që prodhohet në Evropën Juglindore është kanabisi dhe me përjashtim të Shqipërisë, e cila duket se është një vend eksportues, vendet e tjera shënojnë një shkallë të ulët të prodhimit të kanabisit, kryesisht për konsum të brendshëm.

Përsa i takon ATSve (stimulantëve të tipit amfetaminë), Kina, Mianmari dhe Filipinet janë vendet kryesore burimore. Prodhimi i metamfetaminës në Evropë, mendohet se është i përqendruar në Republikën Çeke. Megjithatë, vendet kryesore të origjinës së amfetaminës në botë, janë vendet evropiane, vecanërisht, Holanda, Polonia, Bullgaria dhe Lituania, ndërkohë që Holanda është vendi i pare në botë, nga ku prodhohet ekstazia. Gjithashtu, duket se ka një tregti në rritje të prekursorëve kimikë, që kalon nëpërmjet Ballkanit, e cila ka si qëllim ose prodhimin e drogave jashtë rajonit, ose shënon përpjekjet e para për prodhimin e drogave në këtë rajon.

Raportet dhe të dhënat më të fundit sugjerojnë se ekzistojnë tendencat dhe çështjet e mëposhtëme:

- Përsa i përket kërkesës, Evropa është ndoshta tregu më fitimprurës në të gjithë botën. Afërsia me një treg të tillë dhe rëndësia e "Itinerarit Ballkanik" janë faktorë që dëshmojnë se trafiku i drogave do të vazhdojë të jetë në qendër të vëmendjes së organeve të zbatimit të ligjit, edhe në të ardhmen.
- Brenda Bashkimit Evropian (BE 25), nga 1.2 deri në 2.1 milionë njerëz të grup moshave prej 25 vjeç deri në 64 vjeç, mendohet se janë përdorues problematikë të drogës³⁸. Nga këta, një shifër prej 0.85 deri në 1.3 milionë personash janë përdorues shiringash (e injektojnë drogën). Ndërkohë që numri i vdekjeve që lidhen me drogën është në rënie në Bashkimin Evropian, në disa prej vendeve të reja anëtare të BE-së si dhe në disa vende të tjera evropiane – duke

³⁵ Konventa e Vetme mbi Drogat Narkotike, (1961), Konventa mbi Substancat Psikotrope (1971) si dhe Konventa kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Substancave Psikotrope (1988).

³⁶ Natyrisht që këto shifra i referohen përdorimit të shumëhershëm të drogës. Të dhënat sipas UNDOC të vitit 2004, fq. 8. Ndërkohë që vetëm 3% e popullsisë përdor drogat që janë nën kontrollin ndërkombëtar, rreth 30% e popullsisë globale përdor duhanin.

³⁷ UNODC(2004), faq. 71

³⁸ Shih EMCDDA 2004. "Përdorues problematikë të drogës" nënkupton "përdorimin e drogës nëpërmjet injeksionit, ose një përdorim të zgjatur/të rregullt të opiateve, kokainës dhe/ose amfetaminës".

përfshirë Estoninë, Letoninë, Federatën Ruse dhe Ukrainën – lidhja ndërmjet përdorimit të drogës me anë të shiringës dhe HIV/SIDA, është tepër shqetësuese.

- Në Evropën Juglindore, të dhënat për abuzimin me drogat janë të rralla dhe të vjetëruara. Për ato vende ku të dhënat ekzistojnë, Kroacia ka numrin më të madh të përdoruesve të drogës, që shkon deri në 0.7 % të popullsisë të moshës ndërmjet 15 deri në 64 vjeç. Ajo ndiqet nga Shqipëria me 0.5 % të popullsisë dhe nga “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” me 0.4% të popullsisë përdorues të derivateve të opiumit (heroinës). Në drejtim të abuzimit me kokainën, Kroacia kryeson me 0.2%, ndaj “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” me 0.01%. Kanabisi mendohet të jetë droga më e përdorur, me 3.9% e popullsisë e moshës nga 15 deri në 34 vjeç në Kroaci, përdorues të kanabisit, 2.6% e popullsisë në Shqipëri (e moshës 15-24 vjeç) si dhe perqindja më e ulët e përdoruesve të kësaj substance gjendet në “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” me 0.7% të popullsisë. Të dhënat për përdorimin e amfetaminës në Kroaci janë të vitit 1997, dhe arrijnë shifrën e 0.3% të popullsisë, ndërkohë që të dhënat që vijnë nga “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” të vitit 1995, janë akoma më të papërfillshme, dhe tregojnë për 0.01 % e popullsisë. Në përfundim, të dhënat mbi përdorimin e ekstazisë janë 0.5% për Kroacinë dhe 0.3% për “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.³⁹ Në krahasim me vendet e tjera të Evropës Lindore, Kroacia renditet në mes, ndërkohë që “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” renditet poshtë përsa i takon abuzimit me drogat.

Megjithatë, sipas përgjigjeve që vendet i kanë dhënë pyetësorit, tregjet e drogës si dhe abuzimi me drogat është një problem në rritje për të gjitha këto vende.⁴⁰ Sipas tendencës së vëzhguar, do të duhet të punojnë për t’iu përgjigjur rritjes së tyre.

- Trafiku i drogës konsiderohet një prej aktiviteteve më të rëndësishme të grupeve të krimit të organizuar në Evropë. Duke pasur parasysh rëndësinë e “Rrugës Ballkanike” e cila kalon nëpër të gjitha vendet e rajonit, trafiku i drogës përbën edhe problemin kryesor të këtyre vendeve. Shifrat që flasin për sekuestrimin e drogës i konfirmojnë hipotezat mbi tregjet e drogës, rrugët kryesore të trafikimit si dhe rolin e grupeve të krimit të organizuar (shih tabelën më poshtë).
- Kultivimi i opiumit popi vazhdon të përhapet në Afganistan, duke treguar se përpjekjet post-talibane nga komuniteti ndërkombëtar për të kontrolluar drogat kanë qenë të pasuksesshme. Kjo ka një ndikim të konsiderueshëm në Evropë dhe në Ballkan, jo vetëm përsa i përket mundësive të së heroinës por edhe për sigurinë dhe stabilitetin si dhe për besueshmërinë e bashkësisë ndërkombëtare në përpjekjet e saj për të rindërtuar shoqëritë e dobëta të pasluftës, të tilla si në Afganistan, Kosovë dhe Bosnjë Hercegovinë.

³⁹ Të dhënat për Kroacinë (1999), “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” (viti 1999 për përdorimin e heroines dhe të ekstazisë dhe 1998 për përdorimin e kanabisit), ndërsa për Shqipërinë të dhënat për përdorimin e heroines janë të vitit 2000, për përdorimin e kanabisit janë të vitit 2001 dhe janë marrë nga Raporti mbi Drogat Botërore të UNDOC të vitit 2004. Nuk ka asnjë të dhënë tjetër të disponueshme për vendet e tjera të rajonit.

Kapja e Drogës në Rrugën Ballkanike në periudhën ndërmjet viteve 1998 dhe 2004/në kg dhe njësi

Vendi	Droga	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004*
Shqipëria	Heroina	--	7.122	47.000	4.500	71.714	114.475	155.925
	Kokaina	-	2.159	4.000	0.266	0.006	1.286	2.4
	Bimë kanabisi	-	4395.156	6604.0	6915.0	13717.899	7760.170	4544.154 (marihuanë) 73757(bimë)
	Rrënjë kanabisi	-	-	-	-	-	-	1.185
	Ekstazi	-	-	-	-	-	-	10 u
	Amf.	-	0.009	-	-	10 u	50 u	-
	Bosnja dhe Hercegovina	Heroinë	0.686	1.125	0.375	1.900	3.265	-
	Kokainë	0.005	-	164.392	-	0.240	-	-
	Bimë kanabisi	53.815	59.144	127.982	467.585	919.545	-	168.192
	Rrënjë kanabisi	-	0.002	-	0.060	-	-	-
	Ekstazi	-	-	-	-	1212 u	-	-
	Amf.	-	-	-	-	117.000	-	-
Kroacia	Heroinë	50.09	13.230	7.041	19.569	46.359	85.727	-
	Kokainë	6.426	1.807	913.127	1.487	3.365	380.769	-
	Bimë Kanabisi	20342.877	200.898	797.501	737.911	608.070	435.037	-
	Rrënjë kanabisi	2.878	6.555	1.041	4.559	2.107	2.281	-
	Ekstazi	-	15421 u	9979 u	12906u	110632u	29840u	-
	Amf.	0.765	1.110	2.124	0.931	28.026	3.814	-
	(kg dhe njësi)	9106 u	15429 u	-	-	-	-	-
"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"	Heroinë	91.672	14.375	90.789	110.882	28.572	66.145	242.000
	Kokainë	0.040	2.955	4.689	5.860	0.342	0.342	0.131
	Bimë kanabisi	1136.752	698.098	1333.399	99.115	29.234	180.681	550.000
	Rrënjë kanabisi	1.164	0.089	427.519	309.846	258.406	423.564	-
	Ekstazi	787 u	5532 u	280 u	45 u	0.002 kg 18 341 u	-	-
	Amf.	-	-	-	-	7.015	-	-
Serbia dhe Mali i Zi ⁴¹	Heroinë	-	-	-	62.518	43.462	278.760	-
	Kokainë	-	-	-	3.723	1.962	6.021	10.000
	Bimë Kanabisi	-	-	-	1230.224	1729.501	1464.955	-
	Rrënjë kanabisi	-	-	-	4.534	6.814	1.113	-
	Ekstazi	-	-	-	0.079 kg 10811 u	10 000 u	0.060kg	2000000
	Amf.	-	-	-	0.087	-	96816 u	-

⁴¹ Për informacion më të detajuar lidhur me aktivitetet e trafikimit të drogës në Mal të zi dhe Kosovë shih sektorin që flet për Profilët e Shteteve.

Bullgaria	Heroinë	219.632	265.249	2067.201	1550.629	535.09	778.637	784.000
	Kokainë	685.585	17.010	4.333	12.752	35.282	8.884	-
	Bimë kanabisi	1527.562	29365.00	295.947	183.061	1308.970	689.051	113.000
	Rrënjë kanabisi	0.680	0.010	514.017	422.584	88.476	384.509	-
	Ekstazi	-	-	4524 u	7.900 kg	1.500 kg	1097 u	-
	Amf.	150 u	87.129kg	209.930	64.676	173.950	587.408	-
Turqia	Kg dhe njësi		22928 u	18491	760	145347	140688	
	Heroinë	4651.486	3862.472	6337.747	3998.880	2582.676	4704.736	8900.000
	Kokainë	604.880	13.153	8.444	2.010	7.734	2.833	206.000
	Bimë kanabisi	9295.822	9009.040	28637.130	10096.848	5462.376	6959.763	-
	Rrënjë kanabisi	9349.290	2060.258	71.000	268.277	1220.725	863.551	-
	Ekstazi	3559 u	-	33894 u	121508 u	98989 u	473240u	-
Sllovenia	Amf.	479403 u	1231964u	295037u	1090486u	9063992u	5375197u	-
	Heroinë	46.106	32.270	392.065	88.930	68.670	150.173	-
	Kokainë	3.522	1.580	0.098	1.080	55.380	1.610	-
	Bimë kanabisi	2772.604	249.156	3413.025	177.880	1099.940	219.570	-
	Rrënjë kanabisi	1.958	64.622	1.022	2.360	0.120	0.590	-
	Ekstazi	4496 u	1749 u	0.053 kg 27 974 u	1852 u	7877 u	2847 u	-
	Amf.	0.679 kg 534 u	0.652 kg 818 u	0.218 kg 28546 u	0.664 kg 98 u	0.030 kg 390 u	373 u	-

*Të dhënat për vitet 1998-2004 janë marrë nga Raporti mbi Drogat Botërore të UNODC-së. Të dhënat për vitin 2004 janë marrë nga *Raporti mbi Strategjinë e Kontrollit të Narkotikëve Ndërkombëtarë*, të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, të viteve 2003 dhe 2004, me përjashtim të Shqipërisë, e cila ka dhënë statistikat e veta.

SHENIM: Kosova ka raportuar të dhënat e veta për kapjen e drogave, të cilat ndoshta nuk janë marrë parasysh në raportin e UNODC, që është paraqitur për Serbinë dhe Malin e Zi. Në periudhën qershor-dhjetor 2003, 38 kg heroine u kapën në Kosovë, ndërkohë që 24 kg dhe 28 kg heroine u kapën respektivisht në Itali dhe Bullgari, si rezultat i po këtyre hetimeve. Në vitin 2004, 45.5 kg heroine u kap në Kosovë, ndërkohë që 504.5 kg heroine është kapur në Austri, Gjermani, Itali, Zvicër, Serbi, Bullgari dhe Shqipëri si rezultat i hetimeve të trafikantëve të drogës të Kosovës.

3.1.3 Trafikimi i qenieve njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore ka pushtuar axhendën e qeverive të shumë vendeve Evropiane për shumë vite. Kjo reflektohet ndër të tjera në ratifikimin e “Protokollit të Trafikimit” të Konventës së Palermos⁴² nga 40 vende evropiane deri në qershor të vitit 2005 dhe në përpunimin e Konventës së Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në kuadër të Këshillit të Evropës. Po ashtu, vetë vendet e Evropës Juglindore I kanë përqendruar përpjekjet e tyre mbi këtë çështje.

Në dallim nga koncepti i kontrabandës së emigrantëve, i cili fokusohet tek kalimi i paligjshëm i kufirit, trafikimi i qenieve njerëzore ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut të individit, nëpërmjet shfrytëzimit të tij, që shpeshherë realizohet nga rrjetet ekrimit të organizuar.⁴³ Prandaj, kjo çështje lidhet më shumë me mbrojtjen e viktimave dhe të drejtave të tyre se sa me politikatat e migrimit, si dhe me dënimin e trafikantëve dhe të ortakëve të tyre.

Trafikimi i qenieve njerëzore shpesh bëhet nga organizata kriminale, të cilat përdorin kërcënimin, dhunën, detyrimin, mashtrimin, gënjeshtërinë, apo mënyra të tjera. Trafikimi përfshin një zinxhir veprimesh të veçuara, por të ndërlidhura, me njëri-tjetrin, të tilla si rekrutimi, transporti, strehimi dhe shfrytëzimi, i cili nuk është një ngjarje që ndodh vetëm një here, por kryhet për një periudhë të caktuar kohe. Grupet e krimit të organizuar shfrytëzojnë mundësitë e tregut për shërbime seksuale dhe krahun e lire të punës nga njëra anë, (kërkesën) si dhe situatën e vështirë dhe të prekshme të grave dhe fëmijëve në shumë vende në anën tjetër (oferta). Për më tepër, ato llogarisin të kenë fitime të mëdha dhe një rrezik relativisht të ulët për kontroll dhe dënime.

Duke pasur parasysh rëndësinë e Rrugës Ballkanike për trafikimin dhe kontrabandën e mallrave të ndryshme që kërkohen në tregjet evropiane, nuk përbën surprisë fakti që një numër i madh i grave të trafikuar, kalojnë nëpërmjet kësaj rruge.

Biznesi i trafikimit, funksionon në mënyrë tipike sipas mënyrës së mëposhtme:

- **Rekrutimi:** Gratë u përgjigjen njoftimeve dhe reklamave, që shfaqen në gazeta apo në Internet dhe që kërkojnë dado fëmijësh (bejbisiter), modele, parukiere, kërcimtare, kamariere, etj. Ato gjithashtu rekrutohen ose inkurajohen “të gjejnë punë në Perëndim”, nga miq apo të afërm të tyre.⁴⁴
- **Mashtrimet me identitetin:** Transporti dhe dokumentet rregullohen nga grupet e krimit të organizuar.
- **Detyrimi për të shlyer borxhin:** Dokumentet e identitetit shpesh konfiskohen në çastin e mbërritjes dhe grate ballafaqohen me një borxh të madh, që i detyrohen trafikantëve për transportin, i cili duhet të shlyehet me anë të prostitucionit.
- **Shtrengimi:** Dhuna përdoret mjaft shpesh për t’i detyruar gratë të merren me prostitucion. Ekzistojnë raportime të shumta për gra të mbajtura në izolim, të rrahura, të përdhunuara, të droguara, me qëllim “thyerjen” e tyre dhe për t’i detyruar të shkonin të punonin. Kërcënimet për familjen përdoren gjithashtu për këtë qëllim.

⁴² Protokollit për Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, vecanërisht të Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar, miratuar nga rezoluta A / RES / 55/25 e datës 15 nëntor 2000, në sesionin e pesëdhjetë e pestë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

⁴³ Sipas Nenit 3 (a) të Protokollit: Trafikimi i personave nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave, duke përdorur kërcënimin ose dhunën apo forma të tjera të shtrengimit, të rrëmbimit, gënjeshtërisë, mashtrimit, abuzimit me pushtetin, apo me pozitën e tij të dobët, apo në këmbim të marrjes ose dhënies së pagesës, apo përfitimeve, kundrejt një personi, që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e këtij të fundit. Shfrytëzimi përfshin si minimum, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën apo shërbimet e detyruara, skllavërinë, ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë apo heqjen e organeve”.

⁴⁴ Sipas një sondazhi të kryer në Serbi, rreth 64% e rekrutuesve janë persona të njohur (Nikolic-Ristanovic 2004)

- **Shfrytëzimi i vazhdueshëm:** Viktimat ri-shiten ose shkëmbehen ndërmjet grupeve kriminale dhe vendeve të ndryshme, me qëllim që të garantohet ekzistenca e “mallit të freskët” në treg, të parandalohet gjurmimi, dhe të çorientohet viktimja, për të mos e lejuar të vendosë kontakte që mund ta ndihmojnë të arratiset.

Trafikimi i qenieve njerëzore ka qenë një problem i madh për Evropën Juglindore, për njëfarë kohe. Ky rajon është përdorur si rrugë tranzitore dhe si një vend destinacioni dhe gjithnjë e më tepër si një vend origjine. Ndërkaq, afërsia me vendet e tjera të origjinës, si p.sh. Moldavinë, Rumaninë, Ukrainën, nga njëra anë, por edhe me vendet e Bashkimit Evropian, të tilla si Greqia dhe Italia, në anën tjetër, u ka dhënë mundësinë rrjeteve kriminale të trafikimit, nga Shqipëria, Kosova, Bosnja, Serbia dhe “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” të bashkëpunojnë ngushtë me njëri tjetrin.

Prezenca ndërkombëtare në Kosovë dhe në Bosnjë Hercegovinë – e përafërsisht 20 000 trupave të KFOR-it dhe 7 000 trupave të EUFOR-it në Bosnjë Hercegovinë,⁴⁵ dhe më tepër se 250 organizata ndërkombëtare dhe OJF – fillimisht krijuan një kërkesë të konsiderueshme për shërbime seksuale në fund të viteve 90 dhe në fillim të viteve 2000, duke e kthyer Kosovën dhe Bosnjë Hercegovinën në një zone destinacioni për grate e trafikuar.⁴⁶ Deri në janar të vitit 2004, lista e UNMIK-ut me baret dhe firmat të konsideruara si “të ndaluara” për stafin e UNMIK-ut dhe të KFOR-it, për shkak se disa prej tyre dyshoheshin për përfshirje në trafik⁴⁷ u rrit nga 18 në fund të vitit 1999, në 75, në janar të vitit 2001 dhe më shumë se 200, në janar të vitit 2004.⁴⁸ Në Bosnjë dhe në Kosovë, shumë prej ambjenteve publike ku ofroheshin shërbime seksuale u mbyllën si rezultat i përpjekjeve të organeve të zbatimit të ligjit dhe klientela e huaj e trupave të huaj, u reduktua si pasojë e politikës së “ndalimit”.⁴⁹ Ky mund të ketë qenë një faktor që ka ndikuar për kapërcimin nga klientela e huaj tek klientela vendase. foreign troops thanks to “off-limits” policy.⁵⁰ This may have been a contributing factor to the shift from international to domestic clientele.

Përgjigjet që iu dhanë pyetësorit sugjerojnë se:

- Në Shqipëri, 24 grupe kriminale, të përfshira në trafikim u dënuan në vitin 2003, ndërkohë që gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2004, 13 grupe kriminale janë çmontuar dhe janë rregjistruar

⁴⁵ Në periudhën e viteve 1996-2004, trupat e SFOR-it arritën në 12 000 në vitin 2003, nga 32 000 që ishin në fillim. Trupat aktuale të EURFOR-it arrijnë shifrën 7 000. Në vitin 1999, KFOR-i kishte 46 000 trupa në Kosovë (<http://www.nato.int/kfor/kfor/about.htm>). Në vitin 2004, KFOR-i kishte përafërsisht 20 000 trupa në Kosovë (Amnesty International - <http://web.amnesty.org/library/index/ENGEUR050022004>).

⁴⁶ Shih komunikatën për shtyp të Amnesty International - *Kosovo: Trafficked women and girls have human rights*, (Kosovë - Gratë dhe vajzat e trafikuar kanë të drejta të njeriut) të datës 5 qershor 2004 (<http://news.amnesty.org/mavp/news.nsf/print/ENGEUR700122004>) dhe *Kosovo: International peacekeepers fuelling explosion in sexual exploitation, trafficking and human misery*, (Kosovë: Paqeruajtësit Ndërkombëtarë i hedhin benzinë shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe mjerimit njerëzor), date 6 maj 2004;

Human Rights Watch Hopes Betrayed: Trafficking of women and girls to post-conflict Bosnia and Herzegovina for forced prostitution, (Shpresat e tradhëtuara të Rojes së të Drejtave të Njeriut: Trafikimi i grave dhe vajzave në Bosnjë Hercegovinë e pas-konfliktit për prostitucion të detyruar) Vëll 14, Nr 9, Nëntor 2002; si dhe *Kosovo UN troops 'fuel sex trade'*, (Trupat e Kombeve të bashkuara në Kosovë “i hedhin benzinë tregtisë së seksit”) lajmet e BBC, 5 qershor 2004, news.bbc.co.uk/go/pr/fr/-/2/hi/europe/3686173.stm.

⁴⁷ Vendet e “ndaluara” përfshijnë gjithashtu edhe ambiente që konsiderohen të pasigurta për personelin e UNMIK-ut në përgjithësi, dhe jo vetëm ato që dyshohen për përfshirje në trafikimin e grave. Intervistë me një zyrtar të UNMIK-ut, korrik 2005.

⁴⁸ Një prej arsyeve se përse numri i bareve në listen e “të ndaluarave” është rritur në mënyrë kaq të ndjeshme mund të gjendet edhe tek krijimi i Njërive të UNMIK-ut për Hetimin dhe Dënimin e Trafikimit (TPIU-të) në vitin 2001 dhe interesi në rritje që tregojnë Kombet e Bashkuara për luftimin e trafikimit. Mund të kenë qenë më tepër se 18 bare, në vitin 1999, të cilat dyshoheshin se ishin përfshirë në trafikim dhe prostitucion, por nuk kishte reparte të policisë që t'i përkushtoheshin luftimit të këtyre krimeve. Numri i vendeve “të ndaluara” mund reflektojë në mënyrë të përafërt rritjen e ritmeve të trafikimit dhe të prostitucionit. *Raport i fundvitit* i Njërive të UNMIK-ut për Hetimin dhe Dënimin e Trafikimit (TPIU), Amnesty International (2004) dhe Intervistë me një zyrtar të UNMIK-ut, korrik 2005.

interview with UNMIK officer, July 2005.

⁴⁹ Sipas disa raporteve, personeli ndërkombëtar në Bosnjë dhe Hercegovinë jo vetëm që përfitonte nga shërbimet seksuale por supozohej se kishte qenë i përfshirë në një rast të trafikimit të qenieve njerëzore. Shih artikujt:

⁵⁰ *Outside the Law and Sex-slave whistle-blowers vindicated* by Robert Capps, nga korriku në gusht të vitit 2002, www.salon.com.

73 raste të trafikimit të grave me qëllim shfrytëzimin seksual dhe janë identifikuar 115 kriminelë. Po ashtu janë raportuar 9 raste të trafikimit të fëmijëve si dhe janë identifikuar 11 kriminelë. Këto shifra janë më të ulëta në krahasim me vitete e shkuara.

- Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, tregu i trafikimit në Kroaci është i vogël. Në vitin 2004, janë raportuar 3 grupe të krimit të organizuar me 11 kriminelë të përfshirë në to, dhe janë rregjistruar 3 raste. Tre kriminelë të një grupi të organizuar janë dënuar. Këto të dhëna sugjerojnë se Kroacia vazhdon të jetë një vend tranziti, megjithëse është raportuar se femra minorene, janë trafikuar nga Bosnjë Hercegovina në bregdetin kroat, për t'u shfrytëzuar seksualisht gjatë muajve të verës.⁵¹
- "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka raportuar për 21 raste të regjistruara, që kanë përfshirë 13 grupe kriminale dhe 52 kriminelë.
- Serbia ka regjistruar 17 raste të trafikimit të qenieve njerëzore, prej të cilave, 8 janë dënuar, me 16 grupe të krimit të organizuara të regjistruara, prej të cilave 7 grupe janë dënuar, me një total prej respektivisht 106 dhe 103 kriminelë, ndërkohë që Mali i Zi ka raportuar për 10 raste, që kanë përfshirë në total 31 kriminelë. Kosova ka regjistruar 82 raste të trafikimit që kanë cuar në arrestimin e 86 kriminelëve. Megjithatë numri i grupeve të krimit të organizuar, të përfshira në trafikim, nuk dihet.

Shumica e viktimave janë gra dhe vajza që janë të huaja në vendin, në të cilin ato shfrytëzohen. Deri më tani, shumica prej tyre vijnë nga vendet e Evropës qendrore dhe lindore: Moldavia, Rumania, Ukraina, Federata Ruse, Bullgaria dhe Lituania, janë vendet që citohen me shpeh si vende të origjinës. Për shembull:

- Në Shqipëri, numri i viktimave të asistuar nga IOM-i ka qenë në rënie të vazhdueshme nga 455 viktima të trafikimit, të asistuar në vitin 2000, në 38 viktima të asistuar në vitin 2003. Nga këto viktima 4 kanë qenë prej Serbisë dhe Malit të Zi, ndërkohë që Moldavia, Bullgaria dhe Rumania kanë qenë shtetet prej nga ka ardhur pjesa e mbetur. Një rënie drastike ka ndodhur që nga viti 2000, kur janë asistuar 125 shtetas të huaj.⁵²
- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, IOM-i ka asistuar 53 viktima në vitin 2003, pjesa më e madhe e të cilave ishin me origjinë rumun, moldave dhe ukrainase, ndërkohë që 7% e tyre e kishin origjinën nga Serbia dhe Mali i Zi.
- Në Kroaci, 18 viktima të trafikimit u identifikuar në vitin 2003, dy prej të cilave ishin shtetase kroate.⁵³
- Në Kosovë, 48% e viktimave të asistuar nga IOM-i në periudhën ndërmjet viteve 2000-2003, kishin ardhur nga Moldavia, e ndjekur nga Rumania, me 21% dhe më pas nga Ukraina. Viktimat e tjera kanë qenë me origjinë nga Bullgaria, Shqipëria dhe Serbia dhe Mali i Zi. Sipas IOM-it ka një numër të konsiderueshëm të viktimave që trafikohen brenda vendit (83 viktima kosovare u referuan tek IOM-i vetëm në vitin 2003), sidomos fëmijë të moshës rreth 15 vjeç.⁵⁴ Sipas të dhënave zyrtare të Seksionit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore të UNMIK-ut (THBS)⁵⁵ të vitit 2004, 17 prej 48 viktimave të asistuar nga THBS-ja ishin nga Moldavia, 13 ishin nga Shqipëria dhe vetëm 11 ishin nga Kosova.

⁵¹ Ibidem, faq. 45

⁵² IOM (korrik 2004), faq. 17-18

⁵³ UNICEF/UNOHCHR/OSCE (2004), faq. 108

⁵⁴ Shih Amnesty International (2004) dhe IOM (korrik 2004), faq. 63-64.

⁵⁵ Të dhënat janë raportuar nga Seksioni për Trafikimin e Qenieve Njerëzore të UNMIK-ut, I cili ka zëvendësuar Njësitë për Hetimin e Prostitucionit dhe të Trafikimit (TPIU-të).

- Në Serbi, policia ka identifikuar 109 viktime të trafikimit në vitin 2002 dhe 49 në vitin 2003,⁵⁶ shumica e të cilave ishin nga Rumania, Moldavia, Ukraina dhe Rusia.⁵⁷ Fenomeni i viktimave të trafikuar Brenda vendit, dhe sidoms të trafikimit të fëmijëve, mendohet se është në rritje. Në gjysmën e parë të vitit 2004, OJQ-ja lokale ASTRA kishte asistuar 30 viktime të trafikimit, 22 prej të cilave ishin vendase dhe vetëm 8 prej tyre ishin të huaja.
- Po ashtu, në Mal të zi, në vitin 2003, 12 viktime të trafikimit u asistuan nga një organizatë jo-qeveritare lokale, nga të cilat 3 ishin fëmijë të trafikuar brenda për brenda vendit.⁵⁸
- Në ‘Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë’, 132 viktime janë identifikuar si viktime të trafikimit, 19% prej të cilave ishin nën moshën 18 vjeç dhe 3-4% ishin nën moshën 15 vjeç. Raporti i përbashkët i UNICEF/UNOHCHR/OSCE mbi trafikimin e qenieve njerëzore në rajon evidenton atë çka sot mendohet të jetë një problem në rritje dhe që ka të bëjë me viktimat vendase të trafikuar brenda vendit.⁵⁹ Ky fenomen nuk është mbështetur nga të dhënat zyrtare të autoriteteve, të cilat regjistrojnë pak raste të tilla për çdo vit.

Në raport me trafikimin e qenieve njerëzore në Evropën Juglindore mund të nxirren konkluzionet e mëposhtëme:

- Në Evropën Juglindore në përgjithësi, trafikimi i qenieve njerëzore duket se është në rënie, ose të paktën është më pak i dukshëm. Sipas një raporti të kohëve të fundit⁶⁰:
 - Ka më pak viktime që kthehen nga vendet e rajonit në vendin e tyre të origjinës
 - Ka më pak viktime që kërkojnë asistencë
 - Ka më tepër viktime që kthehen prej vendeve të Bashkimit Evropian në vendet e tyre të origjinës
 - Ka më pak emigrantë të parregullt, të regjistruar në vendet e tranzitit në rajon
 - Ka më pak raporte për trafikimin e qenieve njerëzore në rajon.
- Është vërejtur po ashtu një ndryshim në profilin e viktimave, në mënyrë të veçantë të viktimave që rekrutohen brenda vendit. Megjithëse të dhënat e paraqitura nga IOM-i dhe nga autoritetet vendase shfaqin mospërputhje, sidomos kur bëhet fjalë për “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” dhe “Kosovën”, problemi i rekrutimit në vend nuk mund të nënvleftësohet.
- Trafikimi i viktimave përgjatë një kufiri të vetëm, sikurse dhe trafikimi brenda për brenda i viktimave vendase, të cilat i ofrojnë shërbime seksuale një tregu vendas dhe rajonal në rritje, mbeten probleme serioze. Sapo viktimat e trafikuar brenda vendit, fitojnë njëfarë “eksperiencë” atëherë ato trafikohen përtej kufirit. Megjithatë, ende për shumë shtete, trafikimi i qenieve njerëzore vazhdon të konsiderohet një çështje e emigracionit të paligjshëm (klandestin) – shkaqet e të cilit janë problem për një tjetër shtet. Viktimat e trafikuar në vend, gjykohet se janë pjesë e prostitucionit të modes së vjetër dhe mbeten ende për t’u trajtuar si një fenomen në rritje nga autoritetet vendase. Kjo ka pasoja për viktimat, (të cilave u m’ohohet mbrojtja dhe mbështetja), por edhe për organet e zbatimit të ligjit, (ku dëbimi i referohet hetimeve afatgjata të krimit të organizuar). Kjo mund të shpjegojë faktin se përse në Evropë ka kaq pak hetime të krimit të organizuar, që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

⁵⁶ UNICEF/UNOHCHR/OSCE (2004), faq. 116

⁵⁷ Nikolic-Ristanovic et al. (2004)

⁵⁸ UNICEF/UNOHCHR/OSCE (Mars 2005), faq. 118

⁵⁹ Ibid. p. 110

⁶⁰ UNICEF/UNOHCHR/OSCE-ODIHR (2005): Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Evropën Juglindore 2004 – me focus tek Parandalimi. Duhet, gjithsesi të nënvizohet se të dhënat vijnë nga burime të ndryshme dhe shpeshherë janë kontradiktore. Prandaj, dhe çdo pohim lidhur me tendencat negative apo pozitive duhet konsideruar me maturi.

- Në krahasim me vitete e shkuara, viktimat e asistuar nga IOM-i në vitin 2003 kanë treguar se ato kanë qenë më të ndërgjegjshme, lidhur me mundësinë për të qenë të trafikuar, por që megjithatë shpesh kanë qenë të gatshme ta mësyjnë këtë rrezik, vetëm për të dale jashtë vendeve të tyre të origjinës. Megjithëse, rekrutimi vazhdon të mbështetet ende në metoda të mire-përcaktuara (shih më sipër), vërehen gjithashtu rekrutime nga gra, të cilat në më të shumtën e rasteve kanë qenë vetë viktimat të trafikimit. Ky lloj rekrutimi mbështetet në metoda më të sofistikuar të kontrollit, duke shfrytëzuar njohuritë e përbashkëta se të vendit nga vjen viktimat dhe të anëtarëve të familjes së saj.⁶¹
- Pjesa më e madhe e rekrutimeve kryhet nga persona të të njëjtës kombësi me viktimën, megjithëse paskëtaj, viktimat trafikohet në tregjet e huaja. Megjithëse, mendohet se rekrutimi i grave moldave për në Bosnjë dhe Hercegovinë apo për në “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” kryhet nga vetë shtetasit e këtyre vendeve. Kjo tendencë e re mund të sugjerojë ose një kërkesë më të madhe nga ana e këtyre tregjeve, ose që grupet e krimit të organizuar të këtyre vendeve janë bërë më të fuqishme dhe po përpiqen ta eliminojnë ndërmjetësin.
- Në Kosovë dhe në Bosnjë Hercegovinë, grate e trafikuar të përfshira në tregtinë e seksit mendohet se kanë kushte më të mira jetese – një pagesë të vogël, por të rregullt dhe ambjente më të mira private. Dhuna e përdorur për të kontrolluar viktimat duhet se është pakësuar dhe zëvendësuar me një trajtim më të mire, me qëllim shmangien e vëmendjes jo të dëshiruar. Kjo praktikë duket se ka qenë e suksesshme, sidomos e kombinuar me një formë jo të dhunshme të kontrollit, siç është varësia nga droga apo alkoli.⁶²
- Klientale vendase dhe tregjet e brendshme janë në rritje dhe në zhvillim. Mbyllja e shuëm bareve dhe klubeve në Bosnjë Hercegovinë shkaktoi një zhvendosje të tregut, sepse tani shërbimet seksuale ofrohen në apartamente private dhe në formën e shërbimeve të shoqërimin (shoqërueseve), të cilat janë shumë më vështirë për t’u zbuluar dhe për t’u kontrolluar. Gjithashtu, për shkak të kufizimeve që janë vënë ndaj trupave të huaja në Bosnjë dhe Hercegovinë, por edhe në Kosovë, tregu që i ka rrënjët tek shfrytëzimi seksual, tani ushqen kryesisht klientelën vendase.⁶³ Kjo duket se është një tendencë në rritje, jo vetëm për Bosnjë Hercegovinën dhe Kosovën, por edhe për rajonin në tërësi, duke krijuar sfida dhe kërcënime të reja për shëndetin publik.⁶⁴
- Fëmijët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të viktimave. Në disa shtete të Evropës Juglindore, 50% e viktimave apo edhe më tepër, mendohet se janë nën moshën 18 vjeç, që do të thotë se janë fëmijë.⁶⁵ Vende të tilla si “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, Serbia dhe Shqipëria kanë regjistruar gjithashtu raste të trafikimit të fëmijëve, me qëllim lypjen, prostitucionin, ose për qëllime edhe më klandestine, si p.sh. adoptimi apo transplantit i organeve. Megjithëse kanë qenë raste shumë të rralla, në Shqipëri është vërejtur edhe fenomeni i trafikimit të djemve dhe burrave për qëllime të shfrytëzimit seksual. Greqia është destinacioni kryesor për fëmijët e trafikuar nga Shqipëria. Sipas raporteve të mediave, në vitin 2004, fëmijët janë trafikuar nga Shqipëria për në Greqi për të lypur në mënyrë të organizuar, gjatë Lojërave Olimpikë.⁶⁶
- Përveç dhunës dhe frikësimit, korrupsioni dhe bashkëpunimi mendohet se janë mjete shumë të përhapura për të lehtësuar trafikimin si dhe për të mbrojtur biznesin. Trafikimi i qenieve

⁶¹ Për shembull, në Gjermani, nga 1100 trafikantë të dyshuar, 31% e tyre vinin nga Evropa Qendrore dhe Lindore, 21% e tyre ishin gra, shpeshherë prostituta të dikurshme, që tashmë rekrutonin gra nga vendet e tyre të origjinës, që ndërmjetësonin dërgimin e tyre në shtëpi publike, ose që i mbikqyrin ato në shtëpitë publike.

⁶² IOM (korrik 2004). faq.10-12

⁶³ Deri 90% të klientelës në Kosovës e përbëjnë meshkujt kosovarë, IOM (korrik 2004), faq.67 që citon TPI-të e UNMIK-ut

⁶⁴ Shih IOM (korrik 2004), faq 10-12, dhe Obradovic (2004)

⁶⁵ Save the Children (2004).

⁶⁶ Süddeutsche Zeitung 30 qershor 2004

njerëzore kërkon që funksionarët publikë t'i mbyllin sytë përpara këtij problemi (siç është trafikimi brenda vendit) ose që ata të veprojnë në mënyrë active (duke filluar nga zyrtarët e vizave, funksionarë të migrimit, stafet e ambasadave, apo të doganave dhe të policisë së kufirit, zyrtarët lokalë që lëshojnë lejet e punësimit dhe të tjerë). Mbrojtja sistematike nga ana e politikanëve apo nga ana e personave me influencë dhe nga profesionistë të sektorit privat (agjencitë e udhëtimit, industria hoteliere, dhe të tjera) gjatë etapave të ndryshme të zinxhirit të trafikimit është gjithaq thelbësor për këtë lloj krimi, duke u dhënë mundësinë kriminelëve të përfitojnë nga një shkallë e lartë fleksibiliteti dhe përshtatshmërie në raport me agjencitë e zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi me organet e zbatimit të ligjit, zyrtarët e drejtësisë penale, politikanët me influencë, është i nevojshëm për të mbrojtur kriminelët në zinxhirin e drejtësisë penale, duke minimizuar në këtë mënyrë dëmin shkaktuar rrjeteve kriminale.⁶⁷

⁶⁷ Këshilli I Evropës (2002): Trafikimi I Qenieve Njerëzore dhe Korrupsioni (Programi PACO, TP 28, rev) Strasburg.

3.1.4 Kontrabanda e Personave

Globalizimi kontribuon në rritjen e konsiderueshme të kontrabandës së personave⁶⁸ dhe të trafikimit të qenieve njerëzore, ndërkohë që edhe trafikimi edhe kontrabanda e personave janë kthyer në bizneset kryesore globale të grupeve të krimit të organizuar.⁶⁹

Në Evropë, kontrabanda e personave – si një nga shprehjet e migracionit të paligjshëm – është një çështje tepër e ngarkuar politikisht dhe ka qenë në krye të axhendës së Bashkimit Evropian, për disa kohë, e lidhur ndër të tjera edhe me zgjerimin e BE-së, lëvizjen e lire të njerëzve dhe aksesin tek tregjet e punës, apo me ksenofobinë dhe racizmin. Për shembull, retorika që ka rrethuar së fundi referendumet mbi Kushtetutën e Bashkimit Evropian në Francë dhe Hollandë, ka përfshirë ndërmjet të tjerave edhe mungesën e përgatitjes për të thithur një numër kaq të madh të të huajve.

Evropa Juglindore është kryesisht një zone tranziti për kontrabandën e personave. Në raport me lidhjen ndërmjet kontrabandës së personave dhe krimit të organizuar, mund të vërehen tendencat dhe çështjet e mëposhtëme:

- Një numër në rritje I vendeve evropiane kanë raportuar mbi lidhjet e krimit të organizuar me kontrabandën e personave, një pjesë e madhe e së cilës, realizohet nëpërmjet “Rrugës Ballkanike”. Përgjigjet që i janë dhënë pyetësorit sugjerojnë se ka një rol të fortë të grupeve të krimit të organizuar që përdorin mjete gjithnjë e më të sofistikuara në kontrabandën e personave dhe që ka një bashkëpunim në rritje të grupeve kriminale lokale përgjatë kanaleve të kontrabandës. Për shembull:
 - Para se të mbyllej rruga detare e emigracionit klandestin, nga Shqipëria për në Itali, të paktën 95 000 migrantë mund ta kenë shfrytëzuar këtë kanal për të hyrë në Bashkimin Evropian. Kjo tregti mund të ketë siguruar një fitim prej 58-96 milionë € në periudhën e viteve 1999-2002. Numri i emigrantëve klandestinë, është që prej asaj kohe në rënie. Përdorimi i rrugëve tokësore dhe përkatësisht kufiri me Kosovën, ka fituar që atëherë rëndësi të madhe. Por, ky kufi me gjatësi prej rreth 174 km, i cili mbulon një terren përgjithësisht malor dhe të pakalueshëm mbetet pak ose aspak i ruajtur me policë.⁷⁰ Në nëntë muajt e parë të vitit 2004, është regjistruar një numër prej 365 rastesh të kalimit të paligjshëm të kufirit si dhe të organizimit apo ndihmës në kalimin e paligjshëm të kufirit, me rreth 644 personash të përfshirë, kryesisht me origjinë kosovare. Nëse flitet për rastet, Shqipëria ka regjistruar 16 raste në vitin 2003 dhe po aq grupe të krimit të organizuar, në të cilat është përfshirë një total prej 58 kriminelësh. Duket se kufiri verior i Shqipërisë është përdorur për kontrabandë (të njerëzve, por edhe të armëve, të drogave apo të mallrave të tjera), veçanërisht nga grupet shqiptare në bashkëpunim të ngushtë me grupet e organizuara kriminale të “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, Kosovës dhe Serbisë.

⁶⁸ Neni 3 i Protokollit kundër Trafikut të Migrantëve me rrugë tokësore, detare dhe ajrore, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar, e përkufizon kontrabandën si: “... prokurimin, me qëllim përfitimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një përfitimi financiar, ose një të mire tjetër materiale, i hyrjes së paligjshme të një personi në një prej Shteteve Palë, kur personi nuk është as shtetas dhe as rezidenti i përhershëm i këtij shteti”.

⁶⁹ Popullsia evropiane është duke u plakur dhe është duke u rritur me ritme më të ngadalta se sa popullsia e vendeve në zhvillim, duke krijuar një kërkesë për fuqi punëtore dhe duke u kthyer në destinacione tërheqëse për emigrantët. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit, nga 130 milionë emigrantë ndërkombëtarë, në shkallë globale, rreth 20 deri në 40 milionë janë emigrantë të parregullt, dhe të paktën 4 milionë emigrantë të parregullt, janë në lëvizje në çdo kohë. Besohet se një shifër nga 300 000 deri në 450 000 emigrantësh të parregullt, hyn çdo vit në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian. Në të njëjtën kohë, kërkesat për azil arritën në vitin 2003, nivelin më të ulët, në 20 vjet, duke dëshmuar për një pakësim të numrit të migrantëve të ligjshëm, por jo detyrimisht për një pakësim të hyrjeve dhe të qëndrimeve të paligjshme në vendet e BE-së. Shih Këshilli i Evropës (2005), faq. 35.

⁷⁰ IOM (korrik 2004), faq. 70.

- Kroacia është po ashtu një vend tranziti për migrantët që vijnë nga lindja (afganët, irakenët, kurdët, etj). Kroacia ka raportuar se kontrabanda nëpërmjet territorit të saj është e organizuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet kontrabandistëve kroatë dhe kontrabandistëve nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia e Mali i Zi, ku është ngritur një numër vendstrehimesh për të pritur emigrantët, në kohën që ata janë në pritje të transferimit përtej kufirit. Pjesa më e madhe e kontrabandës së personave është e përqendruar dhe kalon nëpërmjet Zagrebit. Në vitin 2004, u regjistruan 15 raste të krimit të organizuar të kontrabandës së njerëzve, në të cilat ishin përfshirë në total 11 grupe, 7 nga të cilat ishin vënë përballë përgjegjësisë penale dhe ishin dënuar.
- Në vitin 2003, "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka regjistruar 8 raste të kontrabandës së organizuar të personave, me 4 grupe të përfshira dhe 12 të dyshuar në total.
- Statistikat e Malit të Zi, tregojnë për 257 kalime të paligjshme të kufirit në vitin 2003 dhe 372 të tilla në nëntë muajt e parë të vitit 2004, ndërkohë që Serbia ka regjistruar 27 raste të krimit të organizuar të kontrabandës, në të cilat janë përfshirë 16 grupe me 64 kriminelë, nga të cilët janë dënuar respektivisht 19, 5 dhe 37.
- Së fundi, në Kosovë janë regjistruar 234 raste të kontrabandës së personave, ndërkohë që shkalla e organizimit dhe numri i grupeve të përfshira nuk është specifikuar.

Sipas Interpolit, rruga ballkanike për në Evropën Perëndimore përdoret për të transportuar në mënyrë të paligjshme emigrantët nga vendet aziatike dhe të Lindjes së Mesme, nëpërmjet Iranit, Turqisë dhe Bullgarisë.⁷¹ Në krahasim me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabanda e personave, kërkon një sofistikim më të vogël operacional, meqenëse qëllimet e këtij tregu kriminal janë më pak komplekse. Kompleksiteti i grupeve kriminale përcaktohet pra nga kompleksiteti i transferimit të emigrantëve përtej kufijve. Grupet e nivelit të mesëm janë në gjendje të ofrojnë të gjitha lehtësitat për një udhëtim të plotë, që nga përgatitja e dokumenteve false, ose të falsifikuara, deri tek kalimi i paligjshëm i kufijve ndërkombëtarë në forma të paligjshme, ose duke përdorur rryshfetin si dhe duke u mbështetur tek kompanitë e transportit dhe tek agjentët e udhëtimit, të cilët shpesh kanë lidhje të drejtpërdrejta me kontrabandistët, ose janë vetë kontrabandistë. Grupet e nivelit të lartë mund të sigurojnë ndihmë logjistike për emigrantët në vendin e destinacionit, shpesh duke shfrytëzuar lidhjet me komunitetin e të njëjtës etni apo kombësi në atë shtet.

Janë disa kanale që përdoren për të transportuar emigrantët ilegalisht në Evropën Perëndimore nëpërmjet rrugëve tokësore dhe detare. Karakteristika kryesore e këtij tregu në Ballkan është natyra e tij e theksuar rajonale. Aeroportet që më parë përdoreshin për futjen e emigrantëve nga Lindja, siç janë Tuzla dhe Sarajeva në Bosnjë dhe Hercegovinë, janë mbyllur për këtë lloj trafiku, pas miratimit të ligjeve më të mira që rregullojnë çështjet e kufirit dhe të vizave. Sapo këto ligje hynë në fuqi, hyrja e emigrantëve të paligjshëm thjesht u zhvendos në aeroporte të tjera, siç është aeroporti i Prishtinës në Kosovë. Me fjalë të tjera, hyrja u zhvendos për në vende të tjera, aty ku regjimi i vizave dhe kontrolli i kufijve është më liberal, të cilat japin mundësinë e një udhëtimi më të lehtë prej Stambollit, Budapestit, Sofies, etj. Këto udhëtime vijnë më tej në rrugë tokësore drejt Perëndimit. Miratimi i rregullores nr. 2005/16 mbi Lëvizjen e Personave që hyjnë dhe dalin nga Kosova në korrik të vitit 2005 ka si qëllim përmirësimin e kontroleve përgjatë kufijve dhe drejtohet para së gjithash kundër operacioneve të krimit të organizuar dhe të trafikimit të qenieve njerëzore.

- Një tjetër tendencë e vërejtur nga vendet e rajonit, është se disa persona që më parë ishin përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore, më pas kanë kaluar tek kontrabanda e personave dhe mallrave përtej kufijve. Kjo mund të shpjegohet ose me rrezikun e lartë të kapjes për veprën e trafikimit, falë përpjekjeve të organeve të zbatimit të ligjit, ose me konsolidimin e grupeve të trafikimit. Sidoqoftë, është për t'u shënuar që aftësitë e fituara në një lloj të caktuar të aktivitetit kriminal mund të transferohen me lehtësi tek aktivitete të tjera kriminale, bashkë me zhvillimin dhe evolucionin e tregjeve kriminale.

⁷¹ Shih: www.interpol.org

Ndërkohë që rrjetet e trafikimit që operojnë në Ballkan janë kryesisht të përqendruara në Evropën Lindore, origjina e rrjeteve të kontrabandës arrin deri në Bangladesh, Pakistan, Indi dhe Kinë. Pavarësisht kësaj, shumica dërrmuese e emigrantëve që monitorohen ka kombësi turke. Për emigrantët afrikanë, rruga e përdorur për të hyrë në Evropë kalon nga Afrika Lindore drejt Evropës Juglindore, përgjatë Detit Mesdhe. Kjo rrugë është më e rrezikshme se sa Rruga Ballkanike, sepse çdo vit vdesin në det qindra persona.⁷²

Në raport me shifrat aktuale të emigrantëve, ka një kufi të hollë ndërmjet trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së personave tej kufijve, që shpesh nuk dallohet aq qartë sa duhet, pavarësisht përkufizimeve që përmban Konventa Kombëtare kundër Krimin të Organizuar Ndërkufitar. Shifrat e personave të trafikuar dhe që kanë kaluar kufirin ilegalisht, shpesh përzihen me njëra-tjetrën, pjesërisht sepse trajtimi i emigrantëve klandestinë kërkon më pak fonde dhe ka të bëjë vetëm me deportimin, ndërkohë që trafikimi kërkon hetime komplekse sikurse dhe mbrojtje për viktimën. Kjo shpesh ofron një stimul për deportimin e viktimave dhe bëhet shkak për deflacionin e shifrave të tyre.

Policinë kundër kontrabandës së personave shkaktojnë ndonjëherë pasoja negative të paqëllimshme, në këndvështrimin e të drejtave të njeriut. Meqenëse hyrja e ligjshme në Bashkimin Evropian bëhet gjithnjë e më e vështirë dhe kontrollet kufitare më të forta, emigrantët gjithnjë e më tepër u besojnë organizatave të kontrabandistëve për të rregulluar transportin e tyre. Kjo nuk është e vërtetë vetëm për “emigrantët ekonomikë”, por edhe për refugjatët. Është debatuar se që prej vitit 1980 – dhe sidomos pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, çështja e azilit për refugjatët politikë fillimisht është trajtuar nëpërmjet kontrollit të emigrantëve, ndërkohë që filozofia e “kështjellës” e kohëve të fundit me qëllim izolimin e kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian, apo nisma si ajo e Protokollit kundër Kontrabandës së Kombeve të Bashkuara, i cili lë të hapura shumë pak shtigje të ligjshme, ka çuar në kriminalizimin e refugjatëve, duke i shtyrë ata në duart e kontrabandistëve. Kërkimet e kohëve të fundit sugjerojnë se:

- Pjesa dërrmuese e atyre që kërkojnë azil dhe që kanë arritur në Evropë, kanë kërkuar më parë ndihmën e një “kontrabandisti të njerëzve”, në ndonjë etapë të udhëtimit të tyre
- Efekti i masave të zbatimit të ligjit të tipit blanket, ka qenë i tillë që i ka shtyrë kërkuesit e azilit të zëvendësojnë format më të sigurta të emigrimit “të kamufluar” (p.sh. duke përdorur një fluturim ajror të rregullt, por duke udhëtuar me dokumente false), me forma “klandestine”, të cilat janë edhe më të shtrenjta, por edhe më të rrezikshme për grate, burrat dhe fëmijët e implikuar. (p.sh. të qëndrojnë të mbyllur në pjesën e prapme të një kamioni).

⁷² Besohet se më shumë se 3000 persona kanë vdekur në periudhën nga viti 1995 deri në vitin 2003, gjatë përpjekjeve për të arritur Spanjën; më shumë se 400 persona vdiqën në vitin 2003, gjatë përpjekjeve për të arritur Sicilinë. Në gusht të vitit 2004 28 veta u mbytën në afërsi të Sicilisë.

3.1.5 Kontrabanda e mallrave të ligjshme

Kontrabanda nënkupton transportin e paligjshëm të mallrave përtej kufijve, me qëllim që të shmangen detyrimet doganore dhe tatimore mbi këto mallra. Krimi i organizuar që është i përfshirë në kontrabandë, merret zakonisht me mallrat që kanë akcizë të lartë, të tilla si cigaret, alkolin dhe naftën, por edhe me automjete dhe me armë. Sipas përgjigjeve që i janë dhënë pyetësorit, në shumicën e vendeve të këtij projekti, kontrabanda është një treg për krimin e organizuar. Kërkimet e kohëve të fundit ofrojnë një sfond të dobishëm në lidhje me gjendjen në Europën Juglindore.

“[...] Mungesa e stabilitetit në rajon në trembëdhjetë vjetet e fundit e ka dëmtuar zbatimin efektiv të ligjit nëpër të gjithë rajonin, e ka rritur ndjeshëm koston e tregtisë rajonale dhe kësajsoj tarifën e kontrabandës, të cilat për pasojë janë kthyer në një tokë pjellore për krimin e organizuar në shkallë rajonale.”⁷³

Lufta në Ballkan në vitet 90 në përgjithësi, dhe embargoja e tregtisë dhe e armëve e vendosur kundër Serbisë në mënyrë të veçantë, ofruan një shans unik dhe krijuan kërkesën për mallra me tarifa të larta, të tilla si nafta, cigaret dhe alkoli. Përpjekjet e luftës përfshinin edhe dhënien e licencave tepër fitimprurëse për iportin dhe kontrabandën e kontrolluar nga shteti, në Serbi, duke krijuar një simbiozë ndërmjet zyrtarëve të sigurimit, politikanëve, zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe të doganave, dhe kriminelëve të organizuar. Sanksionet nxitën bashkëpunimin ndërmjet kanaleve rajonale të kontrabandës, nëpërmjet Bullgarisë, Rumanisë, “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, Malit të Zi dhe Shqipërisë, kryesisht të mallrave të tilla si nafta, cigaret, armët dhe mallra të tjera. Kontrabanda u kthye pra në një burim i rëndësishëm të ardhurash për grupe të ndryshme, që varionin nga elitat politike dhe deri tek njerëzit që jetonin në zonat kufitare, të cilët shfrytëzonte korrupsionin si në nivel të ulët, por edhe në nivel të lartë, si pjesë themelore e biznesit të kontrabandës.⁷⁴

Edhe pse shkalla e evazionit të detyrimeve tatimore dhe doganore dhe kontrabanda janë ulur falë normalizimit të rajonit, kontrabanda vazhdon të jetë një nga krimet mbizotëruese. Rrjetet e kontrabandës të ngritur në vitin 1990 vazhdojnë të jenë ende shumë aktive dhe janë transformuar në rrjete që merren me kontrabandën ose trafikun e mallrave të tjera, të ligjshme, ose të paligjshme, të cilat kërkohen nga tregjet rajonale ose perëndimore. Përpjekjet aktuale për të vendosur regjimet e TVSH-së dhe një tregti më të liberalizuar ndërmjet vendeve, do të shërbejnë për ta pakësuar – por jo për ta zhdukur krejtësisht – varësinë nga të ardhurat nga mallrat e akcizës dhe nga tarifën doganore. Nën dritën e kësaj, ekonomia rajonale dhe të ardhurat publike do të vazhdojnë të kenë humbje.

Në një kontekst më të gjerë, Evropa vazhdon të jetë një nga tregjet kryesore të duhanit. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës zënë rreth 30% të prodhimit botëror të cigareve, 60% të eksportit global dhe më shumë se 50% të importeve globale. Duke pasur parasysh përmasat e tregut dhe mundësinë për të fituar të ardhura shtesë, në rast se shmangen detyrimet doganore dhe taksat, rreth 25 % e cigareve që prodhohen në shkallë globale ose më tepër se 210 miliardë cigare (diferenca ndërmjet importit dhe eksportit të raportuar) shkon në tregun e zi. Prej kësaj shifre, një e tretë, mendohet se hyn dhe kalon kontrabandë në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ligjet e kohëve të fundit që ndalojnë pirjen e duhanit në vendet publike, në disa prej shteteve të Bashkimit Evropian, siç janë Italia dhe Republika e Irlandës mund të ndikojnë në pakësimin e tregut në Evropën Perëndimore. Megjithatë, vendet e Evropës Lindore, sipas parashikimeve, ka të ngjarë të vazhdojnë të jenë konsumatorë të mëdhenj të cigareve edhe në të ardhmen.

Në Evropën Juglindore, Greqia duket se është një prej vendeve kryesore të nisjes së cigareve të kontrabanduara në Evropë, ndërkohë që Italia, është një nga vendet kyçe të destinacionit dhe të tranzitit.⁷⁵ Prandaj, nuk është e habitshme se përse vendet e Evropës Juglindore, vazhdojnë të

⁷³ Shih Raportin e Qendrës për Studimin e Demokracisë *Corruption, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar në Evropë (Corruption, Contraband and Organised Crime in Europe)* (2003), faq. 8

⁷⁴ Ibid, faq 9.

⁷⁵ Shih RILO (2001)

shprehin shqetësime lidhur me kontrabandën e cigareve, akoma më shumë që kjo çështje është një problem i madh për krimin ekonomik.

Ka dhe mallra të tjera që kontrabandohen: mallrat e akcizës (alkoli dhe nafta), prodhimet ushqimore dhe gjëja e gjallë, veshjet dhe konfeksione të ndryshme. Për të kaluar kontrabandë këto mallra përdoren të njëjtat metoda dhe rrjete. Përgjigjet që ju dhanë pyetësorit tregojnë për sa vijon:

- Në Shqipëri, 25% e të gjitha rasteve të kontrabandës, së regjistruar në vitin 2005, kanë të bëjnë me kontrabandën e bagëtisë, (gjësë së gjallë), ndërkohë që 19% përfshin duhanin, më pas, prodhimet ushqimore, alkoli dhe nafta. Në vitin 2004, numri I rasteve të regjistruara, pothuajse është dyfishuar me 164 raste, shumë prej të cilave përfshijnë mallrat e akcizës, vlera e të cilave arrinte përafërsisht 144 000 euro. Në drejtim të rasteve që lidhen me krimin e organizuar, Shqipëria ka regjistruar 14 raste, me po aq grupe të krimit të organizuar, në të cilat janë përfshirë në total 62 kriminelë. Falsifikimi dhe prodhimi i mallrave pirate përfshin në masë të madhe si produktet e prodhuara jashtë Shqipërisë, por dhe ato të prodhuara brenda vendit, siç mund të jenë pijet e lehta.
- Bosnja dhe Hercegovina ka raportuar për një ekspansion të kontrabandës dhe rritje të shitjes së mallrave pirate të të gjitha llojeve (alkoli, duhani, ushqimi, etj), përkatësisht, të atyre mallrave që prodhohen në vendet fqinje dhe që njihen dhe favorizohen nga konsumatorët vendas. Në vitin 2003, Bosnja dhe Hercegovina ka regjistruar 19 raste të kontrabandës, e cila kishte shkaktuar një humbje prej 14 168 058 euro të të ardhurave publike.⁷⁶ Arsyeya kryesore për lulëzim të tregut të kontrabandës shtrihet në fragmentarizimin e rajonit ekonomik të brendshëm të Bosnjë-Hercegovinës, që krijon kushte të papara për evazionin tatimor dhe doganor në rajon si dhe në ekzistencën e tregjeve që i shesin mallrat e kontrabanduara, siç është për shembull tregu Arizona, në Rrethin (Qarkun) e Brcko-s. Shpresohet që Zyra e Përfaqësuesit të Lartë dhe qeveria e Bosnjë-Hercegovinës të bashkojnë përpjekjet nga viti 2004 në vitin 2005, për të unifikuar sistemin e fragmentarizuar të mbledhjes së taksave si dhe për të ngritur Agjencinë e Taksave Indirekte, që gjithashtu shpresohet se do të sjellë rezultate pozitive në të ardhmen.⁷⁷
- Kroacia vuan kryesisht nga kontrabanda e mallrave të akcizës, duke raportuar për 38 raste të krimit të organizuar, me 17 grupe të përfshira dhe 127 kriminelë, nga të cilat përkatësisht 17 raste, 12 grupe dhe 101 kriminelë janë ndjekur penalisht, që ka rezultuar deri më tani me një dënim në një rast.
- Kontrabanda e cigareve nëpërmjet “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” kalon kryesisht nëpërmjet Kosovës dhe kufijve me Greqinë, e cila është gjithashtu një rrugë e rëndësishme për kontrabandën e aparateve teknike, të tilla si telefonë celularë, kompjuterë, dhe pjesë kompjuterash. Mallrat tekstile, të cilat e kanë origjinën nga Kina, futen kontrabandë nëpërmjet Turqisë dhe Bullgarisë, e cila është gjithashtu një vendburim për mallrat ushqimore që futen kontrabandë në „Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”. Gjithsesi, duket se kontrabanda e ushqimeve, i shërben më tepër tregut vendas dhe shumë shpesh realizohet nëpërmjet individëve të shumtë që kalojnë kufirin me automjetet e tyre private dhe transportojnë sasi të vogla të mallrave, pra mbi bazën e të ashtuquajturës „metoda fluturuese”. Presupozohet se me këtë lloj kontrabande të mallrave ushqimore merren persona të papunë, ose që nuk janë të punësuar në mënyrë të mjaftueshme, të cilët me këtë mënyrë shpresojnë të kenë disa të ardhura shtesë. Riambalazhimi, rietiketimi, dhe shitja e mallrave të cilave u ka kaluar afati i skadencës, por edhe e mallrave ushqimore të falsifikuara që kanë popullaritet tek konsumatorët vendas, kërkon më tepër sofistikim. Në vitin 2003, „Ish Republika Jugosllave e

⁷⁶ Të dhënat janë ofruar nga Ish Zyra e Administratës së Taksave në Republikën Srpska, Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Rrethit të Brčko-s, e cila është zëvendësuar së fundmi nga Administrata e Taksave Indirekte, që mbulon gjithë territorin e Bosnjë Hercegovinës.

⁷⁷ Mbi vendimet e Përfaqësuesit të Lartë në këtë fushë në vitet 2004 dhe 2005, shih: www.ohr.int/decisions/econdec/archive.asp.

Maqedonisë“ ka zbuluar 8 grupe të krimit të organizuar, të përfshira në kontrabandë, me 174 raste të regjistruara. Në 9 muajt e parë të vitit 2004, autoritetet kombëtare kanë sekuestruar mallra të akcizës, kryesisht cigare dhe alkol, me një vlerë totale prej 105 milionë MKD (dinarë maqedonas), ose 1.72 milionë euro.

- Po ashtu Mali I Zi, ka kapur përafërsisht 1.7 milionë euro cigare dhe alkol. Përveç kësaj është vërejtur edhe kontrabanda e mallrave të akcizës dhe e naftës ndërmjet Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës dhe kontrabanda e bagëtive (gjësë së gjallë) ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë. Kontrabanda e duhanit në fund të viteve 90 është pakësuar, falë një kombinimi të presionit ndërkombëtar dhe të përpjekjeve të qeverisë vendase.⁷⁸
- Serbia e ka reduktuar në mënyrë të konsiderueshme kontrabandën e mallrave të akcizës, pas ndryshimit të regjimit politik në vitin 2000. Rruga e shquar dikur për kontrabandën e cigareve nëpërmjet Malit të Zi është mbyllur dhe rrugët e reja tashmë kalojnë nëpërmjet Kosovës, „Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë“, Bullgarisë, Rumanisë dhe Kroacisë. Kontrabanda e mallrave të cila riambalazhohen dhe shiten në treg është një tendencë relativisht e re në rajon, dhe jo vetëm në Serbi. Shtatëmbëdhjetë raste të kontrabandës të lidhur me krimin e organizuar janë regjistruar në vitin 2003, në të cilat janë implikuar 9 grupe kriminale dhe 70 kriminelë, nga të cilat 16 raste, ku kanë qenë përfshirë 7 grupe me 32 kriminelë janë ndjekur penalisht.
- Alkoli dhe cigaret që futen kontrabandë në Kosovë e kanë origjinën në Slloveni, Austri, Serbi, Mal të Zi, „Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë“ dhe Greqi, ndërkohë që markat e falsifikuara prodhohen kryesisht në Kosovë, por edhe në vendet fqinje, nga të cilat më pas hyjnë kontrabandë në Kosovë. Në vitin 2004 dhe në pjesën e parë të vitit 2005, janë regjistruar 332 raste të kontrabandimit të mallrave, me rreth 467 persona të implikuar.

Kontrabanda e cigareve: si funksionon ajo?

- Organizatat kriminale përfitojnë nga sistemi i tranzitit, i konceptuar për të lejuar pezullimin e përkohshëm të taksave dhe detyrimeve të tjera, me qëllim lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare. Organizatat e kontrabandës përdorin kompanitë ndërmjetëse, shumica prej të cilave janë fiktive në Ballkan, për të porositur duhan apo cigare. Kompania blerëse, e cila shpesh është fiktive jep më vonë udhëzimin që mallrat duhet të transportohen në vende të tjera, jashtë Bashkimit Evropian. “Transaksionet e shumëfishta që janë kryer para se ngarkesa e paligjshme të arrijë në destinacionin final kanë si qëllim të vetëm fshehjen e blerësit të vërtetë, roli i të cilit është që të furnizojë organizatat e kontrabandistëve. “Cigaret atëherë pajisen me dokumente të reja dhe kanalizohen në tregun e zi vendas ose hyjnë sërish kontrabandë në vendet e BE-së. Luftimi i rrjeteve të kontrabandës ndërkombëtare të duhanit bëhet edhe më i vështirë falë edhe një perceptimi të ngushtë të këtij problemi, si thjesht një çështje evazioni fiskal.
- Rrjetet e krimit të organizuar shfrytëzojnë mundësitë dhe strukturat e dobëta të kontrollit të shteteve të dobëta apo të keq-qeverisura. Cigaret e futura kontrabandë dhe mallrat e tjera të akcizës janë më të preferuarat, ndërkohë që keq-përfaqësimi dhe raportimi në vlerë më të ulët, të mallrave, shpesh maskohen pas ngarkesave të ligjshme. Korrupsioni i punonjësve të doganave dhe të kufirit, është vendimtar për këtë lloj aktiviteti. Përdorimi i dokumenteve dhe faturave false është gjithashtu vendimtar që ngarkesa të kalojë kufirin pa ndihmën e zyrtarëve “bashkëpunues”. Përdorimi në masë të gjerë i kartave false të identitetit (ID-ve) dhe

⁷⁸ Njoftimi për shtyp i OLAF-it 12/2003, *Olaf-i paraqet prova në gjyqin mbi përfshirjen e “Lidhjes Malazeze” në trafikimin ndërkombëtar të cigarece*. 30 prill 2003, europa.eu.int/olaf; Artikulli: *Prova për rolin e Malit të Zi në tregtinë e paligjshme të cigarece*, Financial Times, 9 gusht 2001; Artikulli *Mali i Zi – Kryeministri i mohon akuzat për Kontrabandë Cigaresh*, Radioja Europa e Lirë, 7 nëntor 2003; dhe *Transporti, Kontrabanda dhe Krimi I Organizuar*, Qendra për Studimin e Demokracisë, Sofie, 2004.

kompanive fiktive me qëllim kontrabandimin dhe shmangien nga taksat dhe doganat, dëshmojnë për një shkallë të lartë sofistíkimi, në atë që duket një treg aktiv dhe i zhvilluar, shpesh duke treguar për bashkëpunim ndërmjet grupeve të krimit të organizuar dhe autoritetet publike të korruptuara.

- Në qendër të kontrabandës së organizuar të cigareve ka një kufi të hollë ndërmjet sferës ligjore kur cigaret janë porositur dhe blerë, dhe sferës së paligjshme, kur ngarkesa e blerë pajiset me dokumente të paligjshme, ose kur ajo hidhet në tregun e zi. Është pikërisht në këtë zonë ndërmjetëse delikate, aty ku kompanitë shumëkombëshe të duhanit, supozohet se bashkëpunojnë me kriminelët e organizuar, apo deklarojnë mungesën e dijenisë për tregtinë tepër të abuzuar të tranzitit, shpeshherë me dijeninë apo implikimin e autoriteteve publike. Të dy këta aktorë nxjerrin përfitimet më të mëdha nga skema e kontrabandës.⁷⁹
- Kontrabanda e stimulon kërkesën, meqenëse ofron çmime më të ulëta, por pa prekur çmimin e mallrave të shumicës. Por, gjithsesi, ruajtja e avantazheve konkurruese në treg, ofron stimuj për bashkëpunim ndërmjet prodhuesve dhe kontrabandistëve të organizuar, duke ushqyer në këtë mënyrë një rreth vicioz.
- Kontrabanda shërben si një strategji hyrjeje në treg, sepse i gjen markat e cigareve me çmime të ulëta, që është tepër e leverdisshme sidomos për konsumatorët e rinj, që kanë kujdes për imazhin e tyre dhe jetojnë në vende me të ardhura të ulëta.
- Prodhuesit e duhanit e përdorin faktin e kontrabandimit për të lobuar uljen e taksave, me argumentin se taksat dhe akcizat e larta, janë stimuli kryesor për kontrabandën.⁸⁰

Tendencat në Evropën Juglindore:

- Falë normalizimit gradual të rajonit, kontrabanda nëpërmjet kalimeve të paligjshme të kufirit është reduktuar. Aktualisht në rajon janë duke u zbatuar reforma në shërbimet doganore dhe të kufirit, përkatësisht nëpërmjet programeve të ndihmës të BE-së, siç është për shëmbull që prej vitit 1997 misioni i Komisionit Evropian CAFAO në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe ai i fillimit të viteve 2000 në Serbi dhe Mal të Zi dhe në “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.
- Kontrolli më i mirë i kufirit dhe mbyllja e kalimeve të paligjshme të kufirit, mund të ketë ndikuar që tregu i kontrabandës të mbështetet më shumë në kalimin e ligjshëm të kufijve, duke gjetur modus operandi më të sofistikuara, pra përdorur dokumente false, karta identiteti false, kompani fiktive dhe korrupsionin për të shtruar rrugën drejt strukturave të ligjshme. Duke pasur parasysh se kontrabanda e mallrave të ligjshme I përgjigjet stimujve që vijnë nga tregu dhe nga ekonomia, përpjekjet e organeve të zbatimit të ligjit për një kontroll më rigoroz të kufirit nuk mund të jenë një mburojë për këtë fenomen. Zgjidhjet e mundshme duhet të ofrojnë kombinimin e masave ekonomike me masat e natyrës ndëshkuese.

⁷⁹ Joosens dhe Raw (1998).

⁸⁰ Në vitin 2002, Komuniteti Evropian i paditi kompanitë amerikane të duhanit, me akuzën e bashkëpunimit me organizatat kriminale, që kishte çuar në një humbje vjetore të të ardhurave nga taksat dhe detyrimet doganore për Bashkimin Evropian, në miliarda euro. Akuzat përfshinin veprën e pastrimit të parave, korrupsionit dhe tregtisë me grupet terroriste si dhe sponsorizimin shtetëror të terrorizmit. Nga apeli I BE-së I dates 10 korrik 2002. Shih gjithashtu, Njoftimin për Shtyp të dates 31 tetor 2002. Në korrik të vitit 2004, Philip Morris International njoftoi se kishte arritur një marrëveshje me Komisionin Evropian, në bazë të së cilës do t'i paguante një miliardë dollarë Komisionit Evropian dhe do të merrte masa për kontrollimin e kontrabandës, ndërkohë që Komisioni Evropian do të tërhiqte padinë para Gjykatës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. (www.ash.org.uk/html/press/040709.html)

3.1.6 Pastrimi i parave

Emëruesi i përbashkët për të gjitha format e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik është fitimi. Prandaj, edhe të ardhurat e përfituara në mënyra të paligjshme mund të ri-investohen në biznese kriminale apo biznese të ligjshme, mund të konsumohen apo mund të fshihen. Për të parandaluar kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit, ato pastrohen në mënyrë që të mos dallohen prej parave të fituara me mënyra të ligjshme.

Raportimi mbi transaksionet e dyshimta financiare është shtuar në vitet e fundit nëpër Evropë,⁸¹ gjë që reflekton ndoshta jo vetëm rritjen e aktiviteteve që merren me pastrimin e parave, por edhe hapat shumë të vendosur që lidhen me gjurmimin e financimit të terrorizmit, sidomos pas 11 Shtatorit, dhe një listë të zgjeruar të enteve që bëjnë raportimin, por dëshmon edhe për përmirësimin e sistemeve kundër pastrimit të parave në shumë vende evropiane, që kanë ngritur njësi të inteligjencës financiare tepër aktive.⁸²

Të influencuara nga ky moment, edhe vendet e Evropës Juglindore kanë marrë përsipër të formojnë kuadrin e përshtatshëm ligjor kundër pastrimit të parave si dhe të ngrenë njësitë e inteligjencës financiare, shumë prej të cilave ende janë në fazat e hershme të procesit të formimit të tyre, si psh. në Bosnjë-Hercegovinë, "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", dhe Kosovë. Në vijim të kësaj, hetimi financiar, si një mjet esencial në gjurmimin e produkteve të krimit, ende mbetet për t'u zbatuar në praktikë. Për pasojë, përveç të dhënave të paverifikuara dhe vëzhgimeve që kryhen nga agjencitë e zbatimit të ligjit në rajon ka pak të dhëna zyrtare të cilat të tregojnë nëse dhe si funksionojnë sistemet e reja kundër pastrimit të parave në rajon, si dhe më pak se një dyzinë me raste (më pak se dymbëdhjetë) të pastrimit të parave, është ndjekur penalisht apo dënuar në krejt rajonin. Në ato vende, në të cilat është kapur dhe sekuestruar pasuria, vendet, kanë raportuar për një vështirësi në menaxhimin e këtyre pasurive apo në shitjen e tyre në treg. Shembujt përfshijnë paafhtësinë për të shitur një varkë të konfiskuar, të përdorur në trafikimin e qenieve njerëzore apo të shtëpive të blera me para të pista, kryesisht për shkak të frikës së pronarëve të vjetër nga blerësit e mundshëm.

Në vendet evropiane, shumica e hetimeve mbi krimin e organizuar lidhen me drogën, prandaj dikush mund të mendojë që pastrimi më i madh i parave, të ketë lidhje me drogën. Por, duke pasur parasysh edhe rendësinë e krimit ekonomik në Evropën juglindore, pastrimi i parave që burojnë nga krimi ekonomik dhe nga droga, mund të kenë pothuaj të njëjtën rendësi. Mashtrimet, evazoni fiskal dhe doganor si dhe shpërdorimet me fondet mendohet se do të zënë një pjesë të madhe të hetimeve financiare në të ardhmen.

Pastrimi i parave zakonisht mbështetet në tre faza:

- **Alokimi** - mënyrat në të cilat produktet direkte të krimit kanalizohen në sistemet financiare, kryesisht në formën e pagesave me para në dorë (cash).
- **Qarkullimi** - qarkullimi i fondeve nëpërmjet një zinxhiri transaksionesh financiare, për të zhdukur cdo lloj lidhjeje ndërmjet kapitalit të alokuar dhe origjinës së tij kriminale, në mënyrë tipike kjo ndodh nëpërmjet transferimit të parave, apo çeqeve.
- **Integrimi** - investimi i të ardhurave, që kanë origjinë kriminale në transaksionet ligjore dhe ekonomike, në mënyrë tipike kjo ndodh në pasuri të paluajtshme, objekte me vlerë, kapitale biznesi, etj.

⁸¹ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Substancave Psikotrope (1988), fillimisht synonte konfiskimin e produkteve të krimeve që lidheshin me drogën, ndërkohë që me miratimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit të vitit 1990 (CETS 141) dhe rekomandimet e mëtejshme të Forcës për Veprim Financiar (Financial Action Task Force - FATF) kishin për qëllim krijimin e sistemeve kundër pastrimit të parave që vinin në shënjestër të ardhurat nga të gjitha llojet e krimit. Këto sisteme sulmojnë para së gjithash transaksionet e dyshimta financiare, që mund të kenë lidhje me pastrimin e parave. Këshilli I Evropës (2005), fq. 45

⁸² Ibid., fq.46

Vendet e këtij projekti kanë raportuar për praninë e të treja këtyre fazave si dhe kanë dhënë shembuj të karakteristikave të pastrimit të parave, specifike për rajonin:

- Autoritetet shqiptare kanë raportuar vetëm dy raste të pastrimit të parave, të regjistruara në vitin 2003, në të cilat është konfiskuar pasuri nga kompani ndërtimi. Në vitin 2004, janë regjistruar 6 raste dhe janë marrë masa për kapjen, sekuestrimin e të ardhurave (pasurive) të krimit. Ka shumë mënyra të pastrimit të parave në Shqipëri, shumica prej të cilave vijnë nga krimet e kryera nga grupet shqiptare të krimit të organizuar që janë jashtë vendit. Sektori që mbizotëron është biznesi i ndërtimit, ndërkohë që zonat urbane dhe ato pranë bregdetit, janë zonat më tërheqëse, pasi kanë potenciale që të japin fitime të mira, nga investimi fillestar.
- Autoritetet e Bosnjë-Hercegovinës kanë regjistruar 8 raste të pastrimit të parave në vitin 2003 dhe 16 raste në vitin 2004, nga të cilat 2 raste përfshinin dy persona që u dënuan në vitin 2004. Sasia e parave që ishte pastruar në rastet e regjistruara shkon në 53 milionë KM (përafërsisht 26.5 milionë €), nga të cilat 2 milionë KM (përafërsisht 1 milionë €) janë cilësuar si të ardhura nga evazioni fiskal.

Mënyra mbizotëruese për pastrimin e parave nga evazioni fiskal dhe shmangja nga detyrimet doganore, është duke përdorur kompani fiktive, që janë krijuar me dokumente false (identitet të rremë) dhe me korrupsion. Kjo metodë, presupozohet se përfshin në një shkallë të gjerë integrimin vertikal në strukturat ligjore, falë edhe bashkëpunimit ndërmjet elitave politike dhe ekonomike.⁸³ Një element kyç I kësaj skeme është një ndarje ndërmjet entiteteve të Republikës Srpska, Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës me sisteme të ndryshme të zbatimit të ligjit, të bankave, të taksave dhe të regjistrimit.

Kompanitë fiktive përdoren në disa mënyra: kompania regjistrohet në emër të një personi real, i cili qëndron jashtë biznesit dhe që paguhet nga kriminelët për të krijuar kompaninë; kompania regjistrohet duke përdorur dokumente false, apo të vjedhura, që dëshmon për një kontroll të pamjaftueshëm nga ana e bashkisë, gjykatës apo zyrtarëve të bankave; kjo kompani e cila përdor dokumente regjistrimi false, zhvillon aktivitetin e vet tregtar; një kompani e tillë, që i përdor të gjitha metodat e treguara më sipër, dhe për më tepër mund të regjistrohet në entitetin tjetër të shtetit, e bën kontrollimin e saj edhe më të vështirë. Hapi tjetër për pastruesit e parave është që të lidhin kontakte me bankat, të identifikojnë zyrtarët e korruptueshëm, qofshin këta sportelistë, apo edhe zyrtarë të lartë të bankës si dhe të realizojnë ndërldhjen me zyrtarë të tjerë të korruptuar nga institucione të tjera, të tilla si: policia, Ministria e Financave, Ministria e Transporteve, Ministria për Telekomunikacionin, Shërbimin Kufitar si dhe kompanitë e transporteve.

Një sasi e madhe e produkteve të krimit buron nga evazioni fiskal dhe shmangja nga detyrimet doganore. Një shumë prej më se 30 000 KM (€15.000) ndahet në depozita të vogla për të evituar ndjekjen e saj dhe shpërndahet në disa llogari bankare, duke përdorur për këtë qëllim korrierë të paguar. Bosnja dhe Hercegovina ende ka një sistem të taksimit të shitjeve që e ngarkon blerësin e fundit (përfundimtar) me detyrimin e pagimit të taksave – që në këtë skemë mund të jetë kompania fiktive – dhe në këtë mënyrë e lejon shitësin, zakonisht një kompani eksport/importi që të deklarojë se nuk kishte dijeni lidhur me pavlefshmërinë e kompanisë së cilës i ka shitur mallrat. Duke pasur parasysh faktin se blerësit e fundit janë kompani “fantazmë”, të krijuara për pastrim parash, fajtorët kryesorë janë kompanitë e

⁸³ Heqja e Dragan Covic, anëtar i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës nga Përfaqësuesi i Lartë, Lord Ashdown në mars të vitit 2005, lidhej me një abuzim të mundshëm të postit. Ndaj Z. Covic është ngritur akuzë nga Zyra e Prokurorit të Bosnjë dhe Hercegovinës për përjashtime të padeklaruara nga taksat për ortakët e vet biznesmenë në kohën që ai ishte Ministër Financash në vitet 2000-2003. Faji ose pafajësia e Z. Covic mbeten ende për t'u provuar përpara gjykatës. Për detaje të tjera shih artikullin e BBC News: *Ashdown Sacks Top Bosnian Croat (Ashdown heq Një prej Krerëve të Boshnjakëve Kroatë)*, 29 mars 2005, newsbbc.co.uk/1/hi/world/Europe/4390635.stm, Vendimi i Përfaqësuesit të Lartë për të hequr Z. Covic nga detyra mund të gjendet tek faqja e internetit: www.ohr.int/decisions/removalsdec/archive.asp.

importit. Produktet e krimit integrohen duke blerë pasuri të paluajtshme, mallra luksoze dhe nëpërmjet privatizimit.

- Në Kroaci, mundësia për pastrimin e parave u krijua nga privatizimi, meqenëse procesi i privatizimit në vetvete nuk kërkonte aspak kontrollin e origjinës së parave të investuara. Kështu që nuk dihet se sa para janë pastruar gjatë privatizimit kroat. Në drejtim të integritetit të produkteve të paligjshme, bregdeti kroat mendohet se është më fitimprurësi, (kompani dhe prona të paluajtshme) dhe tërheq investitorë të brendshëm si dhe investitorë rusë. Mesatarisht, 50 njoftime (sinjalizime) për transaksione të dyshimta (STRs) janë raportuar tek organet kompetente. Në periudhën e viteve 1999-2004, policia kroate ka hetuar 42 vepra penale të pastrimit të parave, të kryera kryesisht nga shtetas kroatë, me origjinë tek krime të tjera, që lidheshin kryesisht me drogën dhe me mashtrime në fushën e taksave. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë dy vendime nga gjykata lidhur me pastrimin e parave, që kanë çuar në konfiskimin e 2.5 milionë €, të fituara nga biznesi i drogës.
- Në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", mundësia e parë për pastrimin e parave u krijua nga futja e Euros në vitin 2000. Që nga ajo kohë, shuma të konsiderueshme në cash (para në dorë) janë depozituar nga Kosova, me të cilën "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" nuk ka një qarkullim bankar elektronik. Ngjashëm me vendet e tjera në rajon, autoritetet vendase kanë kryer tre hetime, që nga viti 1997, të cilat kanë dëshmuar për lidhje të fuqishme ndërkombëtare.

Shumë prej alokimeve dhe qarkullimeve të produkteve të krimit, bëhet duke abuzuar me llogaritë bankare të personave jo-rezidentë në këtë vend; nëpërmjet transfertave elektronike; nëpërmjet sistemeve të shpejta të transferimit të parave; duke tregtuar me pasuritë e paluajtshme dhe me mallra të tjera; duke punuar në kompani të krijuara përtej detit; nga abuzimet e kompanive të import/eksportit dhe të kompanive me vetëm një punonjës, të krijuara me qëllim të fshehjes së produkteve të krimit; si dhe me anë të transferimit fizik të parave përgjatë kufijve.

Një shembull i pastrimit të parave në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" është si vijon: një kompani e tregtimit ndërkombëtar të duhanit dhe të sheqerit përdor disa llogari bankare në disa banka në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" nga të cilat ai merr fondet për të blerë kontejnerë me sasi të mëdha cigaresh, të cilat eksportohen më vonë në një vend tjetër. Aksidentalisht, nuk ekziston asnjë dokument që të provojë se kontejneri ka hyrë dhe ka paguar detyrimin doganor në vendin e importit, duke treguar se ka shumë mundësi që cigaret të jenë shitur në tregun e zi. Një metodë e ngjashme është përdorur edhe me tregtinë e sheqerit, fitimet nga e cila janë depozituar më vonë në llogari bankare në formë cash-i në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë". Gjithsesi, fitimi nuk ishte rregjistruar në regjistrat e taksave, duke treguar për evazion fiskal në vendin e importit. Kështu pra, të ardhurat e fituara në këtë mënyrë janë investuar për të blerë 35% të aksioneve në një ambient të madh tregtar, për 800 000 euro si dhe për të blerë aksione në vlerën 700 000 euro, në bankën që do të përdorej për transferimin e parave. Pjesa tjetër e fitimeve, rreth 830 000 euro është përdorur si depozitë bankare për të hapur një degë në "Ish Republikën jugosllave të Maqedonisë" të një kompanie me origjinë në Qipro. Sapo filiali i zyrës ishte ngritur, 830 000 eurot u transferuan në llogarinë bankare të kompanisë mëmë në Qipro, duke kompletuar në këtë mënyrë ciklin e pastrimit të parave. Filiali i kompanisë vazhonte të përdorej për tregtinë e sheqerit dhe të artikujve të tjerë, fitimet nga të cilat u investuan më vonë në pasuri të patundshme.

- Përmasat ndërkombëtare të këtyre rasteve të pastrimit të parave janë tepër të njohura duke i dhënë mundësinë fajtorëve të fshehin gjurmët e yre dhe të arratisen nga juridiksioni i shteteve ku ata kryejnë një pjesë të krimeve të tyre.
- Mali i Zi nuk ka dhënë asnjë informacion mbi pastrimin e parave, por prova të tërthorta sugjerojnë se ashtu sikurse Shqipëria dhe Kroacia, sektori më i prekur nga pastrimi i parave është bregdeti, i cili është shumë tërheqës për kapitalin e paligjshëm rus, ndërkohë që zona

bregdetare që kufizohet me Shqipërinë dhe që rrethon qytetin e Ulqinit mendohet se tërheq më tepër kapitalin e paligjshëm shqiptar. Janë vërejtur gjithashtu edhe disa trasferta bankare të parave në cash, përtej kufirit.⁸⁴

- Në Serbi, ashtu si në pjesën tjetër të rajonit, sasi të mëdha të ardhurash të paligjshme mendohet se vijnë nga evazoni fiskal dhe i detyrimeve doganore, sikurse dhe nga trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe nga krime të dhunshme. Produktet e krimit, pastrohen nëpërmjet procesit të privatizimit dhe duke blerë pasuri të tundshme dhe të patundshme, duke përdorur llogaritë bankare në vend dhe ato jashtë (përtej detit). Një rast i pastrimit të parave i zbuluar gjatë hetimeve të një rrëmbimi, kishte të bënte me investimin e këtyre të ardhurave në blerjen e apartamenteve dhe të automjeteve luksoze. Hetimet përfunduan me sukses falë bashkëpunimit edhe me agjenci të tjera të zbatimit të ligjit në rajon. Përveç kësaj përgjigjet që ju dhanë pyetësorit nuk treguan për asnjë rast të regjistruar të pastrimit të parave.
- Kosova miratoi një kuadër ligjor për parandalimin e pastrimit të parave në fillim të vitit 2005. Qendra për Informim Financiar e UNMIK-ut (FIC) është tashmë e ngritur dhe është në një fazë të hershme operacionale. Megjithëse ende nuk është përfunduar asnjë procedim penal mbi bazën e kuadrit të ri ligjor për parandalimin e pastrimit të parave, janë hapur disa çështje, të cilat janë aktualisht nën hetim.

Metodat për pastrimin e parave në Evropën Juglindore mendohet se janë në njëfarë mënyre më pak të sofistikuar sesa në vendet e tjera evropiane dhe të botës, me tregje të zhvilluara financiare.⁸⁵ Edhe pse shumica e shteteve evropiane raportojnë se investimi i produkteve të krimit në bizneset e ligjshme është bërë pjesë e rregullt e modus operandi të grupeve të krimit të organizuar, që duket ndër të tjera edhe në numrin e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për pastrim parash⁸⁶, këto praktika mbetet ende për t'u pasuar nga vendet e Evropës Juglindore.

⁸⁴ Mbështetur në intervistat me zyrtarë të zbatimit të ligjit të Malit të Zi, gjatë uorkshopeve dhe semiinareve të Projektit CARPO.

⁸⁵ Task Forca për Veprim Financiar ka treguar për prirjet e mëposhtëme në pastrimin e parave dhe për lidhjet e mundshme të tij me terrorizmin: transfertat elektronike si një mënyrë e shpejtë dhe efiçente e lëvizjes së fondeve, që mund të përdoren gjithashtu për financimin e terrorizmit; keqpërdorimi i një organizate jo-qeveritare mund të jetë një "problem eventualisht serioz i financimit të terrorizmit"; dobësia e sektorit të sigurimeve, që përkeqësohet nga ligjet jo harmonike mund të abuzohet për qëllime të integritetit të të ardhurave nga krimi; anëtarët e elitës politike me role të tashme ose të shquara të shquara në krimin financiar, në veçanti në lëmin e korrupsionit, shpesh "i fshehin pasuritë e tyre të paligjshme, me anë të rrjeteve të kompanive simotra, dhe të bankave "përtej detit"; dhe "portierët" - profesionistë, që specializohen në drejtësi dhe ekonomi, shpesh lehtësojnë operacionet e pastrimit të parave. Shih FATF (2004).

⁸⁶ Vlerësimi i rregullt i efektivitetit të luftës kundër pastrimit të parave është ndërmarrë në kuadër të mekanizmit monitorues të Këshillit të Evropës MONEYVAL (www.coe.int/moneyval)

3.2 GRUPET E KRIMIT TE ORGANIZUAR

3.2.1 Rastet dhe grupet e krimit të organizuar

Vlerësimet lidhur me numrin e grupeve dhe rasteve të krimit të organizuar shtrojnë probleme të mëdha. Pavarësisht kësaj, përgjigjet që i janë dhënë pyetësorit nga zonat e projektit sugjerojnë sa më poshtë:

- Grupet më me influence të krimit të organizuar janë vendase, me lidhje tepër të forta në rajon dhe në raste të caktuara dhe me vendet e Bashkimit Evropian.
- Në drejtim të kërcënimeve që grupet e krimit të organizuar nga rajoni, shtrojnë për BE-në, grupet etnike shqiptare me origjinë nga Shqipëria, Kosova dhe “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” kanë përparuar dhe nga ndihmës të grupeve të tjera të krimit të organizuar kanë marrë nën kontroll të plotë disa prej tregtve, siç mund të jenë për shembull, trafiku i drogës, emigrimi i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore, në zona specifike gjeografike. Avantazhi i tyre mendohet se mbështetet në strukturën e forte organizative, që bazohet tek afërsia etnike dhe gatishmëria për të përdorur dhunën.⁸⁷
- Mungesa e të dhënave të hollësishme mbi grupet e krimit të organizuar në Ballkan i atribuohet faktit se shumica e shteteve kanë nisur të mbledhin sistematikisht të dhëna mbi krimin e organizuar vetëm disa vjet të shkuara dhe vende të tilla si Mali I Zi, nuk e kanë filluar ende një gjë të tillë. Si rezultat, sistemet e informacionit mbi krimin për të dhënat që kanë lidhje me krimin e organizuar ndryshojnë ndërmjet shteteve dhe disa shtete, kur jepnin të dhëna mbi rastet e krimit të organizuar në tregje të ndryshme, nuk ishin në gjendje të jepnin të dhëna rreth grupeve të krimit të organizuar, të përfshira në to. Prandaj tabelat e paraqitura më poshtë, janë më tepër një tentative:

Tabelat: Numri i rasteve dhe grupeve të krimit të organizuar në vitet 2003 dhe 2004

Shqipëria

Numrat me korsive i referohen numrit total të rasteve të regjistruara dhe të kriminelëve të implikuar për vitin 2004, të cilat mund të përfshijnë ose jo krimin e organizuar

	Rastet e regjistruara të Krimit te Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimit të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminelët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	17	17	17 (17)	52 (52)	
Trafiku i Drogës	40 363	40	40 (40)	142 359	
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	17	17	17 (17)	61	
Kontrabanda e Personave	16	16	16(16)	58	
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	14	14	14(14)	62	
Pastrimi i parave	1	1		2	
Korrupsioni	1	1	1(1)	4	

⁸⁷ Europol 2004, faq. 8.

Bosnia dhe Herzegovina

Numrat e raportuar i referohen një numri total të rasteve që nuk lidhen detyrimisht me krimin e organizuar, ndërkohë që numrat që janë raportuar në kllapa [xxx] I referohen numrit të rasteve të vitit 2004.

SHENIM: Numrat me korsive i referohen rasteve dhe dënimeve nga gjykatat e Bosnjë Hercegovinës, (niveli shtetëror). Në vitin 2005, Gjykata dha katër vendime dënimi për gjashtë kriminelë që ishin implikuar në krimin e organizuar. Tregjet kriminale në të cilat operonin këta kriminelë të organizuar nuk janë specifikuar.

BdheH* - Numrat e dënimeve të paraqitura, përfaqësojnë numrin e dënimeve në Republikën Srpska dhe jo numrin e dënimeve në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës dhe në Qarkun e Brcko-s.

	Rastet e regjistruara të Krimin të Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimin të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminelët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	941[907]	941[907]	-	1169[1177]	298[168] raste; 435 [212]kriminelë*
Trafiku i Drogës	368[332]	368[332]	-	427[412]	54[46] raste; 73 [55] kriminelë; 3 raste; 6 kriminelë
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	14[11]	14[11]	-	19[17]	5[7] raste; 8[13] kriminelë; 1 rast; 6 kriminelë
Kontrabanda e Personave	3[5]	3[5]	-	2[5]	-
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	-	-	-	-	-
Pastrimi i parave	8[16]	8[16]	-	10[26]	2 raste (dënuar në 2005)
Korrupsioni	-	-	-	-	-

Croatia

	Rastet e regjistruara të Krimin të Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimin të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminelët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	14	12	14 (10)	97 (63)	3
Trafiku i Drogës	86	77	82 (24)	294 (122)	10 raste; 6 grupe; 39 kriminelë
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	3	2	3(1)	11(3)	
Kontrabanda e Personave	15	15	11 (7)	83 (50)	5 raste; 1 grup
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	18	17	17 (12)	127(101)	1 rast
Pastrimi i parave	1	1	1(1)	1(1)	
Korrupsioni	2	2	2(2)	6 (6)	

Kosova

Numrat e paraqitura në kllapa [xxx] i referohen numrit total të rasteve, disa prej të cilave implikojnë krimin e organizuar.

	Rastet e regjistruara të Krimit të Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimit të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminelët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	3 [4968]*	-	3	600	
Trafiku i Drogës	15[256]	15	-	150	
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	82[103]	0	-	- [86 kriminelë të arrestuar]	
Kontrabanda e Personave	[234]	-	-	-	
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	[332]**			467**	
Pastrimi i parave	2	-	-	-	
Korrupsioni	-	-	-	-	

Kosovë** - Numri total i rasteve të regjistruara të krimit ekonomik është 4968, nga të cilat vetëm 3 janë të lidhura me krimin e organizuar.

Numri total i rasteve që lidhen me trafikun e drogës (trafikimi dhe prodhimi) në Kosovë dhe jashtë është 256, nga të cilat 15 lidhen me krimin e organizuar.

Numri total i kriminelëve të implikuar në tregun e drogës (trafikimi, prodhimi dhe shitja) është 458, nga të cilët më tepër se 150 kriminelë kanë lidhje me raste të krimit të organizuar.

Numri total i rasteve të kontrabandës dhe të falsifikimit të mallrave të ligjshme është 332, në të cilat janë implikuar më shumë se 467 kriminelë, nga të cilët nuk dihet nëse dhe sa janë të lidhur me krimin e organizuar.

Mali i Zi

Me përjashtim të trafikimit të qenieve njerëzore, që është paraqitur e theksuar me të zezë, numri i rasteve të krimit të organizuar në tregjet e tjera të krimit nuk është i njohur. Prandaj, numrat që janë raportuar këtu i referohen numrit total të rasteve, që nuk lidhen detyrimisht me krimin e organizuar. Numrat e paraqitur në kllapat [xxx] i referohen numrit të rasteve në vitin 2004.

	Rastet e regjistruara të Krimit të Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimit të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminelët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	1358[1320]	-	-	1877[1707]	
Trafiku i Drogës	300 (cases of drug possession per year)	-	-	250-300 kriminelë në vit	
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	10	-	7	31	
Kontrabanda e Personave	-	-	-	-	
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	-	-	-	-	
Pastrimi i parave	-	-	-	-	
Korrupsioni	302(221)	-	-	(576)	

Serbia

	Rastet e regjistruara të Krimit të Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimit të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminalët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	38	38	12 (10)	158(104)	
Trafiku i Drogës	19	15	47 (19)	213(75)	
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	17	8	16(7)	106 (83)	
Kontrabanda e Personave	27	19	16(5)	64(37)	
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	17	16	9(7)	70(32)	
Pastrimi i parave	-	-	-	-	
Korrupsioni	18	15	4(4)	81(53)	

“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”

	Rastet e regjistruara të Krimit të Organizuar	Rastet e Hetuara ose të Ndjekura Penalisht	Grupet e Krimit të Organizuar të Implikuar (Ndjekur Penalisht)	Kriminalët e regjistruar (të ndjekur penalisht)	Dënimet
Krimi Ekonomik	8[133]	-	8	35[155]	
Trafiku i Drogës	14 [19]	-	14[40]	48	
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	21[19] 73	-	13[42]	52 121	
Kontrabanda e Personave	8[21]	-	4	12[28]	
Kontrabanda dhe Falsifikimi i Mallrave të Ligjshme	8[14]	-	8	11[17]	
Pastrimi i parave	-	-	-	-	
Korrupsioni	[32] 536			[33] 664	

Shënim: - Numrat në kllapat [xxx] paraqesin paratë e falsifikuara dhe të zhvatura me anë të kërcënimit, nga të cilat 11 rastet me 22 kriminelët e implikuar i referohen zhvatjes me anë të kërcënimit, ndërsa pjesa e mbetur, i referohet falsifikimit të parave.

3.2.2 Struktura e grupeve të krimit të organizuar

Koncepti i grupeve të krimit të organizuar si grupe etnikisht homogjene, të strukturuar formalisht dhe hierarkisht dhe organizata kriminale burokratike me shumë funksione, që konfrontohen me shoqërinë, është duke ndryshuar.⁸⁸ Raporti i Këshillit të Evropës, mbi Gjendjen e Krimit, i vitit 2002, tregon për një kapërcim të rëndësishëm që tregon për decentralizimin e një Cosa Nostra, dikur tepër hierarkike si dhe “rrafshimin” dhe “operimin në formë rrjetesh” të grupeve të krimit dhe tregjeve në vendet e tjera.⁸⁹

⁸⁸ Shembujt përfshijnë organizatat mafioze të tipit të familjes, të tilla si Cosa Nostra në Sicili; grupet nga ish Bashkimi Sovjetik, të cilat shfaqin një ndarje të qartë të detyrave, të tilla si shefat e brigadës, luftëtarët, financierët, personeli i rrjetit, etj, ku shpesh paguhen edhe kuota anëtarësie; si dhe organizatat kriminale anglosaksone “të tipit firmë” me anëtarë të përhershëm, role të ndara, dhe një zinxhir të qartë komandimi. Shih Von Lampe (2001).

⁸⁹ Shih Këshilli i Evropës: Krimi i Organizuar në Evropë: Kërcënimi i Krimit në fushën e Kibernetikës, Raport mbi Gjendjen e Krimit, 2004.

Në Evropën Juglindore, rrjetet kriminale që bashkëpunojnë përgjatë kufijve duket se janë vendimtare. Integrimi vertikal, i kuptuar si një hierarki e mirëpërcaktuar ndryshon në varësi të tregut kriminal. Në këtë aspekt, tregu i drogës është tregu më vertikal dhe tregu i kontrabandës së personave është tregu më pak vertikal. Grupet e krimit të organizuar të implikuara në krimin ekonomik janë relativisht të integruara, nga pikëpamja vertikale, për aq kohë sa ato janë të lidhura me elitat politike dhe ekonomike. Përsa i takon strukturave organizative, mund të thuhet se struktura e rrafshët prej rrjeti, në të cilën detyra dhe shërbime të ndryshme kryhen “nga jashtë” është shenja dalluese e saj.

Etnia e përbashkët (ekskluzive) është një kriter, gjithnjë e më i parëndësishëm, meqenëse në shumë vende, grupet e krimit të organizuar, mendohet se janë shumë-etnike, ku dominojnë anëtarët, që janë shtetas të vendit, në të cilin kryehen krimet. Përrjashtim përbëjnë grupet shqiptare të krimit të organizuar, të cilat janë pothuaj ekskluzivisht të përbërë vetëm nga shqiptarë etnikë, por të cilat mund të ngarkojnë me kryerjen e aktiviteteve të caktuara, grupe të tjera etnike që operojnë në të njëjtën zone gjeografike.

Nocioni i organizatave me hierarki të mirëpërcaktuar, duket se gjithnjë e më tepër po zëvendësohet nga rrjetet kriminale, që konsistojnë në individë-krimienlë, apo në bërthama kriminelësh, me një shkallë të ndryshme depërtimi në strukturat e ligjshme, (më shpesh struktura të ligjshme tregtare), që rreshtojnë profesionistë, si për shembull, juristë, financierë, ekspertë të shërbimeve të ndryshme financiare, noterë publikë për shërbime të caktuara, përkatësisht për të realizuar krimin ekonomik dhe pastrimin e parave.

Emëruesi i përbashkët për të gjitha grupet apo rrjetet e krimit të organizuar në Evropën Juglindore është pastrimi i parave, dhe në njëfarë mase korrupsioni (në nivel të ulët apo të lartë), që lidh strukturat e ligjshme me strukturat e paligjshme, të cilat janë organizuar me qëllim kryerjen e krimeve.

3.2.3 Modi operandi

Një vlerëzim i modi operandi (metodave të punës) të grupeve të krimit të organizuar, na pajis me disa konstatime, lidhur me marrëdhënien ndërmjet grupeve të krimit të organizuar dhe shoqërisë, dhe nëse kjo marrëdhënie është konfliktuale apo harmonike.

3.2.3.1 PËRDORIMI I DHUNËS DHE FRIKËSIMIT

Dhuna shfrytëzohet për të forcuar disiplinën brenda vetë grupit të krimit të organizuar, apo kundër grupeve rivale. Grupet etnike shqiptare gjykohet se janë ndër grupet më të dhunshme në këtë drejtim, megjithëse mosmarrëveshje të dhunshme janë vërejtur edhe në grupet nga Bosnjë Hercegovina dhe nga Serbia.

Frikësimi dhe dhuna kundër viktimave janë të lidhura pazgjidhshmërisht me grabitjen, zhvatjen e parave duke përdorur kërcënimin dhe shantazhin, sikurse dhe me trafikimin e qenieve njerëzore. Ai është gjithashtu i zakonshëm për tregun e drogës, si një mjet për të zgjidhur pretendimet ndërmjet klaneve. Megjithëse dhuna në trafikimin e qenieve njerëzore ka qenë metoda kryesore për të siguruar bashkëpunimin e viktimave, prirjet e fundit tregojnë se përdorimi i dhunës mund të bëhet shkas për tërheqjen e vëmendjes nga ana e organeve të zbatimit të ligjit dhe “të dëmtojë biznesin”, duke i detyruar kriminelët që të gjejnë metoda alternative për të garantuar bashkëpunimin nga ana e viktimave, të tilla si dhënia e një page modeste, dhe kushte më të mire për jetesë, sikundër aplikohet nga trafikantët e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe të Kosovës.

Në shumicën e vendeve, dëshmitarët e rasteve të krimit të organizuar mendohet se janë në rrezik, sidomos nëse ata janë bashkëpunëtorë të drejtësisë, (që përfshin edhe vetë kriminelët). Evropa Juglindore është mbrapa vendeve të tjera evropiane në garantimin e programeve për mbrojtjen e

dëshmitarit, duke u ballafaquar me kufizime të fondeve, si dhe me një hapësirë të ngushtë gjeografike, në të cilën mund të transferojnë viktimat. Kjo është arsyeja se përse janë duke u studiuar zgjidhje rajonale për këtë problem.

Në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore, grupet e krimit të organizuar i shmangen konfrontimeve të hapura me autoritetet publike. Sidoqoftë ka edhe përjashtime:

- Në Shqipëri, përdorimi i dhunës nga kriminelët e organizuar kundër zyrtarëve reflektohet në një numër të madh të zyrtarëve të zbatimit të ligjit, të vrarë viteve të fundit.
- Në Serbi, pas shumë vjetëve të një marrëdhënieje harmonike ndërmjet forcave speciale dhe forcave të sigurimit si dhe regjimit të Miloshevicit, përpjekjet e bëra nga qeveria e re, nën udhëheqjen e Zoran Dijindicit për shkatërrimin e këtyre lidhjeve dhe për kufizimin e pushtetit të krimit të organizuar, përfunduan me vrasjen e tij dhe tentativa për vrasjen e zyrtarëve të tjerë të lartë të shtetit, në shtator të vitit 2003.

3.2.3.2 KORRUPSIONI DHE INFLUENCA

Influencimi i administrates publike, politikanëve, administrates së taksave dhe doganeve, shërbimit të kontrollit të kufirit, sistemit të drejtësisë penale, mediave dhe sektorit privat, nëpërmjet përdorimit të rryshfeteve dhe mjeteve të tjera të korrupsionit, sic është mbështetja tek marrëdhëniet e klientelizmit, nepotizmi, favoritizmit, lidhjeve familjare, raporteve etnike, raportet me persona me pozitë të fuqishme, apo "me persona të ekspozuar politikisht" – kanë qenë mjetet kryesore të përdorura nga grupet e organizuara, për të ndërtuar ura që i lidhnin me sektorin e ligjshëm. Financimi i politikanëve të veçantë, i partive politike dhe fushatave zgjedhore, madje në raste të caktuara dhe i kriminelëve të luftës luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Korrupsioni ushqen marrëdhënie afat-gjata, të cilat janë më të qëndrueshme dhe më të forta, sesa ato që mbështeten tek dhuna dhe tek frikësimi.

Grupet e krimit të organizuar mund ta përdorin korrupsionin duke punësuar, në mënyrë strategjike, ekspertë të së drejtës dhe të ekonomisë, të cilët do të shërbejnë më vonë si ndërmjetës apo negociatorë, apo duke vendosur ortakë të tyre në pozicione të caktuara administrative dhe politike, përkatësisht në sektorin e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit.

Zyrtarët e korruptuar mund t'i tolerojnë, ose të marrin pjesë në aktivitetet kriminale, apo mund të mbrojnë kriminelët nga ndjekja penale, apo – në disa raste të zyrtarëve të lartë – të sponsorizojnë grupe të krimit të organizuar. Në disa vende në tranzicion korrupsioni duket se ka përshkuar të gjitha strukturat e jetës publike, duke përfshirë strukturat e zbatimit të ligjit, dhe sistemin e drejtësisë penale. Pagat e ulëta, papunësia, pasiguria dhe varfëria dhe shpesh shembulli i dhënë nga vetë zyrtarët e lartë të shtetit, i bëjnë funksionarët e tjerë publikë, objekte të prekshme dhe shpesh partnerë të grupeve të krimit të organizuar. Sa më i madh të jetë depërtimi në sektorin e ligjshëm dhe atë qeverisës, aq më i lartë është elasticiteti i krimit të organizuar për t'u përshtatur ndaj situatave të reja dhe për të ndryshuar metodat e veta të punës (modi operandi).

Ndërkohë që ka një perceptim të përgjithshëm – sikurse raportohet nga shumica e shteteve – të lidhjeve të ngushta ndërmjet korrupsionit dhe krimit të organizuar, të dhënat e sakta dhe analizat precize mbi lidhjet ekzakte ndërmjet rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar mbeten të kufizuara.

- Në vitin 2004, Shqipëria ka raportuar 443 raste të ndjekjes penale për veprën e korrupsionit, megjithëse nuk është e qartë se sa prej këtyre rasteve kanë pasur lidhje me krimin e organizuar.
- Kroacia ka regjistruar 2 raste të korrupsionit që kanë pasur lidhje me grupet e krimit të organizuar, në të cilat kanë qenë të implikuar 3 persona. Të dyja rastet janë ndjekur penalisht.

Janë regjistruar edhe raste të tjera të korrupsionit, në të cilat kanë qenë të përfshirë gjyqtarë dhe zyrtarë të gjykatave të punësuar në zyrat e regjistrimit, që lëshonin certifikata. Nuk këto raste nuk është zbuluar ndonjë lidhje me krimin e organizuar.

- Sipas të dhënave zyrtare të paraqitura nga Mali I Zi, janë regjistruar 305 raste të korrupsionit në vitin 2003 dhe 221 raste në vitin 2004, nga të cilat asnjë nuk ka pasur lidhje me krimin e organizuar. Pjesa më e madhe e rasteve të korrupsionit në Malin e Zi, për të cilat janë dhënë shumë pak dënime, ka pasur të bëjë me abuzimin e postit zyrtar.⁹⁰
- Serbia ka regjistruar 18 raste, në të cilat janë përfshirë 4 grupe të krimit të organizuar dhe 81 kriminelë. Nga këto, 15 raste janë ndjekur penalisht, së bashku me të katër grupet dhe 53 kriminelë.
- Kosova ka raportuar për 20 raste të krimit ekonomik dhe korrupsionit në vitin 2004.
- Në vitin 2004, "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka regjistruar 536 raste të korrupsionit, me 664 kriminelë të implikuar, nga të cilat 505 raste i referohen abuzimit me postin, ndërkohë që 31 raste përfshijnë veprat penale korruptive. Nuk është zbuluar asnjë lidhje me krimin e organizuar.

Elementi kryesor që mundëson qëndrueshmërinë dhe fuqizimin e grupeve kriminale që operojnë në Ballkan është aftësia e tyre për të vepruar në një apo më shumë territore dhe në disa tregje, aftësia e tyre për të përdorur një shumëllojshmëri rrugësh ligjore dhe klandestine, metodologjia prej menaxhuesi në trafikimin e qenieve njerëzore, dhe aftësia e tyre për të ofruar gjithçka që kërkon tregu. Në Ballkan dhe veçanërisht, në Kosovë, Bosnjë Hercegovinë dhe "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", grupet kriminale kanë qenë në gjendje të transformojnë si strukturën e tyre, ashtu edhe strategjitë operative, me qëllim që të përshtaten me efektivitet ndaj programeve anti-trafik, të zbatuara nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe nga ligjvënësit.⁹¹

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, portrete menaxherësh të rinj në moshë dhe në eksperiencë, duket se po bëjnë shumë investime, në biznesin e trafikimit dhe punojnë për të depërtuar në strukturat e ligjshme qeverisëse, duke u mbështetur tek korrupsioni. Po ashtu, përdorimi i hallkave mbrojtëse tepër komplekse, krijon mundësi për rritje dhe konsolidim. Hallka e pare mbështetet tek korrupsioni i zyrtarëve shtetërorë, punonjësve të zbatimit të ligjit (nga policia dhe ushtria), politikanëve dhe ngandonjëherë edhe të zyrtarëve të huaj të ambasadave dhe zyrave konsullore (për të modifikuar mënyrat dhe format e mënyrat e operimit). Hallka e dytë është për të siguruar mbrojtje emergjente dhe mbështetet në strukturat logjistike për të lëvizur viktimat nga vende të dukshme, në apartamente private, tek agjencitë e shoqërimit, etj. Hallka e tretë mbrojtëse mbështetet në rritjen e standardeve të jetesës për viktimat, nëpërmjet pagesave më të mira dhe ambjenteve më të mira të punës, për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe një kontroll më të mire.⁹²

3.2.3.3 PRAKTIKAT MASKUESE

Praktikat maskuese janë kthyer në një modus operandi të rëndësishëm për grupet e krimit të organizuar për të mbrojtur veten e tyre nga organet e zbatimit të ligjit dhe për të ruajtur pozitën e tyre në tregun kriminal në raport me rivalët e tyre. Ato janë edhe arsyeja kryesore e zgjatjes dhe ndërlikimit të hetimeve kundër krimit të organizuar.

⁹⁰ Në kodin penal të Malit të Zi, korrupsioni nuk është përcaktuar si një vepër penale e veçantë. Aty kemi të bëjmë më shumë me një seri veprash penale, me elemente të korrupsionit, siç janë mitdhënia, ose mitmarrja, abuzimi me postin zyrtar, dhe abuzimi me postin në sektorët ekonomikë, shpërdorimi i fondeve, etj, të cilat dënohen me burgim nga 2 deri në 12 vjet. Arsyeja e numrit të vogël të dënimeve mendohet se ka të bëjë me sigurimin e provave, sidomos për mitdhënien dhe mitmarrjen. Përdorimi i teknikave të posaçme hetimore (SIM-s) nuk lejonet raste që kanë lidhje me korrupsionin.

⁹¹ Shih IOM-I (korrik 2004), faq. 12.

⁹² Ibid, faq. 13.

Praktika më e rëndomtë e maskimit është mbrojtja e komunikimeve ndërmjet kriminelëve, dhe ata përdorin në mënyrë masive, telefonë celularë, me karta rimbushëse SIM, sikurse dhe mjete të tjera të ndryshueshme për komunikimin, duke i ndërruar ato shpesh, duke përdorur mesazhe të koduara kur flasin apo shkruajnë, si dhe duke përdorur të dhëna të koduara. Në disa raste kriminelët kanë qarkulluar shumë vetëbesim dhe e ndajnë qarkullim pak rrezikun e zbulimit, saqë ata organizojnë takime "biznesi" në publik, si për shembull në rastet e transportit të paligjshëm të emigrantëve.

Maskimi me qëllim mbrojtjen nga autoritetet publike, mund të përfshijë edhe kundër-survejinë, rryshfjetin, ndërtimin strategjik të rrjeteve, blerjen e informacionit apo dhe përgjimin e autoriteteve hetuese.

Metodat ofensive, duket se nuk praktikohen shumë shpesh, por ato përfshijnë gjurmimin aktiv të nëpunësve civilë dhe të anëtarëve të gjyqësorisë, presionet mbi ta apo mbi anëtarët e familjeve të tyre, krijimin e kushteve për shantazh si dhe metoda të tjera. Sidoqoftë, të gjitha këto janë vërejtur nga raporte të pakonfirmuara.⁹³

Duke pasur parasysh rëndësinë e krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave, që është e përbashkët për të gjitha tippet e krimeve, përdorimi i strukturave tregtare të ligjshme nga krimi i organizuar është i shumëpërhapur dhe realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të një ose më shumë bashkëpunëtorëve brenda këtyre strukturave (banka ose punonjës në zyrat e regjistrimit, etj) si dhe duke zotëruar apo investuar në strukturat e ligjshme, apo duke ngritur kompani fiktive.⁹⁴

Sektorë të tillë si pronat e paluajtshme, shërbimet që kanë lidhje me automjetet, sektori I argëtimit dhe ndërtimit, industria e seksit ose e lojërave të fatit, firmat e sigurimit, transporti, kompanitë e import/eksportit, bankat dhe çdo lloj mundësie tjetër për biznes fitimprurës, preferohen nga grupet e krimit të organizuar, sidomos për faktin se këto janë biznese shumë të fuqishme në para (cash). Sapo grupet e krimit të organizuar bëhen më të sofistikuara dhe profesionale, secili sektor mund të përdoret, duke filluar nga investimi në aksione në një kompani të huaj, krijimi ose pjesëmarrja në holdingje financiarë, si dhe dhënia e huave, apo investimi në një kompani, me qëllim përvetësimin e saj të mëvonshëm.

Lidhjet e ngushta të grupeve të krimit të organizuar me strukturat e ligjshme tregtare, përgjatë Evropës Juglindore, tregojnë për një tendencë të fuqishme të intensifikimit të lidhjeve ndërmjet botës së ligjshme dhe të paligjshme, ndërkohë që kufijtë ndërmjet të dyjave, janë sa vijjnë e më të zbehta.

3.2.3.4 OPERACIONET NDËRKOMBËTARE

Në epokën e globalizimit, kontrolli i territorit është më pak i rëndësishëm se sa shfrytëzimi global i mundësisë për përfitime kriminale. Në rastin e Gadishullit Ballkanik, globalja kufizohet mjaft tek rajonalja, por me lidhje të forta me vendet e Bashkimit Evropian.⁹⁵

Raportet e paraqitura nga shtetet tregojnë për një përfshirje të kombësive të shumëllojshme në praktikën e krimit të organizuar që kapërcejnë kufijtë e vendeve. Në të njëjtën kohë, pjesa më e

⁹³ Intervistat me zyrtarë të zbatimit të ligjit nga rajoni, të zhvilluara në periudhën shtator 2004 – qershor 2005.

⁹⁴ Përdorimi i strukturave tregtare i shërben qëllimeve të ndryshme, të tilla si: maskimi apo mbulimi i aktiviteteve të paligjshme; garantimi i mbështetjes logjistike dhe i shërbimeve të tjera ndihmëse për aktivitetet kriminale; lehtësimi i pastrimit të parave; lidhja ndërmjet autoriteteve publike dhe strukturave të tjera të ligjshme të shoqërisë; pjesëmarrja në tenderat publikë; shumëllojshmëria e interesave të biznesit; kontrolli ose monopolizimi i tregjeve. Shih KE (2005). faq. 57.

⁹⁵ Sipas Nenit 3(2) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar, një vepër penale është "me natyrë ndërkufitare" nëse: (a) kryhet në më shumë se një Shtet; (b) Kryhet në një shtet, por një pjesë e rëndësishme e përgatitjes, planifikimit, drejtimit dhe kontrollimit, realizohet në një vend tjetër; (c) Kryhet në një Shtet, por implikon një grup të krimit të organizuar, që është i angazhuar në aktivitete kriminale, në më shumë se një Shtet; ose (d) Kryhet në një Shtet, por ka pasoja thelbësorë në një Shtet tjetër.

madhe e të dyshuarve janë prej vendit, në të cilin kryhet vepra penale, duke mbështetur argumentin se krimi i organizuar konsiston në rrjete, në të cilat individë, apo grupe të vogla, janë të implikuara në transaksione të veçanta në një shtet të caktuar.

4 Vlerësimi i kërcënimit

Kërcënimi i krimit të organizuar ndaj të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës ka qenë për një kohë të gjatë në axhendën e Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian. Në këtë drejtim vendet e Europës Jug – Lindore nuk përbëjnë përjashtim. Prespektiva e aderimit në Bashkimin Europian për rajonin është e lidhur në mënyrë të ngushtë me përpjekjet e këtyre vendeve në luftën kundër krimit të organizuar dhe në përmirësimin e qëndrueshëm të shtetit të së drejtës, ashtu sic është përmendur dhe në Road Map-in e Bashkimit Europian si dhe në Marrvëshjet e Stabilizim Asociimit.

Krimi i organizuar dhe ai ekonomik mbeten një shqetësim i madh për vendet Europiane. Shfrytëzimi i rrugëve Ballkanike për aktivitet e krimit të organizuar në rajon si dhe në Bashkimin Europian ka shumë mundësi që të jetë i vazhdueshëm. Për më tepër, pozicioni i “Ballkanit Perëndimor” si një ishull që nuk bën pjesë në BE, i rrethuar nga vende anëtare të BE-së si rrjedhojë e antarësimit të Rumanisë dhe Bullgarisë, parashikuar për vitin 2007, ka shumë të ngjarë që të rrisë shpresën në vendet e Europës Jug – Lindore për antarësim në BE. Kështu, krijimi dhe zbatimi i një politike publike efektive dhe të bazuar në njohuri mbi krimin e organizuar dhe atë ekonomik është i një rëndësie të veçantë.

Raporti i Situatës mbi Situatën e krimit të organizuar dhe ekonomik në Europën Jug – Lindore duhet kështu të përbëjë një hap përpara drejt kutpimit më të mirë të këtij fenomeni dhe i pari në llojin e vet i hartuar për të vënë në pah dimensionin e tij rajonal. Me përmirësimin në të ardhmen e kapaciteteve të këtyre vendeve për analizimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi krimin e organizuar, do të përmirësohet gjithashtu cilësia e analizës strategjike të krimit.

Europa juglindore është e pozicionuar në mes të kërkesës për mallra të jashtëligjshëm nga vendet e zhvilluara të Europës Perëndimore dhe furnizuesve të mallrave të tillë në Europën Lindore. Në këtë mënyrë është kthyer në një zonë të rëndësishme tranziti për mallra dhe shërbime të jashtëligjshme, impakti i të cilave ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe në vendet që ndodhen jashtë rajonit. Në anën tjetër, krimi ekonomik që ka një shtrirje të gjerë në rajon ka një ndikim serioz në të ardhurat publike, kapacitetet e institucioneve shtetërore që varen nga këto të ardhura dhe legjitimitetin e institucioneve qeverisëse dhe gjyqësore. Efektet e këtij fenomeni janë ndier në mënyrë të veçantë nga vetë qytetarët e vendeve të Ballkanit. Balancimi i këtyre dy prioritetëve do të përbëjë një sfidë të madhe për rajonin në të ardhmen e afërt.

Procesi i tranzicionit dhe i futjes në BE kërkon reforma tërësore në kudirin ligjor dhe institucional jo vetëm në fushën penale, por gjithashtu dhe në fushën e ekonomisë, qeverisjes, politikës, sigurimit social, arsimit, shëndetësisë, etj. Të gjitha këto reforma janë të rëndësishme dhe kërkojnë përkushtim dhe kohë në mënyrë që këto vende të kalojnë me sukses periudhën e tranzicionit dhe futjes në BE. Natyrisht, një fenomen social si krimi i organizuar nuk mund të luftohet vetëm nëpërmjet mjeteve shtypese. Gjithashtu masat ndaluese si dhe faktorë të tjerë, duke përmendur zhvillimin ekonomik, luajnë një rol të rëndësishëm dhe si të tilla kërkojnë vëmendje të posaçme.

4.1 KËRCËNIMET KRYESORE

Tregjet e krimit në Europën Jug – Lindore janë duke u zhvilluar. Që prej mundësive të siguruara për krimin e organizuar nga konfliktet në Europën Jug – Lindore në vitet 1990, krimi i organizuar është shndërruar në një fenomen me kompleks. Kërcënimet kryesore të identifikuara nga këto vende janë krimi i organizuar në lidhje me drogën, krimin ekonomik, trafikimin e qenieve njerëzore dhe së fundmi korrupsionin, i cili është i lidhur me të gjitha këto shkelje ligjore.

4.1.1 Drogat

Nga të qënit ekskluzivisht një zonë tranziti për drogën nga Lindja në Perëndim, rajoni së fundmi është kthyer dhe në një pikë tranziti nga Përqendimi në Lindje për drogat sintetike dhe lëndët parapërgatitore kimike për prodhimin e drogës. Gjithashtu, rajoni nuk është me vetëm një hallkë e rëndësishme në zinxhirin furnizues të drogës, por në mënyrë të konsiderueshme po shndërrohet në një treg konsumi. Megjithë mungesën e të dhënave për përdoruesit e drogës, fakt që mund të ndihmonte në vërtetimin e këtij pretendimi, vendet e rajonit kanë raportuar një shqetësim në lidhje me numrin në rritje të përdoruesve të drogës nga ana e të rinjve, në veçanti në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë". Për të vlerësuar dhe peshuar këto shqetësime, vendet e rajonit duhet të ndërmarrin anketime publike të përdoruesve të mundshëm të drogave. Në qoftë se tendenca në rritje e përdoruesve të drogës rezulton e vërtetë, atëherë politika kundërpërgjigjëse duhet të jetë një paketë e përbërë si nga masa shtypëse ashtu dhe nga masa ndaluese që kanë të bëjnë me abuzimet e drogës.

Pas më shumë se një dekade në aktivitet, trafikantët e drogës kanë fituar një fuqi të mjaftueshme financiare dhe po e përdorin atë për të shpërndarë aktivitetet e tyre në sektorë të tjerë ekonomike, për të ushtruar një influencë të paligjshme në strukturat qeverisëse dhe për të blerë legjitimitet dhe mundësinë për tu futur në sferat politike dhe ekonomike. Mjetet për të arritur këtë gjë varrojnë, duke filluar nga korrupsioni në ngritjen e organeve mediatike për manipulimin e opinionit publik. Fuqia financiare lidhet në mënyrë të ngushtë me tendencën për konsolidimin e pushtetit në tregun e drogës duke ndërmarrë operacione komplekse jo vetëm në trafikimin por dhe në prodhimin dhe shpërndarjen e drogës. Të gjitha këto tendenca tregojnë se krimi i organizuar në lidhje me drogën është "pjekur" – duke e bërë ndikimin e tij të ndihet jo vetëm nëpër tregjet e huaja por edhe në rajon. Kjo i vendos qeveritë e rajonit përball një sfide më të madhe, duke kërkuar që ato të përdorin masa shtypëse më të sofistikuara në nivel rajonal, si dhe gjithashtu të ndërtojnë programe me të plota parandaluese brenda kufijve kombëtare.

4.1.2 Krimi Ekonomik

Specifikat rajonale të një të shkuare të përbashkët, gjuha dhe lidhjet e ngushta, zhvendosja e njerëzve e pa ngjarë më parë si brenda ashtu dhe jashtë rajonit e përshtatshme për fallsifikim identiteti, kapaciteti i ulët institucional i institucioneve shtetërore, kërkesa për disa mallra të caktuara për shkak të luftës apo faktorëve të tjerë si dhe kufijtë e rinj kombëtar ofrojnë mundësi të shumta dhe hapësira të mëdha përfitimi për kriminelë të cilët organizohen për të zhfrytëzuar këto situata. Evazioni në sistemin doganor dhe të taksave, mashtrimet në prokurimet publike dhe në privatizim shkaktojnë humbje të mëdha në të ardhurat publike duke u përlogaritur në miliarda euro, si dhe ndikojnë në shkatërrimin e besimit publik në institucionet qeverisëse dhe të zbatimit të ligjit. Megjithëse impakti ndihet në mënyrë të konsiderueshme nga qytetarët e vendeve të Ballkanit, pasojat afat - gjata mund të sjellin ndërlikime në stabilitetin e përgjithshëm rajonal, zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve, si dhe mund të prekin interesat e BE-së në rajon. Për aq kohë sa pjesa me e madhe e njerëzve të kenë një të ardhme ekonomike të varfër dhe një mungesë mundësish për tu angazhuar brenda shoqërisë në një mënyrë të dobishme dhe konstruktive, sidomos meshkujt e rinj të zonave urbane, ata do të mbeten një shënjestër e lehtë për t'u rekrutuar për aktivitete të jashtëligjshme.

Krimi ekonomik nuk është unik për këto vende në tranzicion dhe shtetet e reja anëtare janë përballur në mënyrë të suksesshme me disa nga këto probleme gjatë procesit të tyre të antarësimit. Mësimet e dala duhet të konsiderohen në gjetjen e zgjidhjeve tërësore rajonale për këtë problem.

Megjithë shqetësimet e vendeve të rajonit, qëllimi i problemit të krimit ekonomik nuk njihet plotësisht. Mënyrat e veprimit të krimit ekonomik njihen më mirë se sa impakti që shkakton ky krim në këto vende. Hapi i parë i nevojshëm që duhet të ndërmarrin vendet e rajonit është përmirësimi i

kapaciteteve te tyre për vlerësimin e impaktit ekonomik. Një vlerësim i tillë do të kërkojë një bashkëpunim ndër-institucional që përfshin jo vetëm organet e zbatimit të ligjit, por gjithashtu dhe administratat e doganave dhe taksave, ministritë e financave, institucionet e kontrollit, njesitë e hetimit financiar, zyrat e regjistrimit si dhe agjensi të tjera që mund të zotërojnë informacion në lidhje me financat dhe aktivitetet ekonomike.

4.1.3 Trafikimi i qenieve njerëzore

Masat e fundit shtypëse që ndërmorrën vendet e rajonit patën një impakt pozitiv në zvogëlimin e numrit të personave të trafikuar në rajon. Këto masa gjithashtu mund të kënë kontribuar në një zhvendosje në treg e cila shfaqet në një mënyrë veprimi me delikate të grupeve kriminale, e orientuar në një afat më të gjatë, bazuar më shumë në rekrutimin vendas se duke u varur nga viktimat e huaja të trafikimit.

Praktikimi i trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë i vazhdueshëm për një kohë të gjatë. Konsolidimi i aktiviteteve kriminale, duke ndërtuar lidhje me të ngushta me strukturat qeverisëse dhe të zbatimit të ligjit nëpërmjet praktikave korruptuese, si dhe tregu i brendshëm në rritje përbën një sfidë më tepër për politikbërësit. Një zhvendosje e tillë në treg kërkon një përqasje me tërësore ndaj trafikimit, me masa më të mprehta shtypëse dhe parandaluese në mënyrë që të frenohet rekrutimi vendas, të zvogëlohen tregjet e brendshme të seksit, dhe të përballohen problemet e mundshme që sjellin këto tregje për shëndetin publik.

4.1.4 Korrupsioni

Korrupsioni depërton në të gjithë tregjet e lart përmendur si një praktikë mbrojtëse për aktivitetet e krimit të organizuar, si dhe shërben si mjeti kryesor për të përshkuar qeverisjen ligjore dhe strukturat ekonomike. Këtu përfshihen rryshfetet si dhe aktivitetet e tjera korruptive të cilat janë të drejtuara si ndaj nepunësve civile të nivelit të ulët për përmbushjen e nevojave operative (policët, zyrtarët e strukturave doganore dhe taksave, oficerët e sigurisë, nepunësit e zyrave të regjistrimit, etj), ashtu dhe ndaj atyre të nivelit të lartë për përmbushjen e objektivave afat - gjata (prokurorët dhe gjykatësit, politikanët, anëtarët e parlamentit, shërbimi informativ, etj).

Në këtë mënyrë, korrupsioni shkatërron përpjekjet kundër krimit të organizuar dhe ndikon në zvogëlimin e besimit publik në institucionet shtetërore. Vendet e rajonit janë në dijeni të këtij problemi dhe kanë ndërmarrë një sërë masash, ligjore apo të tjera, për tu përballur me të. Sidoqoftë, duhet të kryhet me shumë punë, në veçanti në lidhje me një hetim të adresuar më mirë dhe me ndjekjen penale të korrupsionit që është i lidhur drejtpërdrejt me krimin e organizuar.

4.2 PROFILET E VENDEVE⁹⁶

4.2.1 Shqipëria

Origjina e krimit të organizuar në Shqipëri lidhet me disa faktorë: kriza e skemave piramidale e vitit 1997 gjatë së cilës burime kolosale financiare kaluan në duart e një pakice duke shkaktuar një protestë publike dhe një ndryshim të qeverisë; dhe migracioni në përmasa të mëdha i shqiptarëve, në veçanti drejt vendeve fqinje të Greqisë dhe Italisë, duke krijuar lidhje të ngushta midis diasporave të së sapo krijuara dhe vendit amëtar, gjë që ka shërbyer si një makineri për transferimin e praktikave të reja të ligjshme e të jashtë ligjshme. Migrimi në masë i viteve 1990 krijoi rrethana nxitëse për transportin klandestin të migrantëve, ndërkohë që lufta e vitit 1999 në Kosovë krijoi rrethana nxitëse për trafikimin e armeve. Koha gjatë së cilës ndodhen dhe moria e këtyre sfidave ushtroi presion mbi institucionet shqiptare në demokratizim dhe mbi kuadrin e dobët ligjor.

“Transformimi i shoqërisë, shndërrimi i administratës së vjetër, krijimi i strukturave dhe ngritja e mekanizmave të rinj në ekonomi, krijoi në Shqipëri një mori mangësish e boshllëqesh të cilat janë përdorur më së miri nga grupet e krimit të organizuar me qëllim përfitimin maksimal. Papunësia dhe kriza ekonomike influencuan në zgjerimin e shpejtë të aktiviteteve të jashtëligjshme në dy rrugë: së pari duke siguruar “bazën njerëzore” për këto tregje dhe së dyti duke ndihmuar në zhvillimin e strukturave kriminale homologe shqiptare.”⁹⁷

Qeveria ka bërë përpjekeje të dukshme në lidhje me reformat ligjore dhe institucionale në vitet e fundit, në veçanti për zvogëlimin e migrimit të jashtë ligjshëm. Gjithsesi, sipas autoriteteve shqiptare, krimi i organizuar është forcuar duke shfrytëzuar mundësitë e reja, duke u shpërndarë nëpër tregje të reja si ai i cigareve, trafikut të armëve, drogës dhe duke forcuar lidhjet e tij me jashtë vendit.

Kërcënimet më të mëdha që i kanosen Shqipërisë janë krimi i organizuar në lidhje me drogën, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin ekonomik dhe korrupsionin. Biznesi i drogës është zhvilluar deri në atë pikë sa të përfshijë prodhimin, trafikimin dhe shpërndarjen. Shqipëria është i vetmi vend në rajon i cili prodhon cannabis për eksport. Vite të tera aktiviteti kriminal të lidhur me drogën i kanë bërë grupet e krimit të organizuar Shqiptar, mjaft të njohura nga agjensitë e zbatimit të ligjit nëpër vendet e BE-së. Organizimi i efektshëm i tyre mbështetet në ekskluzivitetin e tyre etnik dhe në lidhjet e ngushta me Greqinë, Italinë dhe vendet e tjera të BE-së me një komunitet shqiptar të konsiderueshëm.

Në lidhje me trafikimin e drogës, Shqipëria shikohet si një vend tranzit më shumë se sa si një treg konsumi. Kjo gjithsesi mund të ndryshojë në bazë të të dhënave të dala nga qendrat e trajtimit të personave në varësi të drogës. Për shembull, në vitin 2000 kërkuan trajtim në këto qendra rreth 968 persona, ndërkohë që në vitin 2003 ky numër u rrit në 1360. Konsumi i drogës gjithashtu lidhet ngushtë me incidente të infektimit me HIV dhe AIDS.

Sipas autoriteteve shqiptare, vlera e drogës së prodhuar ose të trafikuar nëpërmjet Shqipërisë përafron me rreth 50 milion euro në vit.⁹⁸ Për sa i përket konfiskimit të drogës në vitin 2004, Shqipëria raportoi midis të tjerash kapjen e 155.9 kg heroinë, 2.4 kg kokainë, 4544.15 kg marijuanë dhe 73 757 bimë cannabis. Heroina trafikohet nëpërmjet tokës, ndërsa kokaina kryesisht nëpërmjet rrugeve ajrore dhe detare. Droga zakonisht fshihet në valixhe ose transportohet në pako të ardhura nga Kolumbia, Peruja, Panamaja, Meksika dhe vende të tjera të Amerikës Latine. Numri i çështjeve të lidhura me konfiskimin e drogës në vitin 2004 është 363, me rreth 395 autorë të përfshirë. Organet

⁹⁶ Përvec rasteve kur është shprehur ndryshe, i gjithë informacioni i paraqitur në lidhje me gjendjen e vendeve të rajonit është bazuar në pergjigjet e pyetesorit.

⁹⁷ Pergjigjia Shqiptare ndaj pyetesorit.

⁹⁸ Vlera është llogaritur duke u bazuar në konfiskimet brenda dhe jashtë Shqipërisë (për drogen e trafikuar nëpërmjet Shqipërisë). Përfitimi është 20% për 1 kg heroinë, që do të thote se kur në Turqi cmimi varion nga 8 000 në 10 000 euro, në Shqipëri cmimi i shitjes varion midis 10 000 – 12 000 euro. Ibid.

shqiptare të zbatimit të ligjit janë duke mbikqyru rreth 20 grupe të krimit të organizuar të përfshira në trafikimin e drogës, të përbëra prej rreth 3 deri në 20 anëtarësh.

Një grup kriminal zakonisht ka një strukturë hierarkike, në të cilën përfitimet ndahen sipas pozicionit dhe rolit në organizatë.⁹⁹ Bashkëpunimi brenda kësaj strukture kriminale është relativisht i qëndrueshëm, ku ata që arrestohen zëvendësohen lehtësisht nga të tjerë. Kriminelët e përfshirë në trafikimin e drogës zakonisht kanë patur një të kaluar kriminale, mund të kenë ushtruar dhunë (shpesh deri krimin e vrasjeve) dhe mund të kenë qënë të përfshirë më parë me trafikimin e grave dhe emigrantëve.

Për sa i përket mënyrës së veprimit, zakonisht për të lehtësuar transportin e drogës përdoret korrupsioni i policëve, oficerëve të doganave dhe oficerëve të shërbimit sekret. Disa nga grupet kriminale të trafikimit të drogës synojnë zgjerimin e aktiviteteve të tyre dhe në mënyrë të vazhdueshme tentojnë të kontrollojnë ciklin e plote të biznesit të drogës (prodhimin, mbledhjen, shpërndarjen, financimin, transportin dhe shitjen).

Grupet kriminale që merren me trafikimin e drogës kanë lidhje familjare, rajonale apo sociale dhe demonstrojnë një disiplinë të fortë dhe një vigjilencë të lartë në mbajtjen e fshehtësisë. Megjithëse këto grupe kryesisht përfshijnë shqiptare, ato gjithashtu mbajnë kontakte me kriminelët të huaj nga Turqia, Italia, "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Mali i zi, etj.¹⁰⁰

Është vënë re se grupet kriminale shqiptare kanë pozicione kyce në trafikimin e drogës në rajon, duke mbajtur majat e hierarkisë dhe duke administruar furnizimin dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të drogës, ndërkohë që detyrat e tjera bazë u lihen grupeve të organizuara kriminale me etnicitet të ndryshëm nga vende të tjera të rajonit. Kapaciteti i tyre, financiar dhe teknik, shpesh e tejkalon kapacitetin e organeve shqiptare të zbatimit të ligjit, ndërkohë që konsolidimi i tyre ngrin një sfidë të veçantë për veprimtarinë e organeve të zbatimit të ligjit, përkatësisht për sa i përket hetimeve më tërësore që kanë nevojë për mjete të posacme hetimi dhe një bashkëpunim ndërkombëtar më të ngushtë, konfiskimit dhe menaxhimit të pronave të konfiskuara, mbrojtjes së dëshmitarëve, dhe zhvillimit të një procesi gjyqësor më të efektshëm.

Në luftimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe të transportit klandestin të emigrantëve është arritur një sukses i dukshëm, veçanërisht duke mbyllur rrugët detare drejt Italisë dhe duke ndjekur penalisht një numër personash të implikuar në këto aktivitete. Sipas autoriteteve shqiptare në vitin 2003 u ndoqën penalisht 23 grupe kriminale, dhe në 9 muajt e parë të vitit 2004 u goditën 13 grupe kriminale të implikuara në trafikimin dhe transportimin klandestin të qënieve njerëzore. Gjithsesi mbetet një sfidë në veçanti trafikimi i brendshëm dhe rekrutimi i viktimave për shfrytëzim seksual, adoptim të jashtëligjshëm, lypje dhe transplant organesh.¹⁰¹

Në bazë të raportimeve,¹⁰² midis vitit 1998 dhe vitit 2002, nëpërmjet Shqipërisë emigruan në mënyrë të jashtëligjshme për në Itali 95 737 persona të cilët paguanin nga 500 deri në 1000 euro për person për transportin. Kjo do të sillte një përfitim total prej rreth 57.4 deri me 95.7 milionë euro për një periudhë pesë vjecare. Sipas autoriteteve shqiptare, që prej vitit 2002 numri i madh i emigrantëve të jashtëligjshëm është zvogëluar deri në disa qindra.

Grupet kriminale që janë të përfshira në trafikimin e qënieve njerëzore janë zakonisht të lidhura me grupe të tjera që veprojnë në fushën e transportit klandestin të personave, trafikimit të drogës, vjedhjes dhe më pas trafikimit të makinave të vjedhura, etj. Struktura e këtyre grupeve kriminale është relativisht horizontale dhe është e organizuar në celula më të vogla të përbëra nga rreth 3 deri në 5 persona. Pamvarësisht përpjekjeve të autoriteteve shqiptare (regjim me strikt vizash dhe

⁹⁹ Pozicionet e identifikuara janë: anëtarët që zbulojnë tregjet e shitjes, keshillues financiar, organizuesit e transportit, shpërndarësit, rekrutuesit, postieret, dhe shitësit e vegjel të drogës. Ibid.

¹⁰⁰ Ibid.

¹⁰¹ Një "shitje" e një viktime të trafikuar shkon deri në 2000 – 2500 Euro, ndërkohë që femijet "shiten" për 500 – 1000 Euro. Duke patur parasysh përfitimet e mëdha rekrutuesit shpesh mbajnë pozicionet me të larta në grupet kriminale. Ibid.

¹⁰² Përgjigjia Shqiptare ndaj pyetësorit duke iu referuar të dhenave të policisë Italiane.

menaxhim më i mirë i kufirit), kërkesa për transportim të emigrantëve të jashtëligjshëm mbetet e lartë.

Kapaciteti financiar midis të tjerash, i arritur nga krimi i organizuar në dekadën e fundit shërben aktualisht për të konsoliduar dhe për të zgjeruar aktivitetin në sektorin ligjshëm, si nëpërmjet dëpërtimit në strukturat shtetërore ashtu dhe nëpërmjet shpërndarjes së aktiviteteve në sektorin e biznesit privat. Krimi ekonomik si për shembull ai që ka të bëjë me mashtrimin për sa i përket TVSH-se, evazionin në forma të ndryshme në sistemin doganor dhe atë të taksave si dhe fallsifikimin e produkteve ligjore mbështet shumë në dobësinë e institucioneve doganore dhe të taksave që janë përgjegjëse për kontrollin e të ardhurave publike. Pamvarësisht faktit se krimi ekonomik vërehet si një kërcënim serioz ndaj shoqërisë shqiptare, nuk ka përlllogaritje për sa i përket dëmit që ky krim i shkakton buxhetit. Në vitin 2003 u ndoqën 91 raste të mashtrimit doganor me 98 aktorë të përfshirë, ndërkohë që në vitin 2004 ky numër u rrit në 163 raste në të cilat ishin përfshirë 224 vetë. Parandalimi dhe hetimi i frytshëm i krimit ekonomik pengohet nga kuadri institucional i copezuar i administratës tatimore dhe agjensive të tjera të zbatimit të ligjit, të cilat kanë zyra nëpër qytete dhe rajone që janë të shkëputur nga njëri-tjetri. Kjo gjë vështirëson procedurat hetimore dhe shkëmbimin e informacionit.

Praktika e pastrimit të parave në Shqipëri ka përfshirë në mënyrë të konsiderueshme investime në prona të paluajtshme, toka dhe turizëm. Janë ndërtuar shumë ndërtesa në mënyrë të jashtë ligjshme, nga të cilat shumë prej tyre janë shkatërruar. Sidoqoftë, është paksa e vështirë të vecosh se Çfarë pjesë e ndërtimeve të jashtë ligjshme vjen si rrjedhojë e pastrimit të parave (drogës, evazionit tatimor, apo të ardhurat që vijnë nga punonjësit sezonale jashtë vendit) dhe se Çfarë pjesë vjen si efekt i keq administrimit të sektorit të ndërtimit. Sektorë të tjerë ku investohen të ardhurat e krimit janë telekomunikacionet, industria e ushqimit, skemat e llotarive, organet e medias, klubet sportive dhe sipërmarrjet publike që promovojnë partitë politike.

Megjithëse janë bërë disa përpjekje, vihet re se korrupsioni vazhdon të ndikojë administratën shtetërore dhe sistemin gjyqësor. Në mënyrë që të arrihet një përmirësim i situatës duhet që të ky problem të shqyrtohet duke kombinuar masa parandaluese dhe shtypëse kundër korrupsionit, i cili është një simptomë e njohur për të gjitha aktivitetet kriminale. Në vitin 2004, 443 të dyshuar u ndoqën penalisht nën akuzën e korrupsionit.

Në një plan afatgjatë, një përmirësim i kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit, duke përfshirë dhe mundësinë për të prodhuar të dhëna të sakta rreth krimit të organizuar dhe ekonomik, duket të jetë i domosdoshëm për shërbimin informativ shqiptar. Një komponent tjetër mjaft i rëndësishëm për sa i përket ngritjes së kapaciteteve është dhe përqëndrimi në shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave, duke përmirësuar kuadrin ligjor. Por gjithashtu në nivel individual, është mjaft i rëndësishm trainimi intensiv dhe lehtësimi i transmetimit të praktikave të mira.

4.2.2 Bosnja dhe Hercegovina

Situata e mbas luftës në Bosnie dhe Hercegovinë shënoi rreth një milion qytetarë të shpërngulur, një shkatërim kolosal të pronës dhe një shtet të copëzuar me fuqi dhe autoritet të dobët. Boshllëku politik dhe ligjor i shkaktuar nga lufta është mbushur me kujdes nëpërmjet përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar dhe atij vendas që nga viti 1996. Në fund të viteve 1990, mungesa e institucioneve të tilla si shërbimi kufitar,¹⁰³ gjyqsori i dobët, hapësira ligjore dhe ekonomike e copëzuar dhe lidhjet rajonale të ndërhuara si rrjedhojë e ekonomisë së luftës, siguruan mundësi të veçanta për krimin e organizuar. Situata e mbas luftës dhe faktorë të tjerë të shkaktuar nga tranzicioni, si për shembull ndryshimet mbi të drejtën e pronës, rënia ekonomike, dhe mbështetja në tregti ofroi një sërë mundësish të tjera. Në këtë mënyrë, krimet e rënda arritën të kalonin në një avantazh, të cilin autoritetet e Bosnje Hercegovines po mundohen që ta arrijnë përmes reformave të shumta ligjore dhe institucionale të kryera në këto vitet e fundit.

Pamvarësisht faktit se analiza strategjike nuk praktikohet në Bosnjë Hercegovinë, përgjigjia e këtij vendi ndaj pyetësorit tregon se kërcënimet kryesore për Bosnjën dhe Hercegovinën janë krimi ekonomik, droga dhe trafikimi i qënieve njerëzore.

Krimi ekonomik po lulëzon për shkak të hapësirës së copëzuar ekonomike, ndarjes juridikionale midis organeve të zbatimit të ligjit në Bosnjë Hercegovinë,¹⁰⁴ përhapjes së gjerë të fallsifikimit të identitetit, gjë që mundësohet nga numri i madh i personave të shpërngulur dhe të vrarë gjatë luftës, si dhe ndarjes së brendshme të vendit. Mekanizmi kryesor për përhapjen e evazionit në të ardhurat publike ka qenë regjistrimi në mënyrë relativisht të lehtë i kompanive të rreme. Sipas autoriteteve tatimore të Federatës së Bosnje Hercegovinës në vitin 2004 ka patur rreth 1187 ente ligjore të regjistruara por që kualifikoheshin si të padisponueshme, të rreme apo paralele. Gjithashtu që nga viti 2002 janë regjistruar 835 raste të evazionit fiskal të cilat kanë shkaktuar një humbje në të ardhura prej 320.2 milion KM (rreth 160 milion Euro), dhe për të cilat akoma nuk është dhënë një dënim. Autoritet tatimore të Republikës Srpska në të njëjtën kohë kanë regjistruar 464 kompani të padisponueshme, 73 kompani të rreme dhe 21 kompani "paralele".¹⁰⁵

Duke ofruar mundësi të tilla të veçanta, Bosnje Hercegovina është kthyer në një zonë joshëse nëpërmjet së cilës kryhet tregtia e jashtëligjshme në rajon. Përpjekjet e fundit të autoriteteve të Bosnje Hercegovines në fushën e tatimeve dhe regjistrimit të biznesit me qëllim forcimin e ndërldhjeve të brendshme dhe unifikimin e sitemit të taksave dhe regjistrimit të biznesit, kanë filluar që të sjellin disa rezultate pozitive.

Metodat e pastrimit të parave në Bosnje dhe Hercegovinë janë të ngjashme me ato që përdoren për evazionin fiskal. Në Republikën Srpska, numri i padive penale kundër personave të implikuar me evazion fiskal dhe pastrim parash u dyfishua nga viti 2002 deri në 2004 (nga 22 në 44 raste). Në vitin 2005, policisë së shtetit, zyrës së prokurorisë dhe gjykatave iu dha juridiksion mbi pastrimin e parasë. Deri në Maj të vitit 2005, gjykata e Bosnje Hercegovinës lëshoi 8 dënime dhe gjopa që shkonin deri në 1.38 milion KM (690 000 Euro) dhe 45 000 dollarë Amerikan. Sasia e parave të pastruara ishte 110.82 milion KM (55.41 milion Euro), ndërkohë që vlera e evazionit në sistemin e taksave ishte 16.26 milion KM (8.13 milion Euro). Evazioni fiskal ishte ishte shkëlja e presupozuar në të teta çështjet. Hetimet që filluan mbas tetë dënimeve të para hodhën dyshime mbi 643 ente ligjore që merreshin me pastrimin e parase.

¹⁰³ Shërbimi kufitar u vendos në vitin 2000. Shiko vendimin e Perfaqesuesit të Lartë në vitin 2000, www.ohr.int/decisions/statemattersdec/archive.asp?m=&yr=2000.

¹⁰⁴ Bosnja Hercegovina ka kater juridiksione në sistemin e se drejtes penale: nivelin shteteror, dy nivele entesh (Republika Srpska dhe Federata e Bosnje Hercegovines) dhe Rrethi i Brckos.

¹⁰⁵ Kompani "te padisponueshme" jane ato te cilat regjistrohen ne adresa qe nuk egzistojne ose qe kane perdorur dokumenta te fallsifikuara regjistrimi; kompani "te rreme" jane ato te cilat perdorin dokumenta te fallsifikuara identifikimi; nderkohe qe kompani "paralele" jane ato qe perdorin kopje te dokumenta te regjistrimit me emra te ndryshuar pronaresh. Kopje te tilla me pas perdoren per te hapur llogari bankare te reja dhe te pagjurmueshme.

Për sa i përket trafikut të drogës, bazuar në përgjigjet e dhëna ndaj pyetësorit, mund të vihet re dukshëm se Bosnje Hercegovina shërben si një 'qendër rishpërndarjeje' për drogën. Faktorë të tillë si kufinj të relativisht të depërtueshëm, kuadri ligjor¹⁰⁶ dhe institucional në zhvillim, mungesa e paisjeve teknike dhe copezimi i brendshëm i sistemit të së drejtës penale shfrytëzohen nga kriminelët dhe e bëjnë Bosnje Hercegovinën një zonë tërheqëse tranzitit, të përshtatshme për ripaketimin dhe rishpërndarjen e drogës.¹⁰⁷

Grupet e trafikimit të drogës nuk i përkasin ndonjë dominancë të caktuar etnike por kanë lidhje të forta me vendet fqinje në të cilat besnikëria bazohet në rrethana dhe vendndodhje gjeografike të përbashkët. Një konfiskim i kohëve të fundit i 34 tonëve të anhidritit acetik (një lëndë e nevojshme për prodhimin e heroinës),¹⁰⁸ e cila rezultoi edhe në dënimin e personave shkelës, tregon për ekzistencën tregtisë së lëndëve të nevojshme për prodhimin e drogës. Gjithashtu ka fakte për ekzistencën e transportit të kanabisit nga Shqipëria nëpërmjet Malit të Zi për në Bosnje Hercegovinë. Përveç trafikimit të drogës, vihet re një rritje e tregut të brendshëm të konsumit, sidomos për drogat sintetike të tilla si 'ekstasia', amfitaminat si dhe kanabis.¹⁰⁹ Pamvarësisht shqetësimit të shprehur nga oficerët e zbatimit të ligjit dhe nga informacionet e servitura nga media vendase, nuk ekziston ndonjë studim ose anketim për sa i përket faktit se sa i madh mund të jetë ky treg dhe se kush janë përdoruesit e drogës. Për shqyrtimin e duhur të këtij problemi, Bosnja Hercegovina duhet të ndër marrë një studim të këtij lloji.

Për sa i përket trafikimit të qënieve njerëzore, situata ndryshoi në mënyrë të dukshme si rrjedhojë e përpjekjeve nga ana e organeve të zbatimit të ligjit dhe e mbylljes në vend të shtëpive dhe klubeve të shumta publike. Si rrjedhojë shfrytëzimi seksual është bërë me klandestin dhe më i sofistikuar, duke u ushtruar më shumë në apartamente private, nëpërmjet shërbimeve eskorte dhe duke u zgjeruar në Internet. Gjithashtu, viktimat duket sikur trajtohen në mënyrë më pak të dhunshme dhe kane kushte jetese më të mira. Këto viktima kryesisht janë në shërbim të tregut të brendshëm. Një zhvendosje e tillë në treg tregon një sofistikim të menaxhimit nga ana e kriminelëve të përfshirë në biznesin e trafikimit të qënieve njerëzore. E gjithë kjo ngre një sfidë të re për hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve.

Personat e përfshirë në trafikim të qënieve njerëzore janë kryesisht qytetarë të Bosnje Hercegovinës, zakonisht pronarë klubesh nate ose persona që kanë lidhje me pronarë baresh. Grupet e përfshira në këtë biznes kapërcejnë me lehtësi çdo kufi etnik, kombëtar, apo kantonesh dhe kryesisht bashkëpunojnë me trafikantë nga Serbia, vend që ndodhet në rrugën kryesore të trafikimit të qënieve njerëzore nga Romania, Moldova dhe Ukraina. Rastet e regjistruara tregojnë se kriminelët të Bosnje Hercegovinës kanë patur bastionet e veta kriminale në Rumani dhe në Moldavi.¹¹⁰ Rekrutimi vendas, trafikimi i brendshëm dhe klientela që dominon në vend kërkon një politikë që ka nevojë jo vetëm për masa shtypëse por gjithashtu dhe për masa më të mira parandaluese. Gjithashtu është e nevojshme dhe një politikë më e mire për shëndetin publik në mënyrë që të përballen problemet shëndetsore që prodhon tregu i brendshëm i seksit.

Për sa i përket transportit klandestin të njerëzve, Bosnja Hercegovina konsiderohet si një vend tranzit nga ku qytetarë të Shqipërisë, Kinës, Turqisë, Indisë dhe Pakistanit transportohen në mënyrë të jashtëligjshme për në vendet e Europës Perëndimore. Ata hynjë në territorin e Bosnje Hercegovinës nëpërmjet Serbisë dhe Malit të Zi përmes kalimit të ligjshëm ose jo të kufirit në pjesën lindore të Bosnje Hercegovinës dhe pasi arrijnë në Sarajevë vazhdojnë për në pjesën perëndimore të vendit zakonisht duke përdorur taksit. Që andej, grupe kriminale vendase i shoqërojnë përmes lumenjve

¹⁰⁶ Sipas autoriteteve, Bosnje Hercegovina ka akoma mangesi në legjislacionin kryesor në fushën e terrorizmit, transportin klandestin të njerëzve, abuzimit me drogen dhe tregtisë së lëndëve kimike të nevojshme për përgatitjen e drogës.

¹⁰⁷ Përgjigjia e Bosnje Hercegovinës ndaj pyetësorit.

¹⁰⁸ Ibid.

¹⁰⁹ Ibid.

¹¹⁰ Ibid.

apo kufinjve të tjerë për në Kroaci. Në të shkuarën, ka patur raste të futjes së grupeve të mëdha emigrantësh të jashtëligjshëm në territorin e Bosnje Hercegovinës si turistë apo si anëtarë të shoqatave kulturore. Kohët e fundit, komuniteti kinez i ngritur duket të ketë lidhje me lehtësimin e migrimin nga Kina për në Europën Perëndimore. Tregu për transportimin klandestin të njerëzve është relativisht i fshehtë dhe mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë midis grupeve të krimit të organizuar të vendeve të ndryshme të rajonit.

Një karakteristik për Bosnje Hercegovinën është lidhja që ekziston midis krimit të organizuar dhe të akuzuarve si kriminelë luftime, gjë që shkakton një shqetësim të madh për disa autoritete të Bosnje Hercegovinës. Financimi i të akuzuarve si kriminelë luftime në arrati, në veçanti i Ratko Mladic dhe Radovan Karadzic, duket të jete i mirë organizuar dhe i lidhur me një numër institucionesh si banka, institucione të ndryshme publike dhe qeverisëse, si dhe parti politike në Republikën Srpska. Në vitin 2004, u bllokuan llogaritë bankare të atyre personave që dyshoheshin se po mbështesnin të akuzuarit për krime luftime. Ne vazhdim një duzinë personash që mbanin poste publike u shkarkuan nga Përfaqësuesi i Lartë, Lord Ashdown.¹¹¹ Akoma nuk është bërë i njohur rezultati përfundimtar i këtyre hetimeve.

Janë bërë përpjekje të dukshme për konsolidimin dhe harmonizimin e sistemit të dobët të së drejtës penale në Bosnje Hercegovinë (përkatësisht për shërbimet e prokurorisë dhe gjyqësorit), të cilat kanë prodhuar rezultate pozitive kundër krimit të organizuar, kjo e vënë re dhe për sa i përket dënimeve të dhëna. Gjithsesi, organet e zbatimit të ligjit vazhdojnë të jenë të copëzuara, të shkëputura nga njera-tjetra dhe të tejshtirira. Në mënyrë të ngjashme si në Shqipëri, shkëmbimi i informacionit brenda vendit është i dobët. Gjithsesi, format e reja të krimit të organizuar kërkojnë një shërbim informativ policor të mirë dhe një shkëmbim informacioni të efektshëm si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Në rastin e Bosnje Hercegovinës, reforma në sistemin e policisë, – një strukturë e bashkuar policore që do mund të ndihmonte në përballimin e shumë problemeve të përmendura këtu, – vazhdon të mbetet në listën e prioriteteve që duhen përmbushur.

¹¹¹Ne vitin 2004 Lordi Asdown nxorri 82 vendime që kishin të bënin me shkarkimin nga postet publike të atyre personave që dyshoheshin për mbështetje të të akuzuarve për krime luftime, financiarisht apo në menyrë të tjera. Gjithashtu u urdherua bllokimi i llogarive të tyre bankare që mendoheshin se perdoreshin për këto qëllime. Qëllimi i mirë publikuar i këtyre veprimeve ishte të prishte rrjetin e mbështetjes dhe të shkeputte fondet krimineleve të luftes në menyrë që ata të arrestoheshin dhe të vendoseshin përpara drejtësisë në Gjykatën e Krimeve Nderkombetare për Ish Jugosllavinë në Hage. Keto vendime janë të disponueshme në internet tek: <http://www.ohr.int/decisions/war-crimes-decs/archive.asp?m=&yr=2004>

4.2.3 Kroacia

Ashtu si vendet e tjera të ish Jugosllavisë, Kroacia është prekur thellë nga lufta e cila shkaktoi ndryshime në rrethant ekonomike, sociale dhe politike të cilave iu bashkëngjiten edhe sfidat që solli tranzicioni në periudhën e pas luftës. Organizatat kriminale në Kroaci mbajtën lidhje shumë të ngushta me analogët e tyre në shtetet e tjera të ish Jugosllavisë, ndërkohë që bashkëpunimi midis organeve të zbatimit të ligjit në shtetet e sapo formuara u dëmtua gjatë konfliktit dhe në periudhën e menjëhershme të mbas luftës. Krijimi i një avantazhi të tillë lejoi grupet e krimit të organizuar që të identifikonin tregjet e krimit ku mund të siguronin përfitime dhe pushtet, por dhe që të arrinin një përshtatje shumë të mirë në ndryshimet e mbas luftës.

Sidoqoftë, Kroacia lëvizi me hapa më të shpejtë se vendet e tjera të rajonit për sa i përket ngritjes së një sistemi të zbatimit të ligjit funksional, me një sistem të centralizuar të dhënash kriminale. Në Kroaci u arriten rezultate jo vetëm në proceset hetimore por gjithashtu dhe në ndjekjen penale dhe dënimin e rasteve të krimit të organizuar. Në mënyrë të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, Kroacia përballet me kërcënime të krimit të organizuar që kanë të bëjnë me trafikimin e drogës, krimin ekonomik dhe korrupsionin.

Për sa i përket trafikimit të drogës, Kroacia duket të jetë kryesisht një vend tranzit në rrugën Ballkanike. Droga (heroina dhe kanabis) trafikohen kryesisht nëpërmjet rrugëve tokësore nga Bosnje Hercegovina dhe Serbia dhe Mali i Zi. Prodhimi i drogës nuk lidhet me krimin e organizuar. Me saktë, prodhimi i drogës, që kryesisht bëhet për konsum të brendshëm, lidhet me prodhues të vegjël e individuale. Droga sintetike vjen nga Perëndimi dhe shërbehet në tregun e brendshëm nëpër zonat urbane apo në qytetet bregdetare gjatë muajve të verës. Kroacia është i vetmi vend në rajon e cila ka ndërmarrë disa masa për kuptimin dhe përlogaritetjen e tregut të brendshëm të drogës dhe për ndalimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit me drogën.

Ka disa lloj organizatash kriminale të trafikimit të drogës të bazuara në kombësi, përkatësi territoriale dhe lidhje familjare. Grupet shqiptare të krimit të organizuar i përkasin llojit të parë dhe në to përfshihen shqiptarë nga Kosova dhe "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", të cilët merren kryesisht me organizimin e transportit të heroinës. Struktura e tyre është mjaft hierarkike dhe bazohet në lidhje të ngushta familjare apo prejardhje të ngjashme, dhe gjithashtu ka lidhje të ngushta në vende të tjera. Ndryshe nga shqiptarët, njerëz që i përkasin etnive të tjera nuk kanë pozicione kyçe, por shërbejnë si transportues. Organizatorët kryesorë kanë marrë një nivel të lartë edukimi, gezojnë një standart të mirë jetese dhe shpesh zotërojnë kompani apo prona në të cilat investojnë të ardhurat e tyre të krimit.

Lloji i dytë i organizatave kriminale lidhet me grupet e krimit që merren me kanabis. Ky grup përbëhet kryesisht nga persona që mbajnë shtetësi të dyfishtë të Bosnje Hercegovinës dhe Kroacisë. Këto grupe kanë një strukturë më pak të përcaktuar dhe në to organizatori kryesor njihet nga anëtarët e tjerë të grupit. Në përbërje të këtyre grupeve ka ekzekutues që refuzojnë të përdorin shërbimet e personave të tretë, përveç oficerëve doganore të vendosur në pikat e kalimit të kufirit. Grupe të tilla kanë lidhje të mira me grupe të tjera të vendosura në pikat ku kryhet transporti klandestin. Mund të vihet re gjithashtu se anëtarët e këtyre grupeve kanë prirje për të kryer dhe krime të tjera.

Lloji i fundit është ai i organizatave kriminale të vendosura në vende të tjera dhe të drejtuara nga individë me eksperiencë në vende tradicionale të prodhimit të drogës si Holanda dhe vendet e Amerikës Latine, ku organizohet trafikimi i drogave sintetike dhe kokainës nëpërmjet rrugëve ajërore dhe detare. Ata mbështeten në persona transportues të cilët mund të jenë trafikantë profesionistë droge ose persona të rastësishëm që punësohen vetëm për një rrugë. Trafikantët përdorin shërbimin postar të shpejtë ose agjensite turistike të udhëtimit dhe fshehin destinacionin përfundimtar duke zgjedhur fluturime me disa ndërprerje.

Grupet kriminale të zhvilluara në vend kanë struktura të përziera dhe shpesh drejtohen nga një person me precedente penale. Disiplina imponohet duke përdorur kërcënimet dhe dhunën ose duke mbajtur një pjesë të të ardhurave kriminale. Anëtarët e këtyre grupeve kanë prirje për të kryer krime të tjera si trafik armësh, cigaresh apo dhe grabitje. Të ardhurat e krimit kryesisht shpenzohen për të blerë prona të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe për të bërë një stil të spikatur jetese.

Për sa i përket krimit ekonomik, problemet kryesore duket se rrjedhin jo nga humbja e të ardhurave publike por nga forma të tjera si për shëmbull mashtrimet në prokurimet publike, mashtrimet bankare dhe fajdet si dhe mashtrimet në lidhje me falimentimet dhe privatizimet. Rasti i fundit është në veçanti mjaft i ndjeshëm duke marrë parasysh statutin e kufizuar të hetimeve dhe ndjekjes penale të këtyre çështjeve. Pasojat e krimeve të tilla janë shumë të dukshme për publikun. Publiku zakonisht e shikon këtë gjë si padrejtësi sociale dhe pasurim i paligjshëm dhe zakonisht pret dënimin me sukses të këtyre krimeve nga organet e zbatimit të ligjit dhe ato të gjyqësorit. Mendohet se besimi publik në këto institucione varet nga zgjidhja e çështjeve të tilla të cilat njihen për vështirësinë e tyre për tu hetuar e për tu ndjekur penalisht për shkak të ndërlikimit dhe lidhjeve politike që mund të jenë në mes.¹¹² Për më tepër, dëmi që i shkaktohet shoqërisë nga ky lloj krimi ekonomik është i vështirë të matet dhe të peshohet.

Grupet kriminale që përfshihen në krimin ekonomik përdorin metoda të sofistikuara që lejojnë zhvillimin profesional dhe rekrutimin e ekspertëve (financiare, ligjore, etj.) dhe rrisin lidhjet me strukturat publike nëpërmjet financimit të, për shembull, aktiviteteve sportive, artikujve mediatiqe, ndihmave financiare, shkëmbimit të informacionit policor, sipërmarrjeve të përbashkëta me organizata nga Italia dhe Rusia në zonat bregdetare.

Anëtarët e këtyre grupeve kriminale janë kryesisht qytetarë kroatë me një nivel shkollimi të mesëm dhe me një status mesatar ekonomik. Rolet e tyre zakonisht ndahen në organizatorë, financierë, fallsifikues (p.sh. të dokumentave të nevojshme për të përmbushur kërkesat për kredi) si dhe ndërmjetës (punonjës firmash apo bankash që u interesojnë grupeve kriminale).

Grupet vetë duket se nuk kanë ndonjë strukturë hierarkike. Por, anëtarë nga grupe të ndryshme fillojnë një biznes bazuar në interesat e tyre personale. Në shumicën e rasteve, grupe specifike kriminale krijohen për kryerjen e krimeve specifike. Këto grupe kanë kryesisht një karakter lokal, dhe vetëm në raste të rralla mbulojnë të gjithë territorin e Kroacisë ose operojnë në vendet fqinje si Serbia, Mali i zi, Bosnje Hercegovina, Austria, Italia, Sllovenia dhe Hungaria.

Kroacia duket se jetë kryesisht një vend tranzit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe për transportimin klandestin të personave. Grupet kriminale të implikuara në krime të ndryshme evitojnë mbivendosjet. Rugët për trafikim dhe transportim klandestin janë të ngjashme me ato të vendeve të tjera të rajonit. Struktura organizative e grupeve të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore ka një ndarje hierarkike, si në nivel ndërkombëtar ashtu dhe në atë vendas. Të gjithë personat e përfshirë në zinxhirin e trafikimit të qenieve njerëzore fitojnë në mënyra të ndryshme, në varësi të vendit të origjinës së viktimës, transportit, llojit të rekrutimit, etj. Sasia e përgjithshme dhe e saktë e të ardhurave që burojnë nga ky krihim nuk është e njohur. Të ardhurat e këtij krimi zakonisht investohen për korrupsion dhe për financimin e aktiviteteve të tjera të jashtëligjshme. Në të gjitha rastet e hetuara, kufijtë ose ishin kaluar në mënyrë të jashtëligjshme ose duke përdorur dokumenta pjesërisht ose plotësisht të fallsifikuara.

Transportimi klandestin i personave, kryesisht turq, iranian, kinezë, romunë, bangladeshian, shqiptarë dhe boshnjakë, bazohet në bashkëpunimin e ngushtë me trafikantë nga Serbia dhe Mali i Zi dhe Bosnje Hercegovina. Në raste të tilla Kroacia përdoret si një vend tranzit për në Slloveni. Grupet e krimit të organizuar që merren me transportin klandestin të personave ndërtohen në një mënyrë vertikale, me detyra të përcaktuara qartë dhe me lidhje me grupe ndërkombëtare kriminale që nga fillimi deri në fund të zinxhirit të trafikimit. Transportimi përmes Kroacisë kryhet nëpërmjet

¹¹²Shiko Kroacia: Nje pune ne zhvillim nga Anna McTaggart dhe Drago Hedl, IWPR No. 562, 27 Qershor 2005

makinave të marra me qera, taksive, furgonave dhe kamionëve të vegjël. Qytetarët e huaj më pas transportohen për në Slloveni nëpërmjet zonës së Medjimurijes, Varazdinës dhe Zagrebit.

Për sa i përket pastrimit të parasë, Kroacia ka një vijë bregdetare mjaft joshëse për investitorë fondesh të ligjshme ose jo, qofshin këta vendas apo te huaj. Pasuri të tilla natyrore shpesh mund të shfrytëzohen për pastrimin e të ardhurave të krimit, përmes të cilave blihen ose bëhen ndërtime, dhe për këtë arsye kërkojnë një monitorim të kujdesshëm dhe një kombinim të mekanizmave shtypës dhe parandalues për ruajtjen e integritetit dhe kapacitetit të tyre për zhvillim ekonomik. Një gjë e tillë demonstron nga raste e kohëve të fundit të korrupsionit në zyrat e regjistrimit të pasurive.¹¹³

Parashikohet që kërcënimi nga krimi i organizuar të rritet në të ardhmen, sidomos për shkak të tendencës së kriminelëve për të depërtuar në elitat politike dhe ekonomike si një mënyrë për të përmirësuar imazhin e tyre publik dhe për të influencuar vendimet politike, ekonomike dhe administrative duke përdorur të ardhurat e tyre kriminale. Korrupsioni i cili lidh krimin e organizuar dhe ekonomik është mjete kryesor për depërtimin në strukturat qeverisëse.

¹¹³ Shiko artikullin *Punonjesit e Administratës Shtetërore në Makarska nën hetim*, HINA, Lista Jutarnji, 12 Maj 2005; dhe *Kroacia: Nje pune ne zhvillim* nga Anna McTaggart dhe Drago Hedl, IWPR No. 562, 27 Qershor 2005.

4.2.4 Serbia dhe Mali i Zi

4.2.4.1 REPUBLIKA E MALIT TË ZI

Lufta dhe sanksionet në vitet 1990 sollën një rënie ekonomike, shtresëzim të shoqërisë dhe sfida politike. Ashtu si dhe në vendet e tjera të rajonit, mundësitë për kontrabandë u shtuan, ndërkohë që sfidat e tranzicionit dëmtuan kuadrin ekzistues ligjor dhe institucionet shtetërore.

Për sa i përket situatës së krimit të organizuar dhe kërcënimit që ky krim i bën shoqërisë së Malit të Zi ka shumë pak informacion. Si rrjedhojë, organet e zbatimit të ligjit nuk kishin grumbulluar asnjë të dhënë mbi krimin e organizuar deri në momentin që ky krim u fut si koncept ne legjislacionin penal të vitit 2004. Mali i Zi përbën të vetmen zonë në rajon në të cilën duhet ende të ndërtohet një sistem për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e krimit të organizuar. Si rrjedhojë, është e vështirë që të kryhet një vlerësim kuptimplotë i kërcënimit nga krimi i organizuar, por duke u bazuar në informacionin e disponueshëm, krimi ekonomik, trafikimi i drogës dhe qënieve njerëzore dhe pastrimi i parasë duket të jenë problemet kryesore për këtë zonë.

Ashtu si dhe vendet e tjera në rajon, Mali i Zi e shikon krimin ekonomik si një nga kërcënimet kryesore që shkakton humbje të konsiderueshme në të ardhurat publike nëpërmjet evazionit në sistemin doganor dhe të taksave. Ky evazion kryhet nëpërmjet përdorimit të dokumentave të fallsifikuara, kompanive të rreme të regjistruara jashtë vendit dhe nëpërmjet skemave të tërthorta tregtare me vëndet fqinjë. Në vitin 2004, policia depozitoi 1320 padi penale (1358 në vitin 2003) kundër 1572 personave (1811 në vitin 2003) për 1707 (1877 në vitin 2003) krime të regjistruara ekonomike. Humbja e përgjithshme në të ardhurat e shkaktohet nga ky krim arrin deri në 17.2 milion Euro (16.5 milion Euro në vitin 2003). Fallsifikimi i dokumentave zyrtare dhe tregtia e jashtëligjshme, vijuar nga abuzimi me postet publike, mashtrimi, dhe shpyllezimi i paligjshëm, dominuan fushën e krimit ekonomik në këto vitet e fundit. Asnjë nga këto raste nuk është cilësuar si e kryer nga ndonjë grup i krimit të organizuar.

Kontrabanda e mallrave të akcizës përmes kufinjve vazhdon të mbetet problem, megjithëse kontrabanda e cigareve që dikur ndodhte rëndomtë tani është reduktuar. Në anën tjetër, kontrabanda e naftës dhe produkteve të saj shkaktoi një humbje në të ardhura prej 9 milion Euro në vitin 2003. Gjithashtu po vihet re dhe një transportim i jashtëligjshëm i shumave të mëdha të hollash. Përveç një porti detar, disa zonave kufitare dhe bregdetare, shumica e aktivitetit ekonomik ndodh në kryeqytet ku jeton më shumë se një e treta e popullsisë së Malit të Zi, duke mundësuar përqëndrimin e hetimeve financiare në një zonë. Përlllogaritjet e vlerës së ekonomisë së zezë nuk janë kryer. Sidoqoftë, është i dukshëm efekti negativ i saj, duke marrë parasysh përmasat relativisht të vogla të tregut të brëndshëm Malazez. Kja gjë vihet re dhe në faktin që tregtarët e mallrave kontrabandë mbajnë çmime konkurruese duke shmangur rreth 200% të vlerës së mallit nga taksat dhe kontributet.

Kontrabandistët e mallrave të ligjshëm nuk veprojnë sipas ndonjë strukture hierarkike por duke formuar aleanca sipas rasteve të veçanta si brenda Malit të Zi ashtu dhe jashtë kufinjve të saj me grupe nga vëndet fqinjë.

Trafikimi i drogës është i dukshëm, sidomos trafikimi i kanabisit nga Shqipëria dhe i heroinës nga Turqia. Keto drogëra futen në Mal të Zi përmes rrugëve tokësore, ndërsa kokaina futet portit të Barit. Mali i Zi është kryesisht një vënd tranzit, por disa drogëra, sidomos kokaina dhe kanabis, konsumohen në tregun e brëndshëm. Fakte sporadike dhe vrojtme të policisë tregojnë për një rritje të problemit të abuzimit me drogën në këto 7 - 8 vitet e fundit. Sidoqoftë, përlllogaritjet e përmasës së tregut të brëndshëm të drogës apo të fitimeve të drogës së trafikuar nëpërmjet Malit të Zi nuk egzistojnë. Sipas të dhënave që mbulojnë periudhën 2001 - 2004, organet e zbatimit të ligjit konfiskojnë çdo vit një sai prej rreth 10 - 15 kg heroinë dhe 1 ton kanabis, ku përfshihen nga 205 deri në 300 persona. Nuk ka të dhëna të disponueshme mbi strukturën, përbërjen dhe mënyrën e veprimit të këtyre grupeve trafikante.

Trafikimi i qënieve njerëzore, një fenomen që u shfaq dukshëm në një rast trafikimi të një gruaje Moldave në vitin 2002, nxiti qeverinë të ndermerte masa progresive.¹¹⁴ Ashtu si dhe për rastet e tjera, nuk ka të dhëna të disponueshme dhe një analizë të tregut të trafikimit të qënieve njerëzore si dhe strukturës dhe mënyrës së veprimit të krimit të organizuar të përfshirë në këtë fushë. Sidoqoftë, bazuar në rastet e trafikimit të hetuara deri tani (10 padi penale ndaj 31 personave), duket se ka patur 7 grupe kriminale përgjegjëse për këto krime me struktura organizative të ndryshme.

Transporti klandestin i personave është zvogëluar si rrjedhojë e ndryshimeve në regjimin e vizave, sidomos për kalimin klandestin nga Shqipëria. Në anën tjetër, një regjim më strikt vizash për qytetarët Shqiptarë dhe Kosovarë që kërkojnë të futen në Bosnje Hercegovinë dhe Kroaci, ka krijuar si rrjedhojë një treg për transport klandestin përgjatë këtyre kufinjve. Në periudhën midis Janarit dhe Shtatorit të vitit 2004 u regjistruan 372 kalime të jashtëligjshme të kufirit.

Megjithëse koncepti i pastrimit të parasë është futur në kuadrin ligjor dhe institucional të Malit të Zi vetëm në këto vitet e fundit, zonat bregdetare dhe disa kompani publike të nxjerra për shitje janë në veçanti të cënuara nga pastrues parash vëndas apo të huaj. Për sa i përket korrupsionit, në nivele të ulta apo të larta si dhe lidhjet e ngushta të përkrahjes, vihet re se ky fenomen përben një sfidë për reagimin e suksesshëm ndaj krimit të organizuar, duke përfshirë dhe procesin hetimor e gjyqësor.

4.2.4.2 REPUBLIKA E SERBISË

Lufta dhe sanksionet gjatë viteve 1990, ndikuan thellësisht karakterin politik, ekonomik dhe social të Serbisë dhe ofruan mundësi të posacme përfitimi për krimin e organizuar jo vetëm në Serbi por në të gjithë rajonin. Rënia e regjimit të Milloshevicit në vitin 2000, sollti në jetën politike një qeveri të re të gatshme për të përballuar disa prej sfidave të tranzicionit dhe të periudhës së pas luftes, duke përfshirë dhe goditjen e krimit të organizuar. Mbas vrasjes së Kryeministrit, Zoran Djindjic, në vitin 2003, dhe zbatimit të ligjit *Sabre* në vijim, i cili i dha fund Klanit të Zemunit, Serbia u fut në rrugën e përpjekjeve serioze kundër krimit të organizuar. Gjithsesi, shpërbërja e Klanit të Zemunit, megjithëse e suksesshme, duket të ketë qënë “një vrimë në ujë”.¹¹⁵ Lidhja midis shërbimit të sigurimit, krimit të organizuar dhe ish forcave paramilitare të krijuara nga Milloshevici dhe të zhvilluara më tej gjatë luftës në vitet 1990, është adresuar deri në një farë pike. Gjithashtu ka filluar reforma për ndarjen e shërbimit informativ policor dhe të sigurimit të shtetit si dhe është prezantuar mbikëqyrja civile dhe transparenca mbi sektorin e sigurimit. Përfundimi me sukses i kësaj reforme dhe qëndrueshmëria e saj do të jenë kyçe për zhdukjen e kërcënimit nga krimi i organizuar në Serbi.

Duke patur parasysh fuqinë e krimit të organizuar, financiar apo i ndonjë lloji tjetër, trafiku i drogës dhe krimi i organizuar ekonomik duket të jenë kërcënimet kryesore për Serbinë. Korrupsioni, mashtrimet në privatizime dhe pastrimi i parasë shkaktojnë një shqetësim të ngjashëm me atë të Kroacisë dhe “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”. Pas vitit 2000, kontrabanda e mallrave të ligjshme (naftës dhe cigareve) u zvogëluar dhe mbledhja e të ardhurave publike u përmirësua. Sidoqoftë, pasojat sociale, ekonomike dhe politike të pasurimit të jashtëligjshëm dëmtojnë besimin pulik ndaj strukturave qeverisëse, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësore. Një numër rastesh të krimit të organizuar u denuan, ndërkohë që numri i vrasjeve u zvogëluar dukshëm që nga ndryshimi i regjimit në vitin 2000.¹¹⁶ Megjithëse janë arritur rezultate pozitive, gjyqet në vazhdim ndaj të dyshuarve për vrasjen e Djindjic përbëjnë një test për besimin publik.

Duke patur parasysh dhe pozicionin geografik, krimi i organizuar për trafikun e drogës është momentalisht një nga format më të rrezikshme të krimit të organizuar në Serbi. Kanabis është droga më e përhapur në Serbi. Megjithëse është zbuluar një sasi e një shkalle të vogël prodhimi prej 2000 rrënjësh në një minjerë të braktisur, kanabisi në të shumtën e rasteve importohet dhe shitja me një cmim relativisht të ulët e bën atë mjaft të disponueshëm. Rrugët e kontrabandës së kanabisit për në

¹¹⁴ Për një informacion të detajuar në lidhje me këtë çështje shiko Raportin e përbashkët të Këshillit të Europës dhe OSBE- së (Shtator 2003) dhe përgjigjen e Qeverisë së Republikës së Malit të Zi (Tetor 2003).

¹¹⁵ Intervistë me oficer Serb të zbatimit të ligjit.

¹¹⁶ Sipas një oficeri të zbatimit të ligjit me përvojë, numri i vrasjeve u ul nga 200 në 60 në vit që nga rënia e regjimit të Milloshevicit. Intervistë, Qershor 2005.

Serbi vijnë nga Mali i Zi dhe Shqipëria, ndërkohë që rrugë të zbuluara së fundmi tregojnë për një kontrabandë të kanabisit nga Serbia për në Hungari.

Heroina është droga e dytë më e përhapur në tregjet Serbe, duke patur parasysh se kontrabanda dhe shitja e heroinës përbën biznesin më fitimprurës kriminal. Deri tani nuk është zbuluar ndonjë prodhim heroine në Serbi. Shumica e heroinës vjen nga Kosova dhe policia Serbe bashkëpunon rregullisht me UNMIK-un dhe policinë e Kosovës për çështjet që lidhen me trafikimin e heroinës. Megjithatë, sipas autoriteteve Serbe shkëmbimi i informacionit lë vënd për përmirësime.

Drogërat sintetike (ekstasia dhe amfetaminat) vijnë kontrabandë nga Perëndimi për në Lindje nga Holanda nëpërmjet Hgungarisë dhe Kroacisë. Përdorimi i ekstasisë është gjithashtu mjaft i përhapur në Serbi. Janë zbuluar disa lanoratorë të prodhimit të ekstasisë në vend, të cilat rezultuan në arrestimin e organizatorëve kryesorë dhe të pronarëve të kompanive që shërbenin si mbulojë. U konfiskuan afërsisht 2 milion pilula ekstasie si dhe 20 ton kimikate të nevojshme për prodhimin e drogës me një vlerë disa milion euro. Ashtu si dhe në Bosnje Hercegovinë policia Serbe zbuloi një tregti në lende kimike të nevojshme për prodhimin e drogës të futura kontrabandë nga Franca, Republika Çeke dhe Rumania, që pas transportoheshin për në Bullgari dhe Turqi.

Një drogë tjetër që e ka prejardhjen nga Perëndimi është dhe kokaina, pjesa më e madhe e se cilës kalon tranzit nga Serbia, ndërkohë që një pjesë e vogël mbetet për konsum në tregun e brëndshëm. Rrugët e trafikimit të kokainës duket të kenë ndryshuar kohët e fundit. Nëpërmjet anijeve kokaina arrin në portet e Spanjës, Greqisë dhe Italisë dhe më pas transportohet për në Serbi nëpërmjet kamionëve, shpesh e paketuar në shishe. Policia Serbe në bashkëpunim me forca të tjera policore ndihmoi në kapjen e 200 kg kokaine (190 kg u kapën në Itali, ndërkohë që 10 kg u kapën në Serbi). Grupet kriminale të përziera në trafikimin e kokainës janë të mirë organizuara dhe kanë strategji të efektshme transporti.

Mbi gjashtëdhjetë përqind e grupeve të krimit të organizuar në Serbi shfaqet të jetë e përzier në trafikimin e drogës. Rreth 50% e këtyre grupeve, përveç trafikut të drogës, është e përzier dhe me krime të tjera si vrasje, shantazhe, rrëmbime dhe grabitje. Megjithatë numri i krimeve të tilla ka patur një rënie të dukshme që nga viti 2003. Në mënyrë të ngjashme me vrottime e UNMIK-ut, grupet më të organizuara dhe më të fuqishme të përfshira në trafikun e drogës janë grupet Shqiptare, me pjestarë me origjinë nga Kosova ose Serbia jugore. Vihet re gjithashtu, se organizatat kriminale Bullgare dhe Shqiptare janë në konkurrencë me njëra tjetrën për kryesim të tregut të drogës në Serbi.

Për sa i përket trafikantëve vëndas, operacioni "Saber" shkatëroi disa grupe të krimit të organizuar dhe neutralizoi një prej rrjeteve më të mëdhaja të trafikimit dhe shitjes së heroinës në Serbi dhe në vëndet e tjera të Europës. Grupi më i madh, Klani i Zemunit, kishte gjashtë nën-grupe me rrjetet e tyre të shpërndarjes. Klani kishte një famë të keqe për përdorimin e dhunës në disiplinimin e anëtareve dhe të personave që i pengonin në punën e tyre. Menjëherë mbas shkatërimit të këtij klani u zbardhën një numër i madh vrasjesh dhe tentativash për vrasje. Kryetarët e klanit i kishin investuar të ardhurat e krimit, të përlllogaritura në miliona euro, në prona të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe në mallra lluksoze. Për të siguruar biznesin e tyre, duke përdorur fuqinë e tyre të jashtëzakonshme financiare, klani korruptonte zyrtarë nga rradhët e policisë dhe të gjyqsorit, dhe krijoi një organ të medias për të influencuar opinionin publik. Te ardhurat e jashtëligjshme duken të jenë investuar në privatizime, pasuri të paluajtshme, biznese tregtare, etj.

Ashtu si dhe Shqipëria, po punojnë që të konsolidojnë influencën e tyre, ndërkohë që shpërndajnë aktivitetet e tyre në tregje të tjera të jashtëligjshme apo në sektorë të ligjshëm.

Përsa i përket trafikimit të qënieve njerëzore (për shfrytëzim seksual, lypje dhe punësim) Serbia duket të jetë kryesisht një vënd tranziti, por dhe një vënd origjine dhe destinacioni të përkohshëm. Sipas autoriteteve Serbe, në trafikimin e qënieve njerëzore janë të përfshira 10 grupe kriminale me rreth 100 anëtarë. Grupet janë kryesisht aktive në zonat kufitare, janë të mirë organizuara dhe të lidhura ngushtë me grupe kriminale në vëndet e tjera fqinje si për shembull "ish Republikën

Jugosllave të Maqedonisë”, Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë, Kroacinë, Bosnje Hercegovinën, Shqipërinë, Italinë, Ukrainën, Slloveninë dhe Turqinë.

Grupet janë mjaft përshtatshme sipas kushteve dhe formojnë lehtësisht aleanca bazuar në interesa të përbashkëta. Ata përdorin kode komunikimi dhe takohen nëpër vende ku akomodohen viktimat e trafikimit. Si një praktikë mbrojtëse ata përdorin të ashtuquajtur “pastrues” – makina që udhëtojnë përpara me qëllim paralajmërimin për rreziqe të mundshme që mund të hasen në rrugë e sipër. Kryetarët e këtyre grupeve nuk përfshihen asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këto operacione, por janë të përgjegjshëm për kryerjen e pagesës mbas përfundimit të transportit. Të hollat zakonisht transferohen nëpërmjet një banke të “Eëstern Union”. Të ardhurat investohen në biznese tregtare si dhe në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Numri i viktimave të trafikimit që kanë Serbinë si destinacion duket se ka patur rënie këto vitet e fundit¹¹⁷, kryesisht për shkak të përpjekjeve të policisë por dhe si efekt i një regjimi më strikt vizash për qytetarët e Rumanisë dhe Moldovës. Tendenca e re duket të jetë rekrutimi vëndas (nëpërmjet Internetit) dhe trafikimi i brëndshëm, ku qytetarë Serbë fillimisht shfrytëzohen brënda vëndit dhe më pas trafikohen në vende të tjera. Përpjekjet e kohëve të fundit nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, vunë në shënjestër trafikimin e fëmijëve duke nërmarrë masa kundër prindërve që shisin fëmijët e tyre dhe kundër personave që i blinin këta fëmijë.

Emigrimi i jashtëligjshëm është një prej aktiviteteve kriminale në zgjerim kryesisht sepse shërben si një zëvendësues i trafikimit të drogës, duke ofruar përfitime të mëdha me më pak rreziqe. Transportimi klandestin i njerëzve zakonisht organizohet nga persona nga vëndi i origjinës, së bashku me kontrabandistë nga rajoni dhe pagesa që kërkohet është nga 2.500 deri në 8.000 euro. Tendencat e fundit të trafikimit tregojnë për transportime grupesh të vogla prej 4 – 8 persona, madje dhe 1 – 2 persona në një rrugë duke përdorur makina pasgjerësh, furgona dhe kamionë me strehëza të postashme për fshehjen e klandestinëve. Emigrantët klandestinë transportohen me makinë deri në kufi dhe më pas merren në dorëzim nga një guidë që i shoqëron përtej kufirit në këmbë. Mbas kalimit të kufirit, përdoret një makinë tjetër për transportimin e emigrantëve deri në kufinj të tjerë me Hungarinë ose Kroacinë.

Qytetarët Rumunë, kryesisht ata ekonomik, janë emigrantët më të zakonshëm në Serbi. Emigrantët të tjerë vijnë nga Afganistani, Iraku dhe Turqia (kryesisht Kurdet). Hetimet e fundit të rrjeteve të kontrabandës përmes aeroporteve të Sarajevës dhe Prishtinës, i zhvendosën rrugët e trafikimit përmes Bullgarisë dhe Rumanisë, nga ku qytetarë Turq transportohen në mënyrë klandestine përmes Serbisë për në Perëndim.

Përpjekjet për të luftuar transportin klandestin të personave, përveç të tjerash përfshijnë një menaxhim më të mirë të kufirit, rregullime në regjimin e vizave dhe masa shtypëse kundër grupeve kriminale të përfshira në transportin klandestin dhe kontrollin e ambjenteve që dyshohen si strehëza emigrantësh. Sipas të dhënave nga viti 2003, u ndërpre në 22 kanale nëpërmjet të cilave ishin transportuar në mënyrë klandestine 247 persona.

Kontrabanda e mallrave të ligjshëm (cigareve, naftës dhe produkteve të saj) ka rënë dukshëm që mbas heqjes së sanksioneve dhe si rrjedhojë e përpjekjeve midis të tjerash nga ana e organeve të zbatimit të ligjit që nga viti 2000. Praktikën e kontrabandës kanë ndryshuar duke ju përshtatur kushteve të reja. Sidoqoftë ato akoma vazhdojnë që ti rezistojnë përpjekjeve të zbatimit të ligjit duke u integruar në rrjedhat e kontrabandës Europiane dhe globale të shpërndarjes së cigareve të prodhuara në mënyrë të ligjshme ose jo. Kanalet e kontrabandës përmes Malit të Zi kryesisht janë ndërprerë, por në të njëjtën kohë janë formuar kanale të reja që kalojnë përmes Kosovës, “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, Bullgarisë, Rumanisë dhe Kroacisë. Cigaret kontrabandë fshihen në makina pasagjerësh ose mallrash ose paketohen si produkte të tjera (fruta të ngrira ose miell për ndihma humanitare). Si në vëndet e tjera të rajonit, tregtia e cigareve dhe e mallrave të tjera

¹¹⁷ Sipas autoriteteve Serbe, 2.000 qytetarë të huaja femra u gjetën duke ‘punuar’ në restorante dhe hotele në vitin 2000. Në vitin 2003, ky numër u zvogëlu në 203.

të akcizes bëhet nëpërmjet kompanive të rreme dhe dokumentave të fallsifikuar. Për sa i përket prodhimit kontrabandë, është vënë re se në tregtinë e pijeve alkolike janë përdorur mallra me afat skadence të mbaruar të futura në vënd nëpërmjet kompanive të rreme.

Pirateria lulëzoi në vitet 1990. Në fillim të vitit 2003, u ndërmorën një numër masash për shtypjen e piraterisë të cilat rezultuan në konfiskimin e mbi 60.000 video kasetash dhe CD-ve, sasive të medha të paisjeve audio vizuale të përdorura për regjistrimin e audiove dhe imazheve, si dhe softëare-ve të kompjuterit.

Për sa i përket pastrimit të parasë, shumica e të ardhurave që pastrohen buron nga evazioni fiskal, më pas nga trafiku i drogës dhe qënieve njerëzore dhe së fundi nga krime të dhunshme si grabitje dhe rrëmbime. Të ardhurat kryesisht investohen në privatizime, në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ose transferohen në llogari bankare si brënda ashtu dhe jashtë vëndit. Transferta të mëdha parash kryhen nëpërmjet Hungarisë, Qipros dhe Austrisë si dhe nëpërmjet llogarive të hapura. Kundravajtësit e këtij lloji krimi janë zakonisht persona me eksperiencë në biznes dhe ekonomi.

4.2.4.3 KOSOVA

Megjithëse e fundit që u prek nga luftërat në ish Jugosllavi në vitet 1990, Kosova ashtu si dhe Bosnje Hercegovina përballet me sfida të rëndësishme të mbas luftës dhe tranzicionit nën administrimin e UNMIK-ut. Zhvendosja, shkatërrimi i pronës, teknologjia e prapambetur dhe kapitullimi i sektorit të manufakturës zvogëloi mundësitë e punësimit për pjesën më të madhe të popullsisë në moshë të re.¹¹⁸ Ashtu si dhe në vëndet e tjera fqinje, vakumi politik dhe ekonomik ofroi mundësi për krimin e organizuar.

Kërcënimi kryesor për Kosovën duket të jetë krimi i organizuar ndërkombëtar i trafikimit të drogës dhe qënieve njerëzore. Kosova ka një vendodhje kyce në rajon për shumë kriminelë në Europën Jug – Lindore. Lidhjet e ngushta me popullsinë etnike Shqiptare në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, në Shqipëri dhe me diasporën Shqiptare jashtë vëndit i bëjnë grupet e krimit të organizuar Kosovare mjaft efektive në trafikimin e drogës në tregjet Perëndimore.

Hetimet e trafikut të drogës në Kosovë mbulojnë si demensionin e brëndshëm ashtu dhe atë ndërkombëtar. Drejtoria e Krimit të Organizuar, Hetimi i Krimit të Organizuar Ndër – Kufitar, merret me hetimin afatgjatë të trafikimit të drogës në bashkëpunim me Zvicrën, Francën, Austrinë, Gjermaninë, Bullgarinë dhe Turqinë. Kjo drejtori është krijuar për shkatërrimin e rrjetit të rëndësishëm të kontrabandës së heroinës nga Turqia për në Europën Perëndimore. Sektori i Hetimeve mbi Lëndët Narkotike i kësaj Drejtorie merret me rastet e trafikut të drogës brënda territorit të Kosovës.

Nga viti 2003 deri në vitin 2005 u hetuan katër çështje ndërkombëtare të lidhjeve me trafikimin e drogës. Midis Qershorit dhe Dhjetorit 2003 u sekuestruan 90 kg heroinë nga të cilat 38 kg u kapën në Kosovë, 24 kg në Itali dhe 28 kg në Bullgari. Në vitin 2004 dhe 2005 u hetuan 20 çështje afat – gjata, ndërkohë që gjashtë prej tyre kërkonin një bashkëpunim ndërkombëtar. Bazuar në këto hetime nga Janari deri në Dhjetor të vitit 2004, në Kosovë u konfiskuan 45.5 kg heroinë, ndërkohë që 504.5 kg u konfiskuan në Austri, Gjermani, Itali, Svicër, Serbi, Bullgari dhe Shqipëri duke arritur një total heroinë prej 550 kg të konfiskuar në këtë periudhë. Për momentin janë në vazhdim pesë hetime afat – gjata.

Për sa i përket hetimeve të brëndshme, në vitin 2004 policia e Kosovës dhe UNMIK-u zbuluan dhe shkatërruan 12 fusha me kanabis. Numri i përgjithshëm i rasteve të kontrabandës së drogës të hetuar në Kosovë në vitin 2004 dhe 2005, të cilat nuk klasifikohen si raste të krimit të organizuar, është 265 me më shumë se 458 persona të përfshirë. Gjatë të njëjtës periudhë kohore janë hetuar 15 raste që kanë patur lidhje me krimin e organizuar, ku janë përfshirë më shumë se 87 persona.

¹¹⁸ Per situatën ekonomike në Kosovë, shiko *C'industrializimi dhe pasojat e tij: Një histori Kosovare*, Nisma Europiane e Stabilitetit, Mars 2002, www.esieeb.org.

Për sa i përket abuzimit me drogën, tregu i brëndshëm nuk duket të përbëj ndonjë problem.

Në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore Kosova është si vënd tranzit ashtu dhe vënd destinacioni, fillimisht si rrjedhojë e prezencës së forcave ndërkombëtare por momentalisht dhe si pasojë e klientelës vëndase. Ashtu dhe si në Bosnje Hercegovinë, klientela vëndase për shërbimet seksuale është mjaft e rëndësishme dhe përbën rreth 90% te klientëve.¹¹⁹ Strukturat e grupeve kriminale të përfshira në trafikim janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me vëndet furnizuese. Grupet që merren me shfrytëzimin seksual të viktimave në Kosovë i marrin viktimat menjëhere mbas mbërritjes në Kosovë, gjë që tregon për lidhjet direkte midis grupeve që veprojnë në vëndet e origjinës dhe grupve që veprojnë në Kosovë.

Duket sikur egzistojnë tre nivele grupesh kriminale që veprojnë në Kosovë që shpesh ndërlidhen me njëra tjetrën. Grupet e nivelit të ulët kujdesen për transportin e viktimave me makinë ose furgona, ose thjesht sigurojnë të hollat e nevojshme që viktimat të kalojnë kufirin me autobus. Më pas këto viktimat strehohen në të njëjtat ambiente ku dhe do të shfrytëzohen. Grupet e niveleve më të larta organizojnë akomodimet për udhëtime ndërkombëtare, përfshirë këtu dhe sigurimin e dokumentave dhe vizave të fallsifikuara, por nuk përfshihen vetë në shfrytëzimin e viktimave megjithëse ato organizojnë dhe ri - trafikimin. Grupe të tilla veprojnë sipas në një mënyrë më të strukturuar dhe shfaqin një hierarki, duke filluar që nga përdorimi i "personave manikine" të cilët sigurojnë mbulesën ndaj kryetarit të rrethit kriminal, duke vazhduar me personelin e sigurisë dhe të zbulimit i ngarkuar me detyrën e përcarjes së aktiviteteve të policisë, e më pas me zyrtarë të korrumpuar që informojnë grupet kriminale për aksionet e policisë. Grupet kriminale të përfshira në këtë krim janë kryesisht ndëretnike, megjithëse disa kombësi mund të jenë dominante në një grup. Mënyra e veprimit në tregun e këtij krimi të organizuar po bëhet më e sofistikuar dhe po ingranohet për ti shërbyer si tregut të brëndshëm ashtu dhe atij rajonal. Gjithastu vihet re të jetë prezent dhe trafikimi e rekrutimi i brëndshëm.

Ekonomia e Kosovës është pothuajse e bazuar tërësisht në tregti, duke i bërë të ardhurat publike të varen nga vetëm një burim, i cili është gjithashtu shumë tërheqës për krimin ekonomik. Kontrabanda, evazioni në sistemin doganor dhe të taksave dhe krime të tjera të lidhura me korrupsionin në sektorin publik përbëjnë gjithashtu një kërcënim për shoqërinë Kosovare. Disa ndryshime, si për shembull, licensimi i importeve të karburantit dhe të cigareve si dhe futja e sistemit kompjuterik në dogana kanë sjellë një ndryshim të dukshëm në mbledhjen e të ardhurave. Në mënyrë të ngjashme me Malin e Zi, shumica e aktiviteteve ekonomik dhe e kompanive veprojnë në prishtinë, duke mundësuar hetimin më me lehtësi të krimet ekonomik.

Për sa i përket strukturës këto grupe, janë të ngjashme me ato të përfshira në trafikimin e qënieve njerëzore. Ato bashkëpunojnë ngushtë me grupe nga Serbia, Mali i Zi, Greqia, "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Shqipëria, Sllovenia dhe Bullgaria.

¹¹⁹ IOM (Qershor 2004), f. 67

4.2.5 "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"

Me përjashtim të një konflikti të shkurtër në vitin 2001, "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" i shpëtoi shkatërrimit në masë nga lufta dhe zhvendosjes së pjesës dermuese të popullsisë së saj. Gjithsesi, çështje të brëndshme politike të lidhura me sovranitetin e vëndit, rënien ekonomike, sanksionet kundër Jugosllavisë dhe lufta në vëndet fqinje ndikoi negativisht vëndin. Ashtu si në vëndet e tjera të rajonit, këta faktorë i siguruan grupeve të krimit të organizuar mundësi dhe avantazhe të shumta.

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" kërcënohet nga krimi i organizuar ekonomik dhe nga krimi i organizuar në lidhje me trafikimin e drogës dhe qënieve njerëzore. Aktivitetet kryesore të krimit ekonomik janë mashtrimi në lidhje me prokurimet publike, deklarimi i falimentimit, mashtrimet në lidhje me privatizimet dhe me TVSH-te. Momentalisht nuk ka një përlllogaritje në lidhje me dëmin që ky krim i bën xhepit të publikut, por që mendohet të matet me qindra milionë euro. Kanë filluar hetime mbi këtë lloj krimi, por rezultatet mbeten për tu parë në të ardhmen. Gjithsesi akoma mungojnë mjetet për sekuestrimin e të ardhurave të krimit.

Mashtrimi në prokurime zakonisht arrihet mbas përzgjedhjes së kompanisë më të kualifikuar duke shtuar në kontratë në mënyrë që të rritet cmimi i fillimit të tenderit. Gjithashtu janë regjistruar dhe mashtrime bankare ku është arritur të merren kredi nëpërmjet përdorimit të dokumentave të fallsifikuar. Fallsifikimi i dokumentave zyrtarë përdoret gjerësisht për përfitime të paligjshme pronash, për marrjen e licensave për import mallrash me kushte të favorshme, etj. Mashtrimet në lidhje me TVSH-ne si dhe kontrabanda dhe fallsifikimi i mallrave të ligjshëm gjithashtu është identifikuar si një problem. Ky i fundit duket të ketë një tendencë në ulje ndërsa i pari në rritje.

Për sa i përket piraterisë dhe fallsifikimit të mallrave të ligjshme, autoritetet kanë vënë re një prodhim, shpërndarje, shitje dhe dhënie me qera në mënyrë të paligjshme të filmave pornografikë dhe produkteve kompjuterikë. Veprimet e fundit kundër këtij lloj krimi rezultuan në shkatërrimin e një grupi kriminal që prodhonte produkte të tilla dhe në konfiskimin e paisjeve dhe të materialeve të regjistruara. Ka patur gjithashtu raste të fallsifikimit të produkteve ushqimore, pijeve freskuese dhe alkoolike dhe produkteve të tjera konsumatore të destinuara për konsum të brëndshëm. Përpjekjet e fundit nga ana e organeve të zbatimit të ligjit i përballuan me sukses këto lloj krimesh.

Për sa i përket korrupsionit, zyrtarët që merren me zbatimin e procedurave të falimentimit të ish ndërmarjeve shtetërore duket të jenë më të prekur. Gjithashtu janë vënë re dhe forma të tjera të korrupsionit në nivele të ulta dhe të larta. Në vitin 2004, policia regjistroi 536 krime të lidhura me korrupsionin të kryera nga 664 persona. Rastet që lidhen me abuzimin e posteve publike arrijnë deri në 504 dhe janë kryer nga 631 persona. Më pas vijojnë rastet e tjera të korrupsionit pasiv ose aktiv. Qeveria ka ndërmarrë si masa shtypëse ashtu dhe masa parandaluese për tu përballur me këtë problem.

Në vitin 2003, janë denuar 8 grupe të krimit të organizuar ekonomik. Këto grupe me struktura të ndryshme organizative vepronin si brënda ashtu dhe jashtë vëndit dhe i investonin të ardhurat e tyre për zgjerimin e aktiviteteve tregtare, në pasuri të paluajtshme dhe në një konsumim të bollshëm mallrash.

Ashtu si dhe në Kroaci, krimet ekonomike si deklarimi i falimentimit, mashtrimet në privatizime dhe përvetësimi i fondeve publike në sektorin e shërbimeve për publikun përfshinin klasën menaxhuese, lidhjet politike dhe korrupsionin. Natyra e ndërlikuar dhe e ndjeshme e çështjeve të tilla i bën ato të vështira për tu hetuar dhe për tu ndjekur penalisht, ndërkohë që pasojat e tyre sociale dhe ekonomike në shoqëri e bëjnë publikun mjaft të ndjeshëm ndaj zgjidhjes së tyre.

Trafikimi i drogës përben gjithashtu një kërcënim për shoqërinë. Droga trafikohet kryesisht nga persona me etni Shqiptare me lidhje të ngushta në Kosovë dhe Shqipëri. Deri në një farë mase

kriminelëve që i përkasin etnive të tjera u lejohet të kruejnë punë lehtësuese në këtë trafik. Një përqëndrim i veçantë gjeografik i aktiviteteve të tilla kriminale, papërshtueshmëria e grupeve Shqiptare të krimit të organizuar dhe ndjeshmëria politike që mund të sjellë hetimi dhe ndjekja penale e këtyre çështjeve, i pengon përpjekjet e organeve të zbatimit të ligjit në këtë fushë.

Përveç heroinës së trafikuar nga Turqia, kokaina që vjete nga portet e BE-se dhe hashashi me origjinë nga Shqipëria gjithashtu kanë mundur të depërtojnë në vënd. Kanabisi që dominon në tregun e brëndshme kontrollon nga grupe të një etnie, ndërkohë ngarkesat e mëdha të kanabisit me destinacion tregjet e Europës Perëndimore kontrollohen nga grupe kriminale me përbërje të ndryshme etnike si Maqedonase ashtu dhe Shqiptare.

Në dekadën e fundit "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" është kthyer gjithashtu në një treg konsumi ku dominon heroina dhe kanabisi. Sipas autoriteteve shëndetsore, çdo vit rreth 600 deri në 700 individë kërkojnë ndihmë shëndetsore si pasojë e abuzimit me drogën. Moshë e abuzuesve të drogës është në ulje, duke patur dhe raste fëmijësh dymbëdhjet vjeçarë. Çdo vit vdesin nga mbi përdorimi i drogës nga 15 deri në 20 persona.

Një analizë e raportuar strikte për përdorimin e drogës në tregun e brëndshëm e bazuar në një numër njerëzish që kanë patur nevojë për ndihmë mjeksore tregon për një konsum vjetor heroine prej 300kg dhe dyfishin e kësaj shume për kanabis. Fitimet nga ky treg arrijnë midis 10 deri në 12 milion euro. Perfitimi i përgjithshëm nga krimet që lidhen me trafikun e drogës nuk mund të përcaktohet në mënyrë më specifike për shkak të mungesës së hetimeve në fushën e pastrimit të parave. Sidoqoftë, nga të dhëna të tjera policore rezulton se të ardhurat investohen në pasuri të paluajtshme, në industrinë e turizmit si dhe në aktivitete të tjera private si klube nate dhe bare, të cilat shpesh përdoren për shfrytëzim seksual të grave.

Nuk është regjistruar ndonjë prodhim lëndësh narkotike, përveç rasteve sporadike të kultivimit të vogël të kanabisit për përdorim të brëndshëm.

Në përgjithësi, si struktura ashtu dhe përbërja e grupeve kriminale që merren me drogë është e përzier. Lidhjet krijohen dhe mbahen nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta familjare, por qëndrueshmëria e tyre mund të mos jetë shumë afatgjatë. Shërbimet informative të policisë tregojnë se kriminelët nga "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" mbajnë kontakte me grupe kriminale nga Zvicra, Gjermania, dhe vëndet Skandinave. Gjithashtu, është vënë re se grupet kriminale të trafikut të drogës shpesh bashkëpunojnë në lidhje me kalimet e jashtëligjshme të kufirit, transfertat e jashtëligjshme të parave, shkëmbimin e avokatëve mbrojtës kur antarët e tyre arrestohen, pagesat për lirimet me kusht, etj. Borxhet likujdohen nëpërmjet kompensimeve me sasi droge.

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" kryesisht ka qënë një vënd tranzit për trafikimin e qënieve njerëzore. Të dhëna të fundit nga IOM dhe UNICEF tregojnë për një rekrutim vëndas, për trafikim të brëndshëm dhe për një treg vëndas, por këto nuk janë konfirmuar nga të dhënat e autoriteteve vëndase. Nëse "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" po përjeton një rritje në tregun e brëndshëm të shërbimeve seksuale, gjë e cila do të kërkonte një kombinim masash shtypëse dhe parandaluese, apo nëse vëndi është akoma kryesisht një pikë tranziti mbetet për tu sqaruar në të ardhmen.

Sipas autoriteteve kombëtare, rreth 2000 deri në 4000 gra trafikohen përmes vëndit. Shpesh viktimat e trafikut qëndrojnë përkohsisht brënda vëndit e më pas ri-trafikohen për në vënde të tjera. Shfrytëzimi seksual shpesh ndodh nëpër klube nate dhe bare, në të cilat gratë i shërbejnë 2 - 3 klientëve në ditë duke fituar një minimum prej 50 eurosh. Kjo shumë arrijnë në 15000 Euro në vit, ose në një total prej rreth 30 milion Eurosh në të gjithë tregun e brëndshëm.

Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e qënieve njerëzore kanë një përbërje të përzier, por në pjesën më të madhe dominohen nga individë me përkatësi Shqiptare. Zakonisht këto grupe kanë më shumë se tre antarë dhe shpesh veprojnë përtej kufijve, sidomos kur bëhet fjalë për transportin e femrave me shtetësi të huaj.

Emigrantët e transportuar në mënyrë klandestine kalojnë nëpërmjet “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” për në Greqi dhe në shumicën e rasteve janë me prejardhje nga Shqipëria dhe Kosova. Transporti klandestin i emigrantëve nga Lindja e Mesme dhe Amerika Latine nëpërmjet “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” organizohet nga grupe kriminale të Bullgarisë dhe Kosovës. Kundravajtësit në shumicën e rasteve janë njerëz që jetojnë në zona kufitare të cilët njohin mirë terrenin gjeografik dhe që kanë bashkëpunim me individë në vëndet fqinje.

Kontrabanda e mallrave të akcizës, në veçanti e cigareve, kanalizohet nga Kosova për në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” e më pas për të vazhduar në Greqi. Kontrabanda e pijeve alkolike kalon nga Greqia, Bullgaria dhe Serbia e Mali i Zi për në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”. Gjithashtu në vënd futen kontrabandë dhe tekstile me origjinë turke, kineze dhe bullgare, ndërkoh që telefonët celularë, kompjuterat dhe pjesët e tyre futen nga Greqia. Produktet ushqimore kalojnë kontrabandë nga Bullgaria si dhe nga Serbia dhe Mali i Zi.

Kontrabanda e mallrave të ligjshëm bëhet nëpërmjet kalimit të ligjshëm ose jo të kufirit. Për sa i përket mënyrës së veprimit, në grupet kriminale që merren me kontrabandë përfshihet të paktën një oficer doganor që ndihmon në kalimin e kufirit. Ata zakonisht korruptojnë oficerët doganorë dhe mashtrojnë për importimin e mallrave nëpërmjet kompanive të rreme. Struktura e këtyre grupeve është relativisht e sheshtë, në të cilat persona të veçantë mbulojnë furnizimin me mallra kontrabandë, kalimin e kufirit dhe shitjen e mallrave në treg. Antarët e këtyre grupeve kanë nivel edukimi dhe prejardhje etnike dhe sociale të ndryshme. Veprimet e tyre janë ndërkombëtare dhe ata mbështeten në përdorimin e telefonave celularë të parapaguar, gjë që e bën mjaft të vështirë kapjen dhe identifikimin e përdoruesit. Të ardhurat kryesisht ri-investohen në biznes, por edhe në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gjatë vitit 2003, u zbuluan 8 grupe të tilla të cilat kishin kryer 174 vepra kriminale. Në vitin 2003, u konfiskuan 29.868 kuti cigaresh dhe 21 ton pije alkolike. Në 9 muajt e parë të vitit 2004 u konfiskuan 32.700 kuti cigaresh, 13.034 litra pije alkolike, paisje teknike, produkte ushqimore dhe tekstile, etj. Vlera e mallrave të konfiskuar gjatë vitit 2003 dhe 2004 arrin në 105 035 760 MKD ose afërsisht 17 milion Euro.

Në shumicën e rasteve të pastrimit të parasë vihet re se janë të përfshira të njëjtat grupe që merren me evazion në sistemin e taksave dhe atë doganor. Të ardhurat e krimit pastrohen nga individë të cilët përdorin fuqinë, politike apo ekonomike, e posteve të tyre duke justifikuar të ardhurat e jashtëligjshme me fatura të rreme (për shembull sasi të mëdha tregtimi të mallrave pa vlerë) ose kompanive të trilluara.

5 Konkluzioni

Krimi i organizuar është një koncept dinamik i cili është në përshtatje të vazhdueshme ndaj një ambientit që ndryshon dita ditës dhe ndaj mundësive të reja që ofrohen. Ky është gjithashtu e vërtetë për krimin e organizuar në Europën Jug - Lindore:

- Bashkërendimi i përpjekjeve nga ana e organeve të zabitimit të ligjit kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe transportimit klandestin të personave duket të ketë sjellë një ndryshim pozitiv për sa i përket zvogëlimit të numrit të personave të trafikuar përmes kufijve. Në të njëjtën kohë, trafikimi i qënieve njerëzore tani ka sjellë një sfidë të re për sa i përket trafikimit dhe rekrutimit të brendshëm, si dhe rritjes së klientelës vëndase.
- Gjithashtu po zhvillohet dhe krimi ekonomik, i cili ndikon seriozisht të gjitha vëndet e rajonit. Heqja e sanksioneve ndaj Serbisë dhe shkatërimi në vijim i kanaleve të kontrabanës së cigareve dhe karburantit, si dhe përpjekjet e tjera rregulluese nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, kontribuan në mënyrë të dukshme në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave. Kështu, janë hequr disa mundësi për tregti të paligjshme në rajon. Por gjithsesi, mjaft të tjera vazhdojnë të mbeten. Fallsifikimi i dokumentave dhe kompanitë e rreme, - mjete kyce që përdoren për evazion fiskal dhe pastrim parash, - duket të jenë të pranishme në të gjitha vëndet e rajonit. Forma të tjera të krimit ekonomik, - të tilla si mashtrimet në prokurimet publike, privatizime dhe në sektorët financiarë, - mendohet të jenë në rritje dhe të vazhdojnë të ndikojnë besimin publik në ekonominë e tregut dhe në sistemin e së drejtës penale.
- Rruga tradicionale Ballkanike e trafikimit të drogës është kthyer në një rrugë me dy kalime, nëpërmjet së cilës kalon heroina dhe kanabisi për në Bashkimin Europian, ndërkohë që lëndët kimike parapërgatitore, kokaina dhe drogat sintetike kalojnë për në drejtim të lindjes. Në disa vënde duket të ketë një rritje të tregjeve vëndase të konsumit së bashku me shtimin e numrit të përdoruesve të drogës. Është e nevojshme që të shtohen jo vetëm masat shtypëse të këtij fenomeni, por edhe masat parandaluese.

Me maturimin e tregjeve të krimit, grupet kriminale përpiqen të konsolidojnë aktivitetet e tyre egzistuese, të shpërndahen në aktivitete të tjera dhe të legalizojnë fitimet dhe pozicionet e tyre në shoqëri. Korrupsioni, si në nivel të ulët ashtu dhe në nivel të lartë, duket të jetë një kryesor i përdorur për të depërtuar strukturat politike dhe ekonomike. Përpjekjet e fundit kundër korrupsionit në këto vënde kanë shtuar numrin e hetimeve dhe proceseve penale por deri tani ka patur pak dënime. Fakti se shumica e vëndëve kanë adoptuar tashmë strategji të hollësishme dhe shërbime anti - korrupsioni është mjaft premtues. Përpjekje të tilla mund të ndihmojnë në dëmtimin e lidhjeve midis krimit të organizuar dhe atij ekonomik me struktura ligjore dhe publike.

Përveç disa karakteristikave të veçanta për çdo vënd, problemet e lidhura me krimin e organizuar dhe atë ekonomik kanë një dimension rajonal. Si të tilla ato kanë nevojë për zgjidhje rajonale. Harmonizimi ligjor, përpjekjet e përbashkëta të organeve të zbatimit të ligjit dhe shkëmbimi i informacionit policor në një nivel rajonal do të jetë kyç për luftimin e suksesshëm të krimeve të rënda në Europën Jug - Lindore. Për këtë arsye, policimi në rajon i bazuar në informacion duhet të marrë baza të forta duke ndërtuar sistme të qëndrueshme të mbledhjes së informacionit.

Megjithëse vëndet e rajonit i kanë njohur efektet negative të krimeve të rënda mbi shoqëritë e tyre, akoma nuk është bërë i disponueshëm një vlerësim i humbjes së të ardhurave publike ndaj krimit ekonomik ose përmasës së tregut vëndas të drogës. Me disa përjashtime, sistemet e zbatimit të ligjit në rajon akoma nuk kanë kapacitet e nevojshme për mbledhjen e informacionit, analizimin dhe hetimin.

Duke patur parasysh se të ardhurat janë emëruesi i përbashkët i formave të ndryshme të krimit të organizuar dhe ekonomik, hetimet dhe informacionet financiare janë të domosdoshme për analizimin e këtyre krimeve. Vëndet e rajonit kanë ngritur tashmë njësi të hetimit financiar dhe deri

në një farë mase kanë filluar hetime financiare në lidhje me hetimet kriminale. Gjithsesi duhet që këto mjete të përdoren në mënyrë më sistematike.

Masat e zhvilluara nga vëndet dhe zonat e rajonit brënda kuadrin të projektit rajonal të policisë CARPO do të ndihmojnë në kalimin e këtyre mangësive. Ato mund të përfshijnë:

- Përmirësimin e mbledhjes dhe të analizimit të informacionit me qëllim që të përmirësohet njohja dhe kuptimi i krimit të organizuar dhe krimit ekonomik (p.sh. ngritja e sistemeve statistikore mbi krimin, përcaktimi i instrumenteve që masin nivelin e krimit, studime mbi mundësinë e prekjes së sektorëve të ndryshëm ekonomikë nga krimi i organizuar dhe krimi ekonomik, bashkëpunimi ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe studiuesve të pavarur apo akademike me qëllim studimin dhe analizimin e fenomeneve që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në rajon).
- Mekanizma të udhëhequr nga informacioni për përkufizimin e politikave, të cilat do të mbështeten në vlerësime rrënjësore, si dhe do të japin mundësinë e caktimit të prioriteteve në luftimin e formave specifike të krimit.
- Fuqizimin e kapaciteteve të njësive për analizimin e krimit, të shërbimeve të specializuara të hetuesisë apo të prokurorisë, për t'u marrë me krimin e organizuar, veçanërisht duke siguruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare si dhe trajnime të specializuara.
- Masat për përmirësimin e aftësive hetuese në lidhje me krimin ekonomik dhe krimin e organizuar, sikurse dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndër-juridiksional (p.sh. përdorimi siç duhet i teknikave të posaçme hetimore, përdorimi i informacionit me rëndësi strategjike dhe i analizës së krimit, përdorimi ndërkufitar i informacionit të mbledhur, etj).
- Përdorimin më të mirë të shërbimit informativ financiar me qëllim që të përfitohet një njohje më e plotë e krimit të organizuar dhe e krimit ekonomik (të forcohen kapacitetet për hetime financiare, kapacitetet e vetë njësive të inteligjencës financiare si dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërkufitar për këto çështje).
- Vënien në dispozicion dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit, duke i kushtuar vëmendjen e duhur garantimit të një shkalle të caktuar të konfidencialitetit (duke përfshirë zbatimin e instrumenteve përkatëse evropiane mbi intimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale).
- Monitorimin sistematik të efektivitetit të masave për paranadalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik.

Monitorimin sistematik të efektivitetit të masave për paranadalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik.

Ratifikimi dhe zbatimi i plotë i instrumentave Europiane do të ndihmonte vëndet që të avancojnë në këtë drejtim dhe të lehtësonin bashkëpunimin ndërkombëtar. Kjo përfshin në veçanti Protokollin e dytë Shtesë mbi Asistencën Reciproke në Çështje Penale (CETS 182), Konventën e re mbi Pastrimin, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit dhe mbi Financimin e Terrorizmit (CETS 198) dhe Konventën e re mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore (CETS 197).

6 Bibliografia

Amnesty International:

- Kosova (Serbia & Mali i Zi) – “A do të thotë kjo që unë kam të drejta?” – Mbrojtja e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave të trafikuar për prostitucion në Kosovë, Londër, 2004
- Gratë dhe vajzat e trafikuar në Kosovë kanë të drejta njerëzore, Botim shtypi, 5 Qershor 2004 (<http://news.amnesty.org/mavp/news.nsf/print/ENGEUR700122004>)
- Kosova: Paqeruajtësit ndërkombëtare mbajnë ndezur shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe mizorinë njerëzore, 6 Maj 2004.

Begovic Boris, Mijatovic, Bosko, dhe Hiber Dragor: Korrupsioni ne Gjyqësor, Qendra e Studimeve Liberale – Demokratike, Beograd 2004; <http://www.clds.org.yu>

Bosnja dhe Hercegovina, Ministria e Sigurimit: Raport mbi Sigurinë: Tre – mujori i parë, 2004

Korporata e Transmetimit Britanik (BBC, <http://news.bbc.co.uk>):

- Trupat e OKB-se në Kosovë ‘mbajnë ndezur tregtinë e seksit’, 5 Qershor 2004, news.bbc.co.uk/go/pr/fr/-/2/hi/europe/3686173.stm
- Krimi ekonomik ‘kushton £40bn britanik’, 17 Tetor 2004
- Ashdown shkarkon liderin e Boshnjakëve Kroatë, 29 Mars 2005,, newsbbc.co.uk/1/hi/world/Europe/4390635.stm.

Black, C./Van der Beken, T./Frans, B./Paternotte, M. (2001): Raportim mbi krimin e organizuar. Një zhvendosje nga pershkrimi në shpjegim në Raportin Vjetor Belg mbi Krimin e Organizuar, Antëerp, Maklu.

Projekti Blue Bird (Afhenda per Shoqërinë Civile në Europën Jug - Lindore: Në kërkim të një Qeverie Reaguese: Ndërtimi i Shtetit dhe Rritja Ekonomike në Ballkan, Qendra për Studimin e Politikave, , Central European University, 2003 (<http://www.cls-sofia.org/>)

Capps, Robert: ‘Fryrësit e birbilit’ jashtë ligjit dhe skllavë- seksi të shfajësuar, nga Korriku në Gusht 2002; www.salon.com.

Castells, M. (2003²): Ngritja e Shoqërisë në Rrjet. Malden/Oxford/Victoria.

Qendra për studimin e Demokracisë (<http://www.csd.bg/publications.php>)

- Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi i organizuar ne Europën Jug - Lindore, Sofie, 2003
- Tregu i drogës në Bullgari, Sofie, 2003
- Bashkëpunorë në krim: Rreziku i simbiozës midis sktorit të sigurimit dhe krimin të organizuar në Europën Jug – Lindore, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofie, 2004
- Transporti, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar Qendra për studimin e Demokracisë, Sofie, 2004
- Tendencat e krimin në Bullgari: Statistikat e policisë dhe anketat viktimizuese, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofie, 2005

Chossudovsky, Michel: Shefi i OKB-se fajëson pjesërisht shtetet e BE-së për dështimin në pengimn e rritjes së trafikimit në Europën Jug - Lindore, 26 Korrik 2002, Qendra për Kërkime mbi Globalizimin,, www.globalresearch.ca

Këshilli i Europës:

- Trafikimi i Qënieve Njerëzore dhe Korrupsioni (Programi PACO, TP 28 rev), Strasburg, 2002
- Raporti i situatës mbi Krimin e Organizuar, 2004 - Fokusi: Kërcënimi i krimin në internet, Strasburg, 2005

Këshilli i Bashkimit Europian / Grupi Ndër - Disiplinor mbi Krimin e Organizuar (2003): Kontrabanda e produkteve të duhanit në Bashkimin Europian dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar. Bruksel (CRIMORG 90).

Komisioni Europian:

- Opinion mbi Aplikimin e Kroacisë për Antaresim në Bashkimin Europian: Komunikatë nga Komisioni, Komisioni i Komuniteteve Europiane, Bruksel, 20 Prill 2004
- Procesi i Stabilizim Asociimit për Europën Jug - Lindore: Raporti i Tretë Vjetor, Komisioni i Komuniteteve Europiane, Bruksel, 2004
- Delegacioni i KE-se ne Bosnje Hercegovinë: Mashtrim i mundshëm i sheqerit, Botim shtypi, Sarajevë, 02 Gusht 2004
<http://www.delbih.cec.eu.int/en/worddocuments/word271.htm>

Qendra Europiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA):

- Raporti Vjetor 2003: Situata e problemit të drogës në Bashkimin Europian dhe Norvegji, Lisbon, 2003
- Raporti Vjetor 2003: Situata e problemit të drogës ne vëndet hyrëse dhe kandidate të Bashkimit Europian. Lisbon, Qendra Europiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga.

Iniciativa Europiane e Stabilitetit (www.esiweb.org):

- Momenti i Helsinkit: Ndërtimi i Shteteve Antare Europiane në Ballkan, 1 Shkurt 2005
- C'industrializimi dhe pasojat e tij: Nje histori Kosovare, Mars 2002

EUROPOL:

- 2004 Raporti mbi Krimin e Organizuar i Bashkimit Europian, Dhjetor 2004 (www.europol.eu.int)
- Europol (2002): Crimet e lidhura me kompjuterin brënda BE-së: Krimet e vjetra, mjete të reja; krimet të reja, mjete të reja, Hagë.

Financial Times: Sondazh mbi rolin e Malit të Zi në tregtinë e jashtëligjshme të cigareve, 9 Gusht 2001;

HINA (Agjensia Kroate e Lajmeve): Punonjësi i administratës shtetërore në Makarska nën hetim, Lista Jutarnji, 12 Maj 2005

Human Rights Watch: Shpresat e tradhtuara: Trafikmi i grave dhe vajzave ne Bosnje Hercegovinën e mbas luftës për prostitucion të detyruar, Vol 14, Nr. 9, Nëntor 2002.

Huremagic, Ramiz: Trajtimi i "Fantazmës": Krimi i Organizuar dhe Kontrolli i tij, Tema e Studimeve mbas universitare për M.Sc në Kriminologji dhe Sistemin e Drejtësisë Penale, Universiteti i Eëllsit, Cardiff, Shtator 2001 (i pa publikuar)

Komisioni ndërkombëtar mbi Ballkanin: Ballkani në të ardhmen e Europës, Prill 2005, <http://www.balkan-commission.org/>

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM):

Modelet dhe Tendencat në ndryshim të trafikimit të personave në rajonin e Ballkanit: Vlerësim i bërë në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Provincën e Kosovës (Serbia dhe Mali i Zi), "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" dhe Republika e Moldovës, Korrik 2004, www.iom.int

Grupi Ndërkombëtar i Krizave:

- Serbia: Rrotullimi i rrotave të saj, Njoftim i përditësuar, Njoftim i Europës Nr. 39, 23 Maj 2005, Beograd/Bruksel, www.crisisgroup.org
- Kthesa në vënd e Serbisë, Raporti Europës N°154, 26 Mars 2004, www.crisisgroup.org

Raporti Ndërkombëtar i Luftës dhe Paqes (IWPR, www.iwpr.net)

- Jovanovska, Svetlana: BE mendon për një marrëveshje të re ndihme për Ballkanin, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Barnett, Neil: Raketat e sekuestruara në Shqipëri, IWPR, Nr. 533, 16 Dhjetor 2004
- Musta, Suela: Nano pyetet në lidhje me paditë mbi kontrabandën e armëve, IWPR, Nr. 528, 19 Nëntor 2004
- Ahmetasevic, Nidzara: Opozita Boshnjake kërkon ligje anti - korrupsion, IWPR, Nr 552, 15 Prill 2005
- Jelacic, Nerma: Hetuesit e mafias nën sulm, IWPR, Nr. 542, 18 Shkurt 2005
- Lasica, Natalija: Bosnja lufton me valën e varësisë nga droga, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Jelacic, Nerma dhe Griffiths, Hugh: Hetuesit e mafias nën sulm, IWPR, Nr. 542, 18 Shkurt 2005
- Jelacic, Nerma dhe Griffiths, Hugh: A do të përballohet Europa me Mafien e Bosnjes?, (IËPR), Nr. 531, 2 Dhjetor 2004
- Jelacic, Nerma: Përhapjet e Eksplozivëve, IWPR, Nr. 458, 05 Shtator 2003
- Papic, Srdjan: Kontrabandistët e Bosnje Hercegovinës gjejnë rrugë për të anashkaluar shtrëngimet e kufirit, IWPR, Nr 425, 25 Prill 2003
- Radic, Renata: Shpenzimet e larta të liderave Boshnjakë përcajnë buxhetin, IWPR, Nr. 511, 12 Gusht 2004
- Anna McTaggart dhe Drago Hedl: Kroacia: Një punë në vazhdim, IWPR Nr. 562, 27 Qershor 2005
- Dimovski, Sase: Gjykatat Maqedonase në krizë, IWPR, Nr. 437, 13 Qershor 2003
- Hajrullahu, M., Salihu, A., Xharra, J.: Perëndimi i egër i Kosovës, IWPR, Nr 542, 18 Shkurt 2005
- Xharra, Arbana: Gangsterët dhe burokracitë pengojnë Investitorët e Kosovës, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Sullivan, Stacy: Raport Special: A i ka mbushur standartet Kosova?, IWPR, Nr. 549, 1 Prill 2005
- Sunter, Daniel: Policia merr në kontroll kufijtë e Serbisë, IWPR, Nr 543, 25 Shkurt 2005
- Sunter, Daniel: Shkarkimi i shefit të policisë shikohet si “pastrim”, IWPR, Nr. 512, 20 Gusht 2004
- Cvijanovic, Zeljko: Drita jeshile e BE-se do të siguronte një qeveri reaguese, IWPR, Nr. 548, 23 Mars 2005
- Simpson, John dhe Bojovic, Zelimir: Serbia humb luftën me korrupsionin doganor, IWPR, Nr. 541, 11 Shkurt 2005
- Serbia: BE-ja mund të zgjasë ndalimin e sheqerit, IWPR Nr. 445, 18 Qershor 2003 Joosens,

Joosens, Luk/Raw, Martin (1998): ‘Kontrabanda e cigareve në Europë: Kush përfiton në të vërtetë?’ Në: Kontrolli i duhanit 1998 (7) 66-71.

Kleinfeld Belton, Rachel: Përkufizime konkurruese të shtetit të së drejtës: Implikime për Praktikuesit, Esetë e Carnegie-t, Seritë e Shtetit të së Drejtës, Ndihmës së Carnigie-t për paqen ndërkombëtare 2005, (http://www.ceip.org/files/projects/dlr/dlr_home_121002.ASP)

Krastev Ivan: Retorika anti - korrupsion dhe reformat e politikave, Qendra për Strategjitë Liberale, (<http://www.cls-sofia.org>)

Morrison, J. (1992): ‘Skanimi mjedisor’, në M. Ëhitely et al (eds.): Nje guidë për Studiuesit e rinj institucionale, Tallahassee, Shoqata për Kërkime Institucionale.

Shërbimi Kombëtar Informativ për Krimin (NCIS): Vlerësimi i Kërcënimit i Mbretërisë së Bashkuar: Kërcënimi nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar, 2003, www.ncis.gov.uk

Nelken, D. (2002): Krimi i nëpunësve shtetërorë. Në: Maguire et al., 844-876.

Nicolic-Ristanovic, V. et al (2004): Trafikmi i personave në Serbi. Beograd (Shoqëria e Viktimologjisë në Servi dhe OSBE).

Obradovic, Vladimir: Trafikimi i grave në Bosnje Hercegovinë, Fakulteti i Qendrës për Kërkime në Kriminologji, Universiteti i Sarajevës, Janar 2004

OLAF (Zyra Anti - Mashtrim e Bashkimit Europian, europa.eu.int/olaf):

- Olaf jep fakte në gjyqin e "Lidhjes Malazeze" për përfshirjen në trafikimin ndërkombëtar të cigareve, Botim për shtyp OLAF/12/2003, 30 Prill 2003,
- Hetimi i Olaf-it në importin e sheqerit nga rajoni i Ballkanit, OLAF/15/2003, 29 Maj 2003,

Instituti i Shoqërisë së Hapur (www.eumap.org):

- Monitorimi i procesit të futjes në BE: Politika e korrupsionit dhe anti - korrupsionit, OSI, 2002
- Monitorimi i procesit të futjes në BE: Kapaciteti gjyqësor, OSI, 2002

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (www.osce.org):

- Raporti i Ekspertëve të pavarur për Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Keshillit të Europës në vizitën e tyre në Podgoricë (Serbi dhe Mali i Zi) nga 22 deri më 24 Korrik 2003, Independent Expert's Report to the Secretaries - General of the OSCE and the Council of Europe on Their Visit to Podgorica (Serbia and Montenegro) from 22 to 24 July 2003, raporti i përbashkët i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë dhe Këshillit të Europës, 3 Shtator 2003
- Qëndrimi dhe Konkluzioni i qeverisë së Malit të Zi në lidhje me Raportin e Ekspertëve të pavarur për Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Keshillit të Europës në vizitën e tyre në Podgoricë (Serbi dhe Mali i Zi) nga 22 deri më 24 Korrik 2003, Qeveria e Malit të Zi, 16 Tetor 2003.
- Komisioni për ristrukturimin e policisë së Bosnje Hercegovinës, Raporti përfundimtar mbi punën e Komisionit për ristrukturimin e policisë së Bosnje Hercegovinës, Dhjetor 2004 (<http://www.ohr.int/ohr-dept/rule-of-law-pillar/prc/>)

Radio Europa e Lirë: Mali i Zi: Kryeministri mohon akuzat për kontabandë cigaresh, 7 Nëntor 2003

Zyra Ndërlidhëse Informative Rajonale për Europën - RILO (2001): LASSO 2000 - Përmbledhje mbi Kontrabandën e cigareve në Europë, Cologne/Rotterdam.

Save the Children Mbretëria e Bashkuar (Programi i Serbisë) 2004: Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qënieve njerëzore. Beograd.

Savona, Ernesto U. dhe Curtol, Federica: Kontributi i Sistemit të shkëmbimit të të dhënave në Luftën kundër krimit të organizuar në vëndet e Europës Jug - Lindore: Raporti Përfundimtar, Krimi ndërkombëtar(Qendra e Studimeve të Përbashkëta mbi Krimin Ndërkombëtar e Universitë Degli Studi di Trento dhe Universitë Cattolica Del Sacro Cuore), Nëntor 2004, www.transcrime.unitn.it

Skrozza, Tamara: Intervistë - Verica Barac: Vlada je centar korupcije, Vreme Nr. 748, 5 Maj 2005, www.vreme.com

Pakti i Stabilitetit për Europën Jug - Lindore: Raporti i Parë Vjetor mbi Viktimat e Trafikimit në Europën Jug Lindore, Task Forca e Paktit të Stabilitetit mbi Trafikimin e Qënieve Njerëzore, Shtator 2003

Transparency International:

Raporti Global mbi Korrupsionin, 2005: Korrupsioni në ndërtimin dhe rindërtimin e mbas luftës, Transparenca Ndërkombëtare, (www.globalcorruptionreport.org)

Tisné, Martin, dhe Smilov, Daniel: Nga toka sipër: Vlerësimi i Rekordit të Ndhmës Anti - Korrupsion ne Europën Jug - Lindore, Qendra për Studimin e Politikave, Central European University, Rrjeti i Fondacionit Soros, 2004

Anti - Korrupsioni në Europën Jug - Lindore: Hapat e para dhe politikat, Qendra për Studimin e Demokracisë, Iniciativa Europës Jug - Lindore për Zhvillimin Ligjor (SELDI), 2002, <http://www.seldi.net/>

Kombet e Bashkuara (UN):

- UNMIK Trafikimi dhe Njësitë e Prokurorisë (TPIU): Raporti i fundit të vitit 2003

- Trafikimi i qënieve njerëzore në Europën Jug - Lindore, Raporti i përbashkët me UNICEF, UNOHCHR, dhe OSBE/ODIHR, Nëntor 2003
- Trafikmi i qënieve njerëzore në Europën Jug - Lindore: 2004 - Përqëndrimi në parandalim, raport i përbashkët i UNICEF, UNOHCHR, dhe OSBE/ODIHR, Mars 2005

UNODC (www.unodc.org)

- Raporti Botërorë për Drogat 2004, Vienë
- Tendencat e Drogës dhe të Krimin në Evropë dhe përtej saj, 2004 (a), Vienë.
- Sondazhi I Shtatë I Kombeve të Bashkuara mbi Prirjet e Krimin dhe mbi Operacionet e Sistemit të Drejtësisë Penale, që mbulon periudhën e viteve 1998-2000, Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin dhe Drogën, dhe Qendra për Parandalimin Ndërkombëtar të Krimin, 2002, Vienë.

Departamenti i Shtetit Amerikan: Raporti i Trafikimit të Personave, Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit të Personave, 14 Qershor 2004, (<http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2004>)

Vander Beken, Tom: Matja e Krimin të Organizuar në Europë: Një studim i realizueshmërisë së një metodologjie të bazuar në rrezikun nga krimi i organizuar në Bashkimin Europian, Instituti për Studime Nderkombëtare dhe Politika Kriminae, Universiteti Ghent, Publikuesit Maklu, 2004

Von Lampe, Klaus (2001) Tregu i jashtëligjshëm i cigareve në Gjermani: Një studim i një çështjeje të krimin të organizuar (Ese e prezantuar në takimin e parë vjetor të Shoqërisë së Kriminologjisë Europiane, Lausanne, Zvicër, 6 Shtator 2001).

Xenakis, Sappho: Sfida e krimin të organizuar ndaj sovranitetit shtetëror në Ballkan, Një përjasje historike, 7 Janar 2001, www.ksg.harvard.edu/kokkalis/GSW3/Sappho_Xenakis.pdf